



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA KUSHTETUESE  
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 7/2021 (JR)  
Datë 28.01.2021

Vendim nr. 7 (JR)  
Datë 23.02.2023

**VENDIM  
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, i përbërë nga gjyqtarët:

<b>Sokol Çomo</b>	<b>Kryesues</b>
<b>Natasha Mulaj</b>	<b>Relatore</b>
<b>Albana Shtylla</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Ina Rama</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Rezarta Schuetz</b>	<b>Anëtare</b>

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore publike, më datë 23.02.2023, ditën e enjte, ora 15:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, në prani të Vëzhgueses Ndërkombëtare Marie Tuma, me Sekretare Gjyqësore Elba Arapi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

**ANKUES:** Komisioneri Publik Florian Ballhysa.

**OBJEKTI:** Shqyrtimi i vendimit nr. 287, datë 04.08.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Mici.

**BAZA LIGJORE:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,**

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore publike, me praninë e palëve, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi Komisionerin Publik, i cili përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 287, datë 04.08.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi subjektin e

rivlerësimit, znj. Anita Mici, e cila kërkoi lënien në fuqi të vendimit objekt shqyrtimi, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

## VËREN:

### I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Subjekti i rivlerësimit Anita Mici (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar, *ex officio*, për shkak të ushtrimit të funksionit të gjyqtares në Gjykatën e Apelit Durrës, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në kuadër të zhvillimit të procesit të rivlerësimit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, administroi raportet për subjektin e rivlerësimit, të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”) dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim “KLGj”), sipas të cilave ka rezultuar:

2.1. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit të hollësishëm të pasurisë së subjektit të rivlerësimit, ka dërguar pranë Komisionit *aktin e përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit, znj. Anita Mici*<sup>1</sup>, ku në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me nenin 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar si vijon: *i. deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin dhe ka mosdeklarim pasurie; ii. ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; iii. nuk ka kryer fshehje të pasurisë; iv. nuk ka kryer deklarim të rremë; v. subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

2.2. DSIK-ja, në zbatim të nenit 39, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, pas përfundimit të procedurave të kryera nga grupi i punës për kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, në raportin e përcjellë me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 02.11.2017, deklasifikuar plotësisht<sup>2</sup>, ka konstatuar *përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Anita B. Mici*. Në vijim të kërkesës së Komisionit, për rishikimin dhe deklasifikimin e informacionit të klasifikuar “Sekret shtetëror”, DSIK-ja përcjell raportin nr. {\*\*\*} prot., datë 07.12.2018, të deklasifikuar pjesërisht<sup>3</sup>, sipas të cilit, nisur nga të dhënat e siguruara nga autoritetet verifikuese, ndryshon konstatimi fillestar nga përshtatshmëri për vazhdimin e detyrës në papërshtatshmëri për vazhdimin e detyrës nga subjekti i rivlerësimit, znj. Anita B. Mici (H.).

2.3. KLGj-ja, pasi ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, bazuar në përshkrimin dhe analizimin e tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, të pesë dosjeve penale, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të të dhënave nga burimet arkivore të Këshillit të Lartë Gjyqësor, në zbatim të

---

<sup>1</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 21.05.2018, “Dërgohet akti i përfundimit të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit Anita Mici, me funksion gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Durrës”.

<sup>2</sup> Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 29.04.2020, të Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”.

<sup>3</sup> Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 18.12.2018, të Komisionit të Deklasifikimit dhe të Zhvlerësimit të Informacionit të Klasifikuar “Sekret shtetëror”;

nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, i dërgoi Komisionit një raport<sup>4</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Mici.

3. Komisioni, pasi kreu hetimin administrativ për të tria kriteret e rivlerësimit, arriti në konkluzionet e mëposhtme.

3.1. Referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV të ligjit nr. 84/2016, në vlerësimin tërësor të komponentit të pasurisë, mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe në bindjen e brendshme, subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, me veprimet dhe mosveprimet e saj nuk ka cenuar besimin e publikut dhe ka arritur nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

3.2. Referuar nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, rezultoi se: (i) nuk u provuan dyshimet e DSIK-së; (ii) u provua se subjekti i rivlerësimit, znj. Anita, Mici, kishte deklaruar në funksion të raportit të DSIK-së, marrëdhënien me të afërmit e saj/djemtë e tezes, të dhënat e tyre personale, lidhjen e gjakut, si dhe veprën penale për të cilën janë akuzuar e dënuar dhe që, për pasojë, ndaj saj nuk mund të zbatohet ndonjë masë penalizuese brenda përcaktimeve të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

3.3. Lidhur me kriterin e vlerësimit etiko-profesional, bazuar në pikën 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni çmon se dërgimi për inspektim i njëres prej dosjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, me cilësinë e anëtares së trupës gjyquese, është i pamjaftueshëm<sup>5</sup> për të arritur në vlerësimin e saj sipas gërmës “b” të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016. Në këto kushte, referuar nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI të ligjit nr. 84/2016, lidhur me vlerësimin e aftësive profesionale, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale sipas nenit 44/a të ligjit nr. 84/2016.

4. Komisioni, bazuar në nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pikat 1 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, pasi konstatoi se subjekti i rivlerësimit plotëson kushtet e nenit 59, pika 1 e këtij ligji, me vendimin nr. 287, datë 04.08.2020, vendosi: *1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Mici, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Apelit Durrës. 2. Transferimin e çështjes gjyqësore, regjistruar me nr. {\*\*\*}, datë 9.9.2016, përfunduar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 5.12.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës, në organin kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, bazuar në pikën 4 të nenit 59 të ligjit nr. 84/2016. [...]*

## **II. Shkaqet e ankimit të paraqitura nga Komisionerit Publik**

5. Kundër vendimit nr. 287, datë 4.8.2020, të Komisionit, ka ushtruar ankim Komisioneri Publik Florian Ballhysa, duke kërkuar, në zbatim të nenit 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016,

<sup>4</sup> Raporti nr. {\*\*\*} prot., datë 03.12.2019, “Për analizimin e aftësisë profesionale të gjyqtarës Anita Mici”.

<sup>5</sup> Neni E, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, përcakton se: “Vlerësimi i aftësive profesionale ka për qëllim identifikimin e atyre subjekteve që nuk janë të kualifikuar për të kryer funksionin e tyre dhe të atyre të cilët kanë mangësi profesionale, që mund të korrigjohen përmes edukimit”. Neni 59 i ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: “Vlerësimi i aftësive profesionale parashikon arritjen e një niveli minimal kualifikues”. Vendimi nr. 2/2017 i Gjykatës Kushtetuese, ku në pikën 54 përcaktohet se: “Në lidhje me kriteret dhe standardet për kryerjen e kontrollit të aftësive profesionale, Gjykata vlerëson të theksojë edhe rëndësinë e garantimit se opinionet ligjore të shprehura nga gjyqtarët dhe/ose prokurorët, të cilat mund të konsiderohen si thjesht “të pasakta” nga kontrolluesit, të mos bëhen shkak për rezultat negativ. Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale (shihni edhe opinionin CDL -AD (2016)036 e Komisionit të Venecias)”.

ndryshimin e këtij vendimi dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Mici. Komisioneri Publik, ndryshe nga sa disponon Komisioni, referuar gjendjes së fakteve dhe analizës ligjore, ndan gjykim të kundërt me të, pasi vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk arrin nivel të besueshëm për kriteret e procesit të rivlerësimit për konfirmim në detyrë. Vendimi i Komisionit është i cenueshëm në tërësinë e tij. Në referencë të nenit 4, pika 2, nenit 59, pika 1 dhe nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, Komisioneri Publik vlerëson se verifikimi nga Kolegji i Posaçëm i Apelit, i situatës faktike dhe i mënyrës së zbatimit të ligjit, është i nevojshëm, duke kërkuar njëkohësisht një vlerësim të përgjithshëm të të tria kriterëve të rivlerësimit.

6. Shkaqet e paraqitura nga Komisioneri Publik në ankim për kriterin e vlerësimit të pasurisë, janë si më poshtë.

6.1. *Për pasurinë, apartament banimi me sipërfaqe totale 104,33 m<sup>2</sup>, Komisioneri Publik e gjen të pabazuar në akte dhe interpretim ligjor qëndrimin e Komisionit, lidhur me vlerësimin e dy burimeve për investimin në këtë pasuri, konkretisht: (i) kursime familjare në shumën 5.000 euro; dhe (ii) ndihmë nga babai i personit të lidhur në shumën 25.000 euro ose 3.000.000 lekë.*

6.1.1. *Lidhur me burimin e krijimit të kësaj pasurie, kursime familjare në shumën 5.000 euro:*

6.1.1.1. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarime të pasakta në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006 dhe deklarime kontradiktore gjatë hetimit administrativ të Komisionit mbi shlyerjen e pagesës 5.000 euro.

6.1.1.2. Në konsideratë të jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit<sup>6</sup>, për deklarimin e likuiditeteve *cash* në deklaratat periodike vjetore, Komisioni duhet të kishte mbajtur një qëndrim ndryshe, duke përfshirë në analizë vetëm sa ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë 2006. Shuma 500.000 lekë duhet konsideruar shtesë e likuiditeteve *cash* në këtë vit, ashtu sikurse ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore 2006.

6.1.1.3. Subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pagesën e shumës 5.000 euro, të kryer më datë 21.03.2006. Nga llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, deri në këtë datë kur është kryer pagesa 5.000 euro, rezulton të jenë tërhequr në total rreth 250.000 lekë, të cilat nuk janë të mjaftueshme për pagesën e shumës 5.000 euro dhe për mbulimin e shpenzimeve familjare deri më datë 21.03.2006.

6.1.2. *Lidhur me burimin e krijimit të pasurisë “ndihmë nga babai i personit të lidhur (bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit)”, në shumën 25.000 euro, e barasvlefshme me 3.000.000 lekë:*

6.1.2.1. Pagesa e tatimit për këto të ardhura është bërë në datën 24.07.2020, gjatë procesit të rivlerësimit dhe, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit<sup>7</sup>, konsiderohet e paefektshme në funksion të procesit të rivlerësimit dhe, si e tillë, kjo shumë nuk duhet përfshirë në mesin e burimeve të të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për pagesën e apartamentit me sipërfaqe 104,33 m<sup>2</sup>.

<sup>6</sup> Referojuni vendimit (JR) nr. 11/2019, pika 27.12.18, paragrafi 27; vendimit (JR) nr. 19/2019, paragrafi 84; vendimit (JR) nr. 20/2019, paragrafi 59; vendimit (JR) nr. 7/2019, paragrafi 39; vendimit (JR) nr. 27/2020, paragrafi 19.4.v. etj.

<sup>7</sup> Referojuni vendimit (JR) nr. 8/2019, paragrafi 63; vendimit (JR) nr. 5/2020, paragrafi 41.9; vendimit (JR) nr. 23/2020, paragrafi 24.13.

6.1.2.2. Rezulton e paprovuar mënyra e përfitimit/transaksioni i kryer, i cili lidh burimin e ligjshëm të të ardhurave, nga kontratat e shitjes të viteve 1995 dhe 2000, me dhurimin prej 3.000.000 lekësh në vitin 2006.

6.1.3. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, në vitin 2006, kanë mungesë të ardhurash të ligjshme për të investuar në pasuri, për të kursyer shumën 500.000 lekë, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare, në shumën totale prej (-) 4.066.211 lekësh.

6.2. *Lidhur me analizën financiare*, Komisioneri Publik e gjen të pabazuar në akte dhe interpretim ligjor vlerësimin e Komisionit mbi mundësinë e mbulimit me të ardhura të ligjshme të krijuara nga burime të ligjshme të kursimeve dhe shpenzimeve të realizuara nga familja e subjektit të rivlerësimit në vitet 2005-2016, për këto elemente: (i) të ardhurat e pretenduara si “ndihmë financiare nga babai i personit të lidhur (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit”); (ii) likuiditetet në *cash*; (iii) shpenzimet jetike të familjes së subjektit të rivlerësimit.

6.2.1. Lidhur me të ardhurat e pretenduara si “ndihmë financiare nga babai i personit të lidhur” në shumat prej 300.000 lekësh/vit:

6.2.1.1. Subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur gjatë plotësimit të deklaratave të interesave privatë të viteve 2005-2016, në rubrikën “Dhurata dhe trajtime preferenciale”, me vlerën mbi 10.000 lekë, nuk rezultojnë të kenë deklaruar të ardhura të përfituara nga babai i personit të lidhur për përballimin e shpenzimeve të jetesës.

6.2.1.2. Deklarimi i këtyre të ardhurave të pretenduara që Komisioni i ka përlllogaritur si të ardhura të ligjshme, ka qenë detyrim ligjor për deklarim, parashikuar nga legjislacioni përkatës, që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur e kanë mbartur gjatë plotësimit të përvitshëm të deklaratave pranë ILDKPKI-së dhe asaj *vetting*.

6.2.1.3. Shumat prej 300.000 lekësh/vit nuk duhen përfshirë në zërin e të ardhurave ndër vite për sa kohë nuk janë deklaruar nga subjekti në deklaratat periodike vjetore, në referencë të nenit 32 pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe të jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit, mbi vlerën provuese të deklaratave periodike vjetore, në procesin e rivlerësimit.

6.2.2. Lidhur me *likuiditetet në cash të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike vjetore*:

6.2.2.1. Komisioni në analizën financiare të kryer për vitet 2006, 2007 dhe 2016, ka pakësuar likuiditetet *cash* në shumën 450.000 lekë, në vitin 2006; në shumën 500.000 lekë, në vitin 2007 dhe 300.000 lekë në vitin 2016, ndërkohë që në deklaratat periodike vjetore, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vetëm shtesa të kursimeve në *cash* dhe në asnjë prej këtyre deklaratave nuk ka deklaruar pakësime të këtyre kursimeve.

6.2.2.2. Përlllogaritjet e Komisionit lidhur me likuiditetet *cash* nuk përputhen me çfarë ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në deklaratimet periodike vjetore dhe bien ndesh edhe me orientimin e Kolegjit në vendimin (JR) nr. 7/2019, paragrafi 39, si dhe me jurisprudencën e deritanishme të tij<sup>8</sup>, pasi këto deklarata përbëjnë të vetmen provë dhe mënyrë verifikimi të ekzistencës së likuiditeteve *cash* në

---

<sup>8</sup> Referojuni vendimit (JR) nr. 27/2020, paragrafi 19.4.v; vendimit (JR) nr. 19/2019, paragrafi 84; vendimit (JR) nr. 11/2019, paragrafi 27.12.18.

funksion të procesit të rivlerësimit.

**6.2.3.** *Shpenzimet e jetesës* të familjes së subjektit të rivlerësimit, ndryshe nga Komisioni që ka reduktuar shpenzimet e jetesës së djalit të subjektit të rivlerësimit, duhen llogaritur bazuar në përbërjen familjare të subjektit, të deklaruar në deklaratat periodike vjetore përkatëse, duke përfshirë vitet 2006 dhe 2007, në të cilat subjekti i rivlerësimit i ka vetëdeklaruar këto shpenzime.

**6.2.4.** Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga aktiviteti privat si avokat, duhet të merret në konsideratë fitimi pas tatimit për vitet 2014-2015, përkatësisht 153.593 lekë në vitin 2014 dhe 2.850.220 lekë në vitin 2015<sup>9</sup>. Likuiditetet në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit, në datën 31.12.2007, janë në total në shumën (-)25.490 lekë<sup>10</sup>.

**6.2.5.** Nga rivlerësimi i këtyre elementeve të analizës financiare për periudhën 2005-2016, Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur për vitet 2005, 2007 dhe 2009-2014, nuk mbulojnë më të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe kursimet në këto vite, për një diferencë totale negative prej (-) 3.256.276 lekësh.

**6.3.** *Për pasurinë, automjet tip “Audi A4”, Komisioneri Publik e gjen të pabazuar në akte dhe interpretim ligjor vlerësimin e Komisionit mbi: (i) mundësinë e huadhënësit për të dhënë shumën 6.000 euro nga burime me të ardhura të ligjshme; dhe (ii) pamjaftueshmërinë e konstatuar në shumën (-) 172.284 lekë, për të investuar në blerjen e kësaj pasurie për të shlyer huan, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare për vitin 2016.*

**6.3.1.** Huadhënësi, shtetasi V. A., nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t'i dhënë personit të lidhur, bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, huan në shumën 6.000 euro<sup>11</sup>.

**6.3.2.** Mbi pamjaftueshmërinë në shumën (-) 172.284 lekë, të konstatuar nga Komisioni, në analizën financiare: (i) nuk duhet përfshirë në zërin të ardhura, shuma 300.000 lekë “ndihmë financiare nga vjehri”, pasi këto të ardhura nuk janë deklaruar nga subjekti as në deklaratat periodike vjetore dhe as në deklaratën e pasurisë *vetting*; (ii) shpenzimet e jetesës për vitin 2016, duhen llogaritur për 4 (katër) persona, bazuar në përbërjen familjare sipas certifikatës së gjendjes civile; (iii) zëri “ndryshimi në likuiditete” duhet llogaritur në shumën 1.925.783 lekë<sup>12</sup>, pasi nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar në deklaratën e interesave private 2016, pakësim të likuiditeteve *cash* në shumën 300.000 lekë.

<sup>9</sup> Komisioni ka përfshirë në zërin “të ardhura”, fitimin e tatueshëm, ndërkohë që nga këto shuma duhet të ishte zbritur tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, që referuar akteve bashkëngjitur shkresës së Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë nr. {\*\*\*} prot., datë 2.8.2017, është përkatësisht 16.667 lekë në vitin 2014 dhe 231.099 lekë në vitin 2015. Ndërsa në vitin 2016, tatimi mbi fitimin e deklaruar është (0) zero.

<sup>10</sup> Balanca e llogarisë bankare nr. {\*\*\*}, në emër të subjektit të rivlerësimit, nuk është në shumën (+) 79.802 lekë, sa është llogaritur nga Komisioni, por është në shumën (-) 79.802 lekë. Balanca e llogarisë bankare nr. {\*\*\*}, në emër të bashkëshortit të subjektit, në Raiffeisen Bank ShA, nuk është në shumën 83.869 lekë, por në shumën 53.869 lekë, pasi rezulton se më 31.12.2007, nga kjo llogari është tërhequr cash shuma 30.000 lekë.

<sup>11</sup> Mbi diferencën e mbetur të çmimit të blerjes prej 2.000 eurosh dhe shpenzimeve doganore në vlerën 229.237 lekë, nga nxjerrjet e llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, z. M., konstatohet se gjatë periudhës 01.01.2016 deri në momentin e blerjes së automjetit, më datë 04.03.2016, nuk janë kryer tërheqje cash. Gjithashtu, të ardhurat e personit të lidhur, z. M., nga aktiviteti i avokatisë, në shumën 3.191.501 lekë, janë vjetore dhe nuk mund të identifikohet pjesa e të ardhurave të realizuara deri në datën e blerjes së automjetit.

<sup>12</sup> Në analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2016, faqe 6 e rezultateve të hetimit, zëri: “ndryshim likuiditeti” është llogaritur në vlerën 1.625.782 lekë, pasi rezulton të jenë pakësuar kursimet cash në shumën 300.000 lekë, pakësim që nuk rezulton të jetë deklaruar në DIPV nga subjekti.

6.3.3. Nëse përfshihet në analizën financiare të vitit 2016, huaja në shumën 6.000 euro, përsëri rezulton se në vitin 2016, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë mungesë të ardhurash të ligjshme për të investuar në pasurinë automjet “Audi A4”, për të shlyer huan, si dhe për të mbuluar kursimet dhe shpenzimet e tjera familjare, në total për një diferencë negative në shumën (-) 1.007.151 lekë.

6.3.4. Në *Formularin e Deklarimit të Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin*, të dorëzuar nga personi fizik “Dh. M.”, për vitin 2016, nuk është deklaruar shuma e tatim fitimit, por është deklaruar vetëm fitimi i tatueshëm ose fitimi para tatimit. Nëse nga fitimi i deklaruar do të zbritej edhe tatim fitimi i paguar, të ardhurat neto nga aktiviteti i avokatisë për vitin 2016, do të reduktoheshin dhe, si rrjedhojë, do të thellohej edhe diferenca negative e vitit 2016.

6.4. Në përfundim, për vlerësimin e kriterit të pasurisë, Komisioneri Publik vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar investimet, shpenzimet dhe kursimet gjatë periudhës 2005-2016, me një diferencë negative në total prej (-) 8.329.638 lekësh, referuar nenit D, pikave 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 61, pika 3, si dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ndodhet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për kontrollin e pasurisë.

7. Shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, konsistojnë si në vijim.

7.1. *Për vendimin penal nr. {\*\*\*}, datë 30.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës:*

7.1.1. Për veprat penale të kësaj çështjeje, “Ndërtimi i paligjshëm” dhe “Vjedhje e energjisë elektrike dhe impulseve telefonike”, të parashikuara nga nenet 199/a, paragrafi 2 dhe 137, paragrafi 1 i Kodit Penal, duhen marrë në konsideratë gjetjet dhe vlerësimet e raportit të hartuar nga KLGj-ja, në cilësinë e organit ndihmës në lidhje me konstatimin se: [...]masa e dënimit të caktuar nga gjykata është dhënë në keqinterpretim të neneve 47 dhe 55 të K. Penal dhe, për rrjedhim, ka cenuar parimin e proporcionalitetit të përcaktuar nga neni 1/c i K. Penal dhe neni 17/1 i Kushtetutës [...].

7.1.2. Referuar rolit dhe kompetencës të institucioneve të rivlerësimit në shqyrtimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit dhe kritereve vlerësuese të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, Komisioneri Publik konstaton mungesë të arsytimit ligjor nga ana e subjektit të rivlerësimit, lidhur me caktimin e masës së dënimit në vendimin objekt vlerësimi.

7.2. *Për vendimin penal nr. {\*\*\*}, datë 15.05.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës:*

7.2.1. Referuar rolit dhe kompetencës të institucioneve të rivlerësimit në shqyrtimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit dhe kritereve vlerësuese të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i këtij rasti, në kushtet e konstatimeve të përsëritura, Komisioneri Publik vlerëson se duhen marrë në konsideratë gjetjet dhe vlerësimet e raportit të hartuara nga organi inspektues i kohës në drejtim të mungesës së analizës dhe argumentimit logjik të subjektit rivlerësues në vendimin objekt vlerësimi.

7.3. *Për vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.12.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Durrës:*

7.3.1. Komisioneri Publik konstaton se subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, edhe në këtë rast, nuk provoi të kundërtën e barrës së provës, për sa kohë as aktet e administruara dhe as parashtrimet

e saj nuk ndryshuan rezultatet e hetimit administrativ, fakt që argumentohet dhe në pjesën përkatëse të vendimit të Komisionit.

**7.3.2.** Ndryshe nga sa ka konkluduar Komisioni, se: [...] në vlerësim të përgjithshëm të rastit, nuk konstatohen problematika që të mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit [...], Komisioneri Publik vlerëson se ky denoncim i publikut, në referencë të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, përmban të dhënat e nevojshme për të vlerësuar mbi shkeljen, pasojat ligjore si dhe rrethanat që krijojnë bindje se ka pasur shkelje ligjore.

**7.3.3.** Cenimi i parimit të *sigurisë juridike* për palët në këtë proces gjyqësor, ka ardhur si pasojë e mosthirrjes së palës tjetër në gjykimin me objekt “për rivendosjen në afat të ankimit”, veprim i detyrueshëm nga ligji, që duhej të ishte kryer nga subjekti i rivlerësimit në cilësinë e gjyqtarit të vetëm që shqyrtoi kërkesën.

**7.3.4.** Referuar rolit dhe kompetencës së institucioneve të rivlerësimit në shqyrtimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, në zbatim të kriterëve vlerësuese të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i këtij rasti, në kushtet e konstatimeve të përsëritura, Komisioneri Publik çmon se vendimi gjyqësor objekt vlerësimi, i marrë nga subjekti i rivlerësimit në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, sikurse neni 152 i Kodit të Procedurës Civile, duhet të merret në konsideratë dhe të vlerësohet në drejtim të mungesës së analizës ligjore dhe argumentimit.

**7.3.5.** Kolegji i Posaçëm i Apelit, në vendimin orientues (JR) 21/2019, shprehet se: [...] konsideron me rëndësi që për vlerësimin e aftësive profesionale, vëmendje t’i kushtohet edhe denoncimit të fakteve nga publiku [...], kur ekzistojnë kushtet dhe rrethanat e parashikuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016. Sa më sipër, rezultatet e hetimit të këtij denoncimi të administruar sipas nenit 53, duhen konsideruar dhe në funksion të qëllimit kushtetues për rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

**7.4.** *Vendimi penal nr. {\*\*\*}, datë 05.12.2016, i Gjykatës së Apelit Durrës, në të cilin subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues:*

**7.4.1.** Referuar përmbajtjes së nenit 434, paragrafi i dytë i Kodit të Procedurës Penale, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë gjatë gjyimit të rekursit ndaj këtij vendimi, do t’u japë përgjigje të gjitha shkaqeve të paraqitura nga prokurori. Komisioneri Publik konstaton se vetë Komisioni ka kërkuar dhe administruar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me shkaqet e rekursit të prokurorit të ushtruar ndaj vendimit nr. {\*\*\*}, datë 05.12.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës, duke konkluduar edhe mangësi në analizën ligjore të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me pretendimet për zbatimin e nenit 427, pika 5 e Kodit të Procedurës Penale.

**7.4.2.** Në të tilla rrethana fakti dhe ligji, në referencë të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, sa kohë procesi i rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit në rastin konkret, do të përfundojë me marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka vendosur Komisioni për transferimin pranë organit kompetent për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore, kërkon që kjo çështje të përfshihet në rrethin e vendimeve objekt vlerësimi të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke u administruar eventualisht vendimi që do të marrë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë mbi shkaqet e rekursit të prokurorit.



### III. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

#### *Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit*

8. Në përputhje me nenin 65, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit, në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga Komisioneri Publik, kryhet në seancë publike. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhet me shqyrtimin e ankimit të Komisionerit Publik ndaj vendimit të Komisionit nr. 287, datë 04.08.2020, për subjektin e rivlerësimit, znj. Anita Mici, u mor në shqyrtim nga trupi gjykues i Kolegjit në seancë gjyqësore publike, të zhvilluar në prani të palëve.
9. Në kuadër të veprimeve përgatitore të çështjes, bazuar në nenin 20, pika 5/1 e rregullores së Kolegjit “Për veprimtarinë e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit të Gjykatës Kushtetuese”, e ndryshuar, janë ftuar palët pjesëmarrëse në këtë proces, subjekti i rivlerësimit dhe Komisioneri Publik, që të depozitojnë në Kolegj parashtrimet e tyre me shkrim, së bashku me aktet që kërkojnë të merren në cilësinë e provës në gjykim, në mënyrë që këto parashtrime dhe aktet t’u komunikohen përkatësisht palëve në proces, për dijeni Operacionit Ndërkombëtar të Monitorimit, para seancës gjyqësore publike, për efekt të një ekonomie gjyqësore dhe të menaxhimit sa më efikas të procesit gjyqësor. Gjithashtu, palëve pjesëmarrëse në proces u janë vënë në dispozicion dhe denoncimet<sup>13</sup> nga publiku të depozituara në Kolegj, adresuar subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Mici.
10. Në seancën gjyqësore publike të datës 31.01.2023, Komisioneri Publik mbajti qëndrimin e tij lidhur me denoncimet nga publiku, duke i konsideruar ato të panevojshme për t’u hetuar, pasi shkaqet e ankimit sipas tij, janë të mjaftueshme për disponimin përfundimtar nga ana e Kolegjit. Ndërsa subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, u shpreh se denoncimet lidhen me vendime gjyqësore të marra në zbatim të ligjit. Njëri nga denoncimet, sipas saj, nuk kënaq kërkesat e ligjit për t’u konsideruar, pasi nuk identifikon të dhëna për denoncuesin apo fakte konkrete që të çojnë te veprimtaria gjyqësore apo vendimi dhe pjesa tjetër janë vendimmarrje pas periudhës së rivlerësimit dhe nuk duhet të jenë pjesë e këtij procesi. Trupi gjykues i Kolegjit thekson se në kuadër të këtij procesi, legjislati i zbatueshëm nuk pengon denoncimet, dhe në rast se ato nuk identifikojnë denoncuesin, si dhe nuk kufizon në kohë faktet apo rrethanat objekt denoncimi, të cilat mund të kenë ndodhur edhe tej periudhës së rivlerësimit, por që përbëjnë shkak për hetim të mëtejshëm kur adresojnë shkelje ligjore të subjektit të rivlerësimit. Trupi gjykues, pasi analizoi denoncimet e paraqitura në Kolegj, me vendim të ndërmjetëm, vlerësoi se ato nuk plotësojnë kërkesat e nenit 53 të ligjit nr. 84/2016 për të kërkuar hetim të mëtejshëm dhe, për këtë arsye, vendosi të mos çelë hetim gjyqësor lidhur me këto denoncime.
11. Gjatë kësaj seance gjyqësore publike, trupi gjykues, bazuar në nenin F, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenet 45 dhe 49 të ligjit nr. 84/2016, me vendim të ndërmjetëm, vendosi çeljen e hetimit gjyqësor dhe administrimin si provë të akteve shkresore<sup>14</sup> të listuara së bashku me

<sup>13</sup> i. Denoncimi nr. {\*\*\*} prot., datë 25.03.2019, i shtetasit P. Gj.; ii. denoncimi nr. {\*\*\*}, datë 10.02.2020, i shtetasit E. M.; iii. denoncimi nr. {\*\*\*} prot., datë 14.09.2022, i shtetasit A. E.; iv. denoncimi nr. {\*\*\*} prot., datë 04.04.2022, i shtetasit L. H.; v. denoncimi nr. {\*\*\*} prot., datë 23.06.2021, i shtetasit D. Z.; vi. denoncimet nr. {\*\*\*} prot., datë 18.03.2022 dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 23.03.2022, të shtetasit R. T.; vii. denoncimi nr. {\*\*\*} prot., datë 07.07.2022, i shtetasit K. Sh.

<sup>14</sup> (i) Vërtetimi nr. {\*\*\*} prot., datë 11.01.2023, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, mbi pagën e subjektit në periudhën tetor – dhjetor 2004; (ii) raport vlerësimi i përgatitur nga ekspert B. M., për pronat e llojit “Ullishte” të z. I. M., me vendndodhje {\*\*\*}, Vlorë dhe ana e detit, {\*\*\*}, Vlorë; (iii) relacion nr. {\*\*\*} prot., datë 24.01.2023, i Njësisë Administrative Maminas, për të ardhurat vjetore nga tokat bujqësore të z. B. H.; (iv) kontratë cedimi të të

parashtrimet e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, në Kolegj, administruar me nr. {\*\*\*} prot., datë 26.01.2023, të individualizuara prej saj, për arsye dokumentimi dhe gjatë seancës gjyqësore publike, duke i bërë ato pjesë të shqyrtimit gjyqësor. Në seancën gjyqësore publike të datës 13.02.2023, në bisedimet përfundimtare, Komisioneri Publik përfundimisht kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 287, datë 04.08.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Mici, ndërsa subjekti i rivlerësimit kërkoi lënien në fuqi të vendimit të Komisionit.

A. *Vlerësimi i Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të pasurisë*

12. *Për pasurinë apartament banimi me sipërfaqe totale 104.33 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë, lidhur me burimin “kursime familjare në shumën 5.000 euro”, Komisioneri Publik në ankim ka pretenduar se: i) subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarime të pasakta në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006, si dhe deklarime kontradiktore gjatë hetimit administrativ në Komision mbi*

---

*drejtave të aktmarrëveshjes nr. rep {\*\*\*}, nr. kol. {\*\*\*}, datë 06.11.2012, së bashku me aktmarrëveshjen, planimetri, mandatpagesa [nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 07.06.2017]; (v) deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.07.2013, e z. L. H. dhe shoqërisë ndërtimore “{\*\*\*}” ShPK; deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 23.05.2013, e z. P. Q., M. K. (Q.), F. K. dhe shoqërisë ndërtimore “{\*\*\*}” ShPK; kontratë sipërmarrjeje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 29.09.2006, e shoqërisë ndërtimore “{\*\*\*}” ShPK dhe P. Q. dhe M. K., pagesë e brendshme e Raiffeisen Bank ShA, datë 10.05.2012, e z. F. K., mandatarkëtimi lëshuar për z. F. K.; aktmarrëveshje për kalim të drejtash pronësie nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.07.2012, nënshkruar mes shoqërisë ndërtimore “{\*\*\*}” ShPK, F. D., P. U.; kontratë sipërmarrjeje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 18.08.2006, mes shoqërisë ndërtimore “{\*\*\*}” ShPK dhe F. D.; kontratë sipërmarrjeje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 12.04.2012, mes shoqërisë ndërtimore “{\*\*\*}” ShPK dhe Q. Sh.; kontratë sipërmarrjeje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.08.2012, mes shoqërisë ndërtimore “{\*\*\*}” ShPK dhe z. Th. N.; kontratë porosie nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 09.03.2011, mes shoqërisë ndërtimore “{\*\*\*}” ShPK dhe z. E. R.; kontratë porosie nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.03.2011, mes shoqërisë ndërtimore “{\*\*\*}” ShPK dhe z. A. D.; kontratë porosie nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 13.01.2011 mes shoqërisë ndërtimore “{\*\*\*}” ShPK dhe S. Q., -- deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 25.10.2010, e deklaruesve Th. Q., V. Z., V. A.; (vi) vendim civil nr. {\*\*\*}, datë 09.11.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, paditës Dh. M. dhe e paditur N. Z. (B.), me objekt zgjidhje kontrate sipërmarrjeje dhe kthim shume; (vii) shkresa nr. {\*\*\*} prot., datë 26.01.2023, e Këshillit të Qarkut Vlorë dhe nr. {\*\*\*} prot., datë 26.01.2023, Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës, Këshilli i Qarkut Vlorë; (viii) urdhër nr. {\*\*\*}, datë 31.12.2014, “Për miratimin e dhënies së lejes së veçantë për të burgosurin”, Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale (në vijim “IEVP”) Fushë Krujë; urdhër nr. {\*\*\*} prot., datë 18.09.2015; urdhër nr. {\*\*\*}, datë 02.07.2016; urdhër nr. {\*\*\*} prot., datë 09.10.2016; urdhër nr. {\*\*\*} prot., datë 07.10.2016; urdhër nr. {\*\*\*} prot., datë 06.08.2015; urdhër nr. {\*\*\*} prot., datë 19.09.2016; urdhër nr. {\*\*\*} prot., datë 31.12.2015; urdhër nr. {\*\*\*} prot., datë 20.09.2015, “Për miratimin e dhënies së lejes së veçantë për të burgosurin” e IEVP Durrës; (ix) vlerësime nga IEVP Durrës, si: “Vlerësim sjelljeje për në gjykatë” nr. {\*\*\*} prot., datë 30.11.2016, me objekt “Ulje dënimi”; “Vlerësim sjelljeje” nr. {\*\*\*} prot., datë 07.10.2016, me objekt “Leje të veçantë”; “Vlerësim sjelljeje” nr. {\*\*\*} prot., datë 01.09.2016; “Vlerësim sjelljeje për në gjykatë” nr. {\*\*\*} prot., datë 11.07.2016, me objekt “Lirim para kohe me kusht, neni 64 i Kodit Penal”; “Vlerësim sjelljeje për në gjykatë” nr. {\*\*\*} prot., datë 10.09.2016, me objekt “Ulje dënimi”; “Vlerësim sjelljeje për në gjykatë” nr. {\*\*\*} prot., datë 13.04.2016, me objekt “Ulje dënimi”; “Vlerësim sjelljeje” nr. {\*\*\*} prot., datë 08.07.2016; “Vlerësim sjelljeje” nr. {\*\*\*} prot., datë 20.01.2016, me objekt “Leje të veçantë”; “Vlerësim sjelljeje” nr. {\*\*\*} prot., datë 19.01.2016; “Vlerësim sjelljeje” nr. {\*\*\*} prot., datë 17.03.2016, me objekt “Leje të veçantë”; “Vlerësim sjelljeje” nr. {\*\*\*} prot., datë 01.09.2016; “Vlerësim sjelljeje” nr. {\*\*\*} prot., datë 03.07.2015, me objekt “Për transferim për të dënuarin L. B.” nga IEVP, Fushë Krujë; “Vlerësim sjelljeje për në gjykatë” nr. {\*\*\*} prot., datë 05.02.2015, me objekt “Ndryshim sigurie”, nga IEVP Fushë Krujë; “Vlerësim sjelljeje” nr. {\*\*\*} prot., datë 17.03.2015, IEVP, Fushë Krujë; “Vlerësim sjelljeje për në gjykatë” nr. {\*\*\*} prot., datë 22.07.2015, me objekt “Ulje dënimi”, nga IEVP, Durrës; “Vlerësim sjelljeje për transferim” nr. {\*\*\*} prot., datë 20.03.2011, nga IEVP, Peqin; “Vlerësim sjelljeje” nr. {\*\*\*} prot., datë 18.03.2014, me objekt “Ulje dënimi”, nga IEVP, Fushë Krujë; “Vlerësim sjelljeje” nr. {\*\*\*} prot., datë 17.01.2014, IEVP, Fushë Krujë; “Vlerësim sjelljeje” nr. {\*\*\*} prot., datë 16.09.2013, IEVP, Fushë Krujë; Raporti i vlerësimit të sjelljes për transferim nr. {\*\*\*} prot., datë 27.01.2012, IEVP, Tiranë; “Vlerësim sjelljeje” nr. {\*\*\*} prot., datë 14.11.2011, IEVP, Tiranë; “Vlerësim sjelljeje” nr. {\*\*\*} prot., datë 10.11.2010, IEVP Tiranë; “Vlerësim sjelljeje” nr. {\*\*\*} prot., datë 19.05.2011, IEVP Tiranë; “Vlerësim sjelljeje” nr. {\*\*\*} prot., datë 10.05.2010, IEVP Tiranë; “Vlerësim sjelljeje” nr. {\*\*\*} prot., datë 16.09.2013, IEVP Fushë Krujë; “Vlerësim sjelljeje” nr. {\*\*\*} prot., datë 20.09.2012, IEVP Fushë Krujë.*

shlyerjen e pagesës 5.000 euro; ii) në konsideratë të jurisprudencës së deritanishme të Kolegjit<sup>15</sup>, për deklarimin e likuiditeteve *cash* në deklaratat periodike vjetore, Komisioni duhet të kishte mbajtur një qëndrim ndryshe duke përfshirë në analizë vetëm sa ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë 2006. Shuma 500.000 lekë duhet konsideruar shtesë e likuiditeteve *cash* në këtë vit, ashtu sikurse është deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën periodike vjetore 2006; iii) subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme pagesën e shumës 5.000 euro, të kryer më datë 21.03.2006. Nga llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, deri në këtë datë kur është kryer pagesa 5.000 euro, rezulton të jenë tërhequr në total rreth 250.000 lekë, të cilat nuk janë të mjaftueshme për kryerjen e pagesës 5.000 euro dhe për mbulimin e shpenzimeve familjare deri në këtë datë. Në analizë të këtyre pretendimeve, trupi gjykues konstaton:

**12.1.** Apartamenti është porositur nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. Dh. M., me kontratën e sipërmarrjes nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 02.03.2006, nënshkruar mes tij dhe palës sipërmarrëse, N. B. Z., investitore në pallatin që po ndërtohej nga shoqëria “{\*\*\*}” ShPK<sup>16</sup>, në vlerën 75.000 euro. Shlyerja e çmimit të apartamentit sipas kontratës, është parashikuar: më datë 27.02.2006, porositësi i ka dorëzuar investitores shumën prej 25.000 eurosh, me mandatin nr. {\*\*\*}, datë 27.02.2006, ndërsa pjesa tjetër do të paguhej nga porositësi me marrjen e kredisë nga NBG Bank ShA.

**12.2.** Për financimin e kredisë nënshkruhet “Kontratë kredie bankare” nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.03.2006, mes Bankës Kombëtare të Greqisë ShA (NBG), në cilësinë e kredihënësit, kredimarrësve Anita Mici, Dh. M. dhe dorëzanës J. H., për dhënien e kredisë në shumën 45.000 euro, me afat 20 vjet dhe qëllim blerjen e një shtëpie me adresë në Tiranë. Për garantimin e shlyerjes së kredisë, rezulton të jetë vendosur si garanci hipotekore, apartamenti i ndodhur në bulevardin “Bajram Curri”, pranë KESH-it, në pronësi të dorëzanësit J. H.. Informacion mbi këtë kredi përcjell edhe Banka Amerikane e Investimeve [Abi Bank] ShA<sup>17</sup> nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 24.12.2018, ku informon Komisionin se Anita Mici aktualisht ka një llogari kredie në monedhën euro, hapur më datë 15.03.2006, pasi ka marrë kredinë hipotekore në shumën 45.000 euro, me afat maturimi 20-vjeçar, bashkëmbajtës i llogarisë së kredisë është edhe Dh. M.. Sipas lëvizjeve të llogarisë bankare, kredia është disbursuar më datë 21.03.2006 dhe po në këtë datë, është tërhequr *cash*.

**12.3.** Në kuadër të detyrimit për deklarim, trupi gjykues konstaton se ky apartament dhe burimi i krijimit të tij janë deklaruar për herë të parë nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e interesave privatë 2006, si vijon: *Prenotuar apartament me sipërfaqe 104,33 m<sup>2</sup> në Tiranë, sipas kontratës nr. {\*\*\*}, datë 02.03.2006, me vlerë totale 75.000 euro, ku është paguar cash vlera 25.000 euro ose 3.000.000 lekë, dhënë nga babai si rezultat i ndarjes familjare për blerjen e apartamentit (shtëpi më vete) nga shitja e pronave të trashëguara.* Në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit deklaroi kredinë e marrë në Bankën Kombëtare të Greqisë për blerjen e apartamentit, në shumën 45.000

<sup>15</sup> Referojuni vendimit (JR) nr. 11/2019, në pikën 27.12.18, paragrafi 27; vendimit (JR) nr. 19/2019, paragrafi 84; vendimit (JR) nr. 20/2019, paragrafi 59; vendimit (JR) nr. 7/2019, paragrafi 39; vendimit (JR) nr. 27/2020, paragrafi 19.4.

<sup>16</sup> Kontratë sipërmarrjeje për ndërtim nr. {\*\*\*} rep., datë 22.08.2005, nënshkruar mes investitores N. Z. dhe ndërtuesit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, për ndërtimin e godinës së banimit në rrugën “{\*\*\*}”, Tiranë. Kontratë sipërmarrjeje [nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.08.2005] për ndërtim, mes investitores N. Z. dhe ndërtuesit shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, me objekt përcaktimin e kushteve dhe detajimi i detyrimeve të investitorit dhe ndërtuesit.

<sup>17</sup> Banka NBG Albania ShA është përthithur nga Banka Amerikane e Investimeve ShA.

euro, sipas kontratës nr. {\*\*\*}, datë 14.03.2006.

Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit deklaroi se prej vitit 2006, banon në shtëpinë e të vëllait, J. H., në adresën, bulevardi “Bajram Curri”, pranë KESH-it, Tiranë, i lënë si garanci për huan e financuar nga NBG Bank ShA. Ndërsa personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit, deklaroi kontratën e sipërmarrjes, datë 2.03.2006, për blerjen e apartamentit me sipërfaqe 104,33 m<sup>2</sup>, në vlerën 75.000 euro, me burim krijimi: *kredinë bankare në NBG Bank, në shumën 45.000 euro, kursimet familjare dhe ndihmë nga prindërit*. Në rubrikën e rezervuar për të dhëna konfidenciale, personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit) deklaroi se për vlerën 75.000 euro, 45.000 euro janë marrë kredi, 5.000 euro nga kursimet familjare dhe diferenca prej 25.000 eurosh ndihmë nga babai, si rezultat i ndarjes nga familja.

**12.4.** Lidhur me mospërputhjet e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit për likuidimin e shumës 5.000 euro, ku në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006, nuk deklaroi detyrim të mbetur, ndërkohë që në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, deklaroi se shuma 5.000 euro nuk është likuiduar, më pas me përgjigjet e pyetësorit nr. 5, subjekti i rivlerësimit shpjegoi se i qëndron deklaramit periodik në vitin 2006 dhe se nuk kishte detyrim të mbetur ndaj znj. N. B. (Z.) për prenotimin e apartamentit, pasi shuma prej 5.000 eurosh ishte shlyer në të njëjtën ditë me disbursimin e kredisë bankare, në numrin personal të llogarisë së investitores. Subjekti i rivlerësimit sqaroi se në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, u ishte referuar deklarimeve të bashkëshortit, i cili nuk mbante në kujtesë shlyerjen e detyrimit 5.000 euro për likuidimin e çmimit të apartamentit, pasi nuk kishte ruajtur aktin që e vërtetonte dhënien e kësaj shume dhe gabimisht ishte përgjigjur se nuk është shlyer kjo shumë. Në përgjigje të pyetësorit nr. 5, datë 06.04.2020, lidhur me burimin e ligjshëm të shumës 5.000 euro, subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se pagimi i kësaj shume përputhet dhe me deklaramin periodik të vitit 2006, në zërin “kursime familjare”, si pjesë e të ardhurave të përdorura për pagimin e apartamentit, si dhe me faktin se në deklaramin periodik të dorëzuar më datë 26.03.2007, është pakësuar gjendja “cash” në banesë në masën 450.000 lekë, shumë e cila është përdorur në atë kohë për plotësimin e detyrimit prej 5.000 eurosh ndaj shtetasës N. B. (Z.).

**12.5.** Me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, depoziton dokumentacionin financiar për pagesat e kryera për likuidimin e çmimit të apartamentit objekt shqyrtimi që ajo dhe bashkëshorti kanë kryer ndaj investitores N. Z. (B.)<sup>18</sup>, konkretisht: i) mandatar-këtimin [{\*\*\*}] e datës 21.03.2006, për pagesën 5.000 euro, me përshkrimin: “Pagesë për blerje apartamenti”; ii) mandatpagesën [{\*\*\*}] për tërheqjen e shumës 45.000 euro nga llogaria e kredisë së Anita B. Mici dhe Dh. I. M. më datë 21.03.2006; dhe iii) mandatar-këtimin [{\*\*\*}] po të datës 21.03.2006, me përshkrimin “Kalim kredie” në llogarinë e bashkëshortëve Mici, si dhe mandatpagesën për komisionin e disbursimit në shumën 675 euro; iv) mandatar-këtimin [{\*\*\*}] e datës 21.03.2006, për transferimin e shumës 44.325 euro në llogari të znj. N. B. (Z.), me përshkrimin: “Për blerje apartamenti”.

**12.6.** Në kushtet kur nga deklarimi në deklaratat e interesave privatë 2006, deklaratën e pasurisë *vetting*, si dhe nga dokumentacioni financiar i depozituar, provohet që shuma 5.000 euro është paguar më datë 21.03.2006, trupi gjykues mori në analizë pretendimet e Komisionerit Publik në ankim, lidhur me burimin e krijimit të shumës 5.000 euro, nga ku konstatoi si vijon.

**12.6.1.** Në deklarimin e bërë në vitin 2004, që është dhe deklarata e parë e pasurisë e plotësuar nga

<sup>18</sup> Sipas ekstraktit historik, shoqëria “{\*\*\*}” ShPK, e regjistruar më 07.11.2003, me NUIS {\*\*\*}, ka pasur ortak të vetëm znj. N. B..

subjekti i rivlerësimit, në faqe të parë ku pasqyrohen llojet e deklaramit (i. deklarim i parë apo para fillimit të punës; ii. deklarim vjetor; iii. deklarim pas largimit nga funksioni; iv. deklarim me kërkesë), subjekti ka zgjedhur *deklarim i parë apo para fillimit të detyrës*. Në këtë deklarim, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklaronte deri më 31.12.2004, të gjitha pasuritë e akumuluarra ndër vite, detyrimet financiare, burimet dhe origjinën e pasurisë së vetë subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur. Nga sa rezulton, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar likuiditete, kursime në *cash*, e nuk ka deklaruar as të ardhurat sipas kërkesës së deklaratës, ku specifikohet: *Kujtesë: Në deklaramin e parë apo para fillimit të detyrës, subjekti duhet të deklarojë edhe të ardhurat e realizuara në përgjithësi ndër vite: personale, të bashkëshortit/es dhe fëmijëve që ka në përbërjen familjare*. Në këtë rubrikë, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Anita Micaj (Mici) 40.000 lekë në muaj, nga Shkolla e Magjistraturës*, dhe në rubrikën e të dhënave konfidenciale, ka deklaruar të ardhurat nga paga si gjyqtare për periudhën tetor 2004 – mars 2005, në vlerën 400.299 lekë.

**12.6.2.** Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2005, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Likuiditete në cash, 950.000 lekë. Pjesa takuese: 50%*. Në këtë deklaratë, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar burimin e krijimit, për të korrigjuar kështu mosdeklarimin e kësaj shume në vitin paraardhës.

**12.6.3.** Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *Cash në shtëpi nga kursimet e 2006-ës, 500.000 lekë. Pjesa takuese: 50%*.

**12.7.** Gjatë hetimit administrativ në Komision dhe me parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit sqaron se gjendja *cash* në masën 950.000 lekë, e deklaruar në deklaratën e interesave privatë 2005, është diferenca ndërmjet të ardhurave dhe shpenzimeve, shtrirë ndër vite deri më datë 31.12.2005, për të cilën burim krijimi kanë shërbyer të ardhurat e ligjshme, nga paga si oficere e policisë gjyqësore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, bursa nga Shkolla e Magjistraturës dhe paga si gjyqtare (stazhiere) në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës. Për shkak të mungesës së përvojës, subjekti i rivlerësimit sqaron se nuk ka deklaruar më parë gjendjen *cash* të akumuluar, por e ka deklaruar më 04.03.2006, në shumën 950.000 lekë, që përfshin kursimet e mëparshme deri më 31.12.2005. Deklarimi në deklaratën e interesave privatë 2006: *Cash në shtëpi nga kursimet e 2006-ës, në shumën 500.000 lekë*, sipas subjektit të rivlerësimit, përbën gjendjen e mbetur nga shuma 950.000 lekë, deklaruar në deklaratën e interesave privatë 2006, dhe përcakton pakësim të gjendjes *cash* në shtëpi dhe jo shtesa. Likuiditeti *cash*, në shumën 950.000 lekë në fund të vitit 2005, është përdorur për të kryer pagesën 5.000 euro të datës 21.03.2016, dhe në fund të këtij viti, nga të ardhurat nga pagat, është krijuar përsëri një gjendje *cash* në vlerën 500.000 lekë, si deklaruar në vitin 2006, pra është gjendja në fund të vitit 2006 dhe nuk është përdorur fjala shtim apo pakësim. Fakti që gjendja *cash* në fund të vitit 2006 është 500.000 lekë, tregon me fjalë të tjera se gjatë vitit 2006, është pakësuar në vlerën 450.000 lekë. Për këtë pretendim, subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje jurisprudencën<sup>19</sup> e Kolegjit, se ndreqja e pasaktësive të një deklarate vjetore jashtë procesit të rivlerësimit nuk përbën shkak për marrjen e masës disiplinore.

**12.8.** Në kushtet kur, në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, deklaratat e pasurisë dhe të interesave privatë mund të përdoren si provë gjatë procesit të rivlerësimit, pakësimi i gjendjes *cash*

<sup>19</sup> Vendimi (JR) nr. 33, datë 03.11.2021, paragrafët 44 dhe 45; vendimi (JR) nr. 20, datë 31.07.2019, paragrafi 67; vendimi (JR) nr. 37, datë 24.11.2021, paragrafi 10.42; vendimi (JR) nr. 35, datë 22.09.2022, i Kolegjit të Posaçëm të Apëlimit.

450.000 lekë, pretenduar nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ, me sqarimin se shuma 500.000 lekë në fund të vitit 2006 përbën diferencën e mbetur nga gjendja *cash*, 950.000 lekë, deklaruar në fund të vitit 2005, nuk rezulton të jetë deklaruar si i tillë në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006. Për më tepër, mënyra si shprehimisht deklaroi subjekti i rivlerësimit: *Cash në shtëpi nga kursimet e 2006-ës*, tregon shtesë të likuiditeteve në vitin 2006, nga kursimet e këtij viti. Në këto kushte, shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision dhe në parashtrimet në Kolegj, nuk e kalojnë pragun deklarativ pasi nuk mbështeten në prova, dhe trupi gjykues, me konsideratë edhe jurisprudencën e tij<sup>20</sup>, gjen të bazuar pretendimin e Komisionerit Publik lidhur me deklarimin e likuiditeteve në *cash* në deklaratat periodike vjetore, se Komisioni duhet të kishte mbajtur një qëndrim ndryshe, duke e konsideruar shumën 500.000 lekë, shtesë të likuiditeteve *cash* në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006.

**12.9.** Nisur nga fakti që subjekti i rivlerësimit pretendon se shuma 5.000 euro të ketë si burim gjendjen e kursimeve *cash* të deklaruara në deklaratën e interesave privatë 2005, në shumën 950.000 lekë, në Kolegj u krye analiza financiare për të verifikuar mundësinë e subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur me të për t'i krijuar këto kursime me të ardhura nga burime të ligjshme. Rezultatet e analizës së kryer për vitet 2000 – 2004, treguan pamjaftueshmëri të burimeve financiare në vlerën (-) 385,972 lekë, ndërkohë që për vitet 2000 – 2005, mundësia e kursimit rezultoi vetëm 150.287 lekë, nga 950.000 lekë të pretenduara. Nëse shuma 950.000 lekë konsiderohet e krijuar në vitin 2005, analiza financiare e këtij viti tregoi pamjaftueshmëri në vlerën (-) 413,741 lekë, ndërsa ajo e vitit 2006, duke përfshirë shumën e kursimeve 500.000 lekë të këtij viti, rezultoi në vlerën negative (-) 1.186.177 lekë. Në këto kushte, trupi gjykues konkludon se subjekti i rivlerësimit rezulton me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vitin 2006, për pagesën e shumës 5.000 euro nga “kursime familjare”, si burim krijimi për këtë pasuri, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

**12.10.** Për më tepër, nga analizimi i lëvizjeve të llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, përcjellë në Komision nga bankat e nivelit të dytë, Tirana Bank ShA dhe Raiffeissen Bank ShA përkatësisht, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, ka tërhequr nga llogaria e saj e pagave në Tirana Bank ShA, për periudhën janar – 21 mars 2006, shumën 106.000 lekë, ndërsa bashkëshorti ka tërhequr nga llogaria e tij në Raiffeissen Bank ShA, shumën 148.600 lekë. Totali i shumave të tërhequra nga gjendja e likuiditeteve në bankë për periudhën 01.01.2006 - 21.03.2006, prej 254.600 lekësh (148.600 + 106.000 ), nuk ka qenë i mjaftueshëm për të justifikuar likuidimin e shumës 5.000 euro nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në këtë datë. Subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, nuk mund të justifikojë pagesën e kësaj shume as me kursimet e vitit 2005, si pretenduar prej saj në përgjigjet e pyetësorit nr. 5, datë 06.04.2020, në kushtet kur rezultatet e analizës financiare të kryer në Kolegj, kanë treguar se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk mund të krijojnë kursime në shumën 950.000 lekë në këtë vit, kur rezultojnë me mungesë burimesh të ligjshme në shumën (-) 413.741 lekë, ndërkohë deklarojnë diferencën 500.000 lekë, si gjendje *cash* në banesë, në fund të vitit 2006.

13. Lidhur me burimin e deklaruar si “ndihmë nga babai i personit të lidhur në shumën 25.000 euro ose 3.000.000 lekë”, Komisioneri Publik ka ngritur në ankim këto pretendime: i) pagesa e tatimit për

<sup>20</sup> Referojuni vendimit (JR) nr. 11/2019, në pikën 27.12.18, paragrafi 27; vendimit (JR) nr. 19/2019, paragrafi 84; vendimit (JR) nr. 20/2019, paragrafi 59; vendimit (JR) nr. 7/2019, paragrafi 39; vendimit (JR) nr. 27/2020, paragrafi 19.4.

këto të ardhura është bërë në datën 24.07.2020, gjatë procesit të rivlerësimit, dhe, bazuar në jurisprudencën e Kolegjit<sup>21</sup>, konsiderohet e paefektshme në funksion të procesit të rivlerësimit dhe, si e tillë, kjo shumë nuk duhet përfshirë në mesin e burimeve të të ardhurave të ligjshme që kanë shërbyer për pagesën e apartamentit me sipërfaqe 104,33 m<sup>2</sup>; ii) rezulton e paprovuar mënyra e përfitimit/transaksioni i kryer, i cili lidh burimin e ligjshëm të të ardhurave, nga kontratat e shitjes të vitit 1995 dhe 2000, me dhurimin prej 3.000.000 lekësh në vitin 2006; iii) kontratat e shitjeve të pasurive të paluajtshme në periudhën 1995-2006, të realizuara nga babai i bashkëshortit, I. M., të ardhurat nga të cilat pretendohen si burim i ligjshëm për dhurimin e kësaj shume, rrjedhin nga një titull i pronësisë së subjektit të shpronësuar, shtetasi F. M. (disa trashëgimtarëve të tij) dhe një titull pronësie në emër të shtetasit I. M.. Trupi gjykues në analizë të këtyre pretendimeve, konstaton:

**13.1.** Komisioni, në vendim, ka arsyetuar se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në kohë reale shumën 3.000.000 lekë. Megjithëse forma e dhënies nuk është kryer si një dhurim i mirëfilltë, marrëdhënia e posaçme familjare *babë e bir* në këtë rast, nuk mund ndikohet, për sa kohë provohet burimi i ligjshëm i krijimit të shumës së dhënë. Përderisa për këtë të ardhur është paguar tatimi, vlerësimi ndryshe do të çonte në kushtet e tatimit të dyfishtë, veprim që shkon përtej parashikimit ligjor. Tjetërsimi i pasurisë ka ndodhur nga vjehri i subjektit dhe, për pasojë, edhe tatimi është paguar prej tij, ndërsa shuma e dhuruar është një e ardhur neto që buron nga tjetërsimi. Komisioni me kompetencat që i jep Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016, pa u kushtëzuar nga informacioni i përcjellë nga organi tatimor, por as nga veprimet e ndërmarra nga subjekti, duke u bazuar në legjislacionin e fushës, konkludon se kjo e ardhur nuk mund t'i nënshtrohet tatimit. Për çdo interpretim ndryshe apo boshllëk ligjor, nëse kjo e ardhur do t'i nënshtrohej tatimit, Komisioni ka konstatuar se legjislacioni tatimor me zhvillimet e tij, ka synuar të qartësojë përjashtimin nga ky tatim rastet që vijnë kryesisht nga marrëdhëniet familjare.

**13.2.** Në analizë të deklaratave të pasurisë, trupit gjykues të Kolegjit i rezulton i provuar fakti i deklaramit të kësaj shume si në deklaratën e pasurisë *vetting*, ashtu dhe në deklaratën e interesave privatë 2006.

*i.* Në deklaratën e pasurisë *vetting*, personi i lidhur deklaroi “ndihmë nga prindërit”, si burim për krijimin e pasurisë objekt shqyrtimi, dhe në rubrikën e rezervuar për të dhënat konfidenciale, e deklaroi shumën 25.000 euro ndihmë nga babai, si rezultat i ndarjes nga familja. Lidhur me këtë shumë, babai ka përdorur të ardhurat nga kontrata e shitjes nr. {\*\*\*} rep./kol., datë 29.11.1995, në shumën 100.000 USD (pronë e trashëguar dhe kthyer nga Komisioni i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave Ish-Pronarëve (në vijim “KKKP”), sipas vendimit nr. {\*\*\*}, datë 16.10.1995), kontrata e shitjes nr. {\*\*\*} rep./kol., datë 22.08.2000, në shumën 4.500.000 lekë (pronë e trashëguar dhe e kthyer nga KKKP-ja sipas vendimit nr. {\*\*\*}, datë 30.05.1995). Babai i personit të lidhur është trashëgimtar i vetëm i testamentarit F. M., për pasuritë e paluajtshme të rifituara nëpërmjet vendimit të KKKP-së. Këto prona për efekt trashëgimie, kanë kaluar në pronësi individuale të babait të personit të lidhur, z. I. M..

*ii.* Në deklaratën e interesave privatë të vitit 2006, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *3.000.000 lekë, dhënë nga babai si rezultat i ndarjes familjare, për blerjen e apartamentit (shtëpi më vete) nga shitja e pronave të tij të trashëguara.*

**13.3.** Në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, për shkak të shumës së dhuruar prej 25.000

---

<sup>21</sup> Referojuni vendimit (JR) nr. 8/2019, paragrafi 63; vendimit (JR) nr. 5/2020, paragrafi 41.9; vendimit (JR) nr. 23/2020, paragrafi 24.13.

eurosh, e barasvlefshme me shumën 3.000.000 lekë, babai i bashkëshortit të subjektit kualifikohet si person tjetër i lidhur. Në këto kushte, si me deklaratën e pasurisë *vetting*, ashtu dhe gjatë hetimit administrativ në Komision, për të provuar pronësinë e vjehrrit të subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Mici, mbi këto pasuri dhe shitjet e tyre, subjekti i rivlerësimit ka depozituar akte shkresore për të provuar pronësinë e vjehrrit të saj mbi disa pasuri të paluajtshme, si dhe tjetërsimin e disa prej tyre, shërbyer si burim për dhënien e shumës 25.000 euro, konkretisht:

i. Procesverbal çelje testamenti nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 07.11.1994<sup>22</sup>, për çeljen e testamentit olograf, të lënë nga i ndjeri F. M., vdekur më 04.09.1983, duke disponuar të gjithë pasurinë e tij në emër të të birit, I. M..

ii. Vendim nr. {\*\*\*}, datë 30. 05. 1995, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” i KKKP-së, Bashkia Vlorë, me të cilin ka vendosur të njohë si ish-pronarë të pronës shtetasit F. M. dhe A. M. (trashëgimtarët e tij), të katit të poshtëm të një shtëpie në lagjen “{\*\*\*}” dhe pikërisht dy dhoma të ndara që kanë qenë në përdorim si kafene më parë, një sipërfaqe trualli prej 890 m<sup>2</sup>, në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë, të kthejë në natyrë katin e poshtëm të një shtëpie dykatëshe në lagjen “{\*\*\*}”, të kthejë në natyrë në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë, 3500 m<sup>2</sup>, të kthejë në natyrë sipërfaqen 3286 m<sup>2</sup>, në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë, të kompensojë sipërfaqen e truallit prej 2114 m<sup>2</sup>.

iii. Vendim nr. {\*\*\*}, datë 16.10.1995, “Për kthimin dhe kompensimin e pronave” i KKKP-së, Bashkia Vlorë, i cili vendosi të njohë si ish-pronar shtetasin I. M., mbi një sipërfaqe trualli me sipërfaqe 1870 m<sup>2</sup>, në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë, të kthejë në natyrë këtë sipërfaqe. Pasuri që sipas vërtetimit hipotekor është regjistruar në regjistrat e transkriptimeve nr. {\*\*\*}, datë 27.11.1995.

iv. Vërtetim pronësie, datë 10.04.1996, i Zyrës së *Hipotekës*, sipas të cilit vërtetohet se në regjistrat e pasurive të paluajtshme në emër të shtetasit I. F. M.<sup>23</sup>, janë të regjistruara pasuritë e fituara me trashëgimi nga prindërit F. dhe A. M., konkretisht: 1. kati i poshtëm i një shtëpie banimi, ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë, pikërisht dy dhomat e ndara që kanë qenë përdorur si kafene më parë; 2. truall i ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë, me sipërfaqe 3500 m<sup>2</sup>; 3. truall i ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë, me sipërfaqe 3286 m<sup>2</sup>.

v. Kontratë shitblerjeje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 29.11.1995, me të cilën I. M.<sup>24</sup> i shet shtetasit M. G., truallin 1870 m<sup>2</sup> të ndodhur në lagjen “{\*\*\*}”, Vlorë, në vlerën 100.000 USD. Pasuri e cila transkribohet në emër të blerësit në regjistrat nr. {\*\*\*}, datë 29.11.1995.

vi. Kontratë shitjeje e datës 13.04.1996, nënshkruar mes shitësit I. M. dhe blerësit N. B., të truallit me sipërfaqe 350 m<sup>2</sup>, në vlerën 1.155.000 lekë. Pasuri e regjistruar në emër të blerësit me nr. {\*\*\*}, datë 18.04.1996.

vii. Kontratë shitjeje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 14.08.1996, nënshkruar mes shitësit I. M. dhe blerësit O. S., të truallit me sipërfaqe 150 m<sup>2</sup>, në vlerën 450.000 lekë.

---

<sup>22</sup> I përcjellë dhe me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.01.2019, të ZVRPP Vlorë.

<sup>23</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 28.12.2018, të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile, referuar regjistrin marrë nga Arkiva Digjitale e Gjendjes Civile, rruga “{\*\*\*}”, P. {\*\*\*}, Sh. {\*\*\*}, Ap. {\*\*\*}, gjendet shënimi “Dh-26, datë 26.08.2005 [...] mbiemri nga “M.” në “M.”<sup>23</sup>. Sipas certifikatave të përbërjes familjare të vitit 2010, të përcjella me këtë shkresë, mbiemri i prindërve të bashkëshortit të subjektit vijon “M.”, ndërsa i anëtarëve të familjes së subjektit të rivlerësimit “M.”.

<sup>24</sup> Në nënshkrimin e kësaj kontrate dhe të tjerave në vijim z. I. M. është përfaqësuar nëpërmjet prokurës nr. {\*\*\*} rep., datë 24.11.1995, nga Dh. M..



viii. Kontratë shitblerjeje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 30.12.1997, nëpërmjet së cilës I. M. i shet shtetasit L. D., truallin me sipërfaqe 300 m<sup>2</sup>, në vlerën 600.000 lekë. Pasuri e regjistruar në emër të blerësit nr. {\*\*\*}, datë 30.12.1997.

ix. Kontratë shitblerjeje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 30.12.1997, nëpërmjet së cilës z. I. M. i shet shtetasit S. D., truallin në sipërfaqe 216 m<sup>2</sup>, në vlerën 400.000 lekë. Pasuri e regjistruar në emër të blerësit me nr. {\*\*\*}, datë 30.12.1997.

x. Kontratë shitblerjeje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 07.01.1998, nëpërmjet së cilës Dh. M., si përfaqësues me prokurë i babait të tij, z. I. M., i shet shtetasit D. B. truallin në sipërfaqe 308 m<sup>2</sup>, në vlerën 1.694.000 lekë. Pasuri e regjistruar në emër të blerësit me nr. {\*\*\*}, datë 07.01.1998.

xi. Kontratë shitblerjeje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.06.1998, nëpërmjet së cilës I. M. i shet shtetasit M. S., truallin me sipërfaqe 230 m<sup>2</sup>, në vlerën 1.260.000 lekë. Pasuri e regjistruar në emër të blerësit me nr. {\*\*\*}, datë 02.07.1998.

xii. Aktmarrëveshje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 24.07.2000, nëpërmjet së cilës I. M. i shet shtetasit B. Xh. truallin me sipërfaqe 120 m<sup>2</sup>, në vlerën 1.000.000 lekë.

xiii. Kontratë shitblerjeje pasurie nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.08.2000, nëpërmjet së cilës z. I. M. i shet shtetasit A. G., truallin me sipërfaqe 900 m<sup>2</sup>, në vlerën 4.500.000 lekë.

**13.4.** Së bashku me deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit depoziton dhe deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.01.2017, të shtetasit I. M., i cili deklaroi se i ka dhuruar të birit, Dh. M., një shumë prej 25.000 eurosh në fillim të vitit 2006, në momentin e nevojës për blerjen e apartamentit në Tiranë, në kohën kur i biri u nda për të jetuar si familje më vete. Si burim, deklaruesi përmend shitjet e tokës truall të përfituruar me vendime të KKKP-së, Vlorë dhe trashëguar nga i ati, F. M..

**13.5.** Në analizë të shkaqeve ankimore të Komisionerit Publik, trupi gjykues konstaton se, si burim për shumën 3.000.000 lekë, ose 25.000 euro, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit deklaroi të kenë shërbyer të ardhurat nga kontrata e shitjes nr. {\*\*\*} rep./kol., datë 29.11.1995, në shumën 100.000 USD dhe kontrata e shitjes nr. {\*\*\*} rep./kol., datë 22.08.2000, në shumën 4.500.000 lekë. Gjatë hetimit administrativ, në përgjigjet e datës 20.02.2020, të pyetësorit nr. 4, subjekti sqaron se shitjet sipas këtyre dy kontratave, janë krijuar para martesës dhe i janë dhënë bashkëshortit Dh. M. si ndihmë për blerjen e shtëpisë, pas ndarjes nga trangu familjar. Në kushtet kur babai i bashkëshortit të subjektit nuk ka qenë subjekt deklarues dhe, në periudhën e kryerjes së këtyre transaksioneve, nuk ka pasur detyrim ligjor që pagesa të bëhej nëpërmjet sistemit bankar, si dhe në kushtet kur nuk është provuar që shumat e përfitura të jenë mbajtur në llogari bankare, në vlerësim të trupit gjykues, duket që pamundëson provimin e lidhjes së të ardhurave nga shitjet me shumën e dhuruar prej 3.000.000 lekësh. Megjithatë, ky konstatim nuk mund të bëjë inekzistente këtë shumë, e cila është deklaruar si në deklaratën e interesave private të vitit 2006, ashtu dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, së bashku me burimin e krijimit të kësaj shume nga shitja e pronave të trashëguara.

**13.6.** Lidhur me ligjshmërinë e kësaj shume në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, trupi gjykues konstaton:

**13.6.1.** Në përgjigjet e pyetësorit nr. 4, subjekti i rivlerësimit sqaron se për shkak të moshës dhe të

kohës së largët, vjehrrit nuk i kujtohet nëse janë paguar këto detyrime. Ndërsa në vijim i referohet nenit 11 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Tatimi mbi të ardhurat”, që parashikon se: 2. *Tatimi paguhet nga individit që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të pasurive të mësipërme, në përputhje me aktet ligjore. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrave të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.* 3. *Zyrat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme janë të detyruara që, brenda datës 20 të muajit pasardhës, të transferojnë për llogari të administratës tatimore tatimin e paguar, sipas parashikimeve të këtij neni.* Në zbatim të kësaj dispozite dhe faktit se të dyja pronat e paluajtshme të shitura me kontratat e mësipërme janë regjistruar në librat publikë në emër të blerësve, subjekti i rivlerësimit pretendon se duhet të jetë paguar tatimi në burim pasi, në të kundërt, nuk mund të bëhej regjistrimi i pronave.

**13.6.2.** Në vijim, subjekti sqaron se pagesat e taksave dhe tatimeve për kohën kur datojnë kontratat e shitjes, 1995 dhe 2000, bëheshin pranë Zyrave të Hipotekës si kusht i domosdoshëm për regjistrimin e pronës të blerësi, detyrim i respektuar nga i vjehrrit. Prona, sipas subjektit, e shitur me kontratën e vitit 1995 të shtetasi M. G., është regjistruar prej tij e më pas është zhvilluar duke e dhënë për ndërtim.

**13.6.3.** Me përgjigjet e pyetësorit nr. 4, subjekti depoziton shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 10.03.2020, të AShK-së, Drejtoria Vendore Vlorë, me të cilën vihet në dispozicion dokumentacioni i dalë nga arkiva e këtij institucioni, përcjellë ndër të tjera dhe kërkesa e aplikimit për regjistrim e blerësit A. G., “për kalim pronësie”, e datës 29.08.2000. Subjekti i rivlerësimit, me përgjigjet, paraqet gjithashtu deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 07.03.2020, të babait të bashkëshortit I. M., nëpërmjet së cilës deklaroi se, për pronat e trashëguara me testament nga i ati, të shitura nëpërmjet kontratave nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 29.11.1995 dhe nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 22.08.2000, ka respektuar ligjet e kohës duke paguar taksat e kërkuara nga shteti, për t’u dhënë mundësi blerësve të gëzonin të lirë pronën që po blinin, si dhe sqaron se për shkak të kohës së gjatë, deklaroi se nuk e ka pasur të mundur të gjejë dokumentet e pagimit të taksave apo tatimeve, por deklaroi se ka qenë korrekt me ligjet e shtetit.

**13.6.4.** Pas seancës dëgjimore të datës 16.07.2020, Komisioni me vendimin nr. 4, datë 24.07.2020, vendosi *riçeljen e hetimit administrativ, për të proceduar me dërgimin e shkresës pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, të njoftojë subjektin për vendimin e riçeljes së hetimit dhe shtyrjen e seancës dëgjimore.* Në zbatim të këtij vendimi, Komisioni i drejtohet Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 24.07.2020, me kërkesë për qartësim nëse subjekti ka pasur ligjërisht detyrim tatimor për të paguar për shumën e marrë ndihmë nga vjehrrit, prej 3.000.000 lekësh. Kjo shumë, sipas përcaktimeve në shkresë, ka ardhur si rezultat i dy kontratave të shitjes së pasurive të paluajtshme në emër të vjehrrit të subjektit, përkatësisht sipas kontratës nr. {\*\*\*}, datë 29.11.1995, në vlerën 100.000 dollarë dhe nr. {\*\*\*}, datë 22.08.2000, në vlerën 4.500.000 lekë.

**13.6.5.** Nëpërmjet komunikimit elektronik po të datës 24.07.2020, duke marrë shkas nga pyetja e drejtuar gjatë seancës dëgjimore nga një anëtar i trupit gjykues mbi pagesën e tatimit mbi të ardhurat personale në lidhje me shumën 3.000.000 lekë, dhënë ndihmë bashkëshortit nga babai i tij I. M., për blerjen e apartamentit, subjekti i rivlerësimit sqaron se pas konsultimit me ligjin, kanë marrë masa për pagimin e këtij detyrimi të prapambetur në buxhetin e shtetit, për të mos qenë debitor ndaj tij. Subjekti, duke qenë në dijeni të faktit që ligji ka përjashtuar tatimin mbi dhurimet, në këtë lloj marrëdhënieje të posaçme, përsëri vlerësoi që të paguajë tatimin mbi këto të ardhura personale, siç

parashikon neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, me qëllimin për të qenë deri në fund korrekt me detyrimet ndaj buxhetit të shtetit, duke mos pasur qëllim shmangien e detyrimit.

**13.6.6.** Në këtë komunikim, subjekti i rivlerësimit informon se bashkëshorti, në cilësinë e individit, ka pasur detyrimin të paguante tatimin mbi të ardhurat në kuptim të nenit 8, germa “dh” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar. Për vonesën në pagimin e këtij detyrimi, që nuk është kuptuar në kohën e përfitimit të të ardhurave, zbatohen sanksionet administrative të përcaktuara në nenin 113 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar. Ligji tatimor nuk pengon tatimpaguesin të shlyejë me vonesë detyrimin tatimor, por për këtë është i detyruar të paguajë gjobën e llogaritur nga organi tatimor.

**13.6.7.** Po më datë 24.07.2020, subjekti i rivlerësimit depoziton pranë Komisionit “Urdhër pagese {\*\*\*}, tatimi mbi të ardhurat individuale”, detaje të urdhër pagesës: *Pagesë kundrejt detyrimit tatimor, {\*\*\*}, DIVA (deklarim individual), detyrim principal 450.000 lekë.* Pagesë e cila është kryer nëpërmjet Alpha Bank ShA, më datë 24.07.2020, me përshkrimin: *Dh. M., me NIPT {\*\*\*}, tatim mbi të ardhurat individuale janar-dhjetor 2017,* për Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve.

**13.6.8.** Pas kërkesës së Komisionit, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 29.07.2020, informon se sipas dispozitave ligjore tatimore në fuqi, konkretisht neni 8, germa “dh” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, konsiderohen të ardhura personale të tatueshme fitimet e realizuara nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, të cilat në zbatim të nenit 11 të këtij ligji, paguhen nga individi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, para kryerjes së regjistrimit të pasurive. Pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme. Sipas rastit të paraqitur nga Komisioni, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve sqaron se trashëgimtari në momentin e kalimit të pasurisë së paluajtshme (shitje), ka paguar edhe tatimin mbi të ardhurat personale për të ardhurat e përfituara. Më pas, kur ky individ ka dhënë ndihmë në *cash* në vlerën 3.000.000 lekë, përfituesi i kësaj shume nuk është subjekt i dispozitave të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, dhe nuk ka detyrim të paguajë tatim mbi të ardhurat personale për të ardhurat e përfituara, pasi parimi i tatimeve është që e njëjta shumë nuk mund të tatóhet dy herë.

**13.7.** Komisioneri Publik, me parashtrimet e datës 26.01.2023, ka ndryshuar qëndrim, duke arsyetuar se për këtë pjesë të shkakut ankimor, që lidhet me pagesën e detyrimeve tatimore për këtë shumë të dhuruar, nënvizon evoluimin e jurisprudencës së Kolegjit lidhur me sa është kërkuar në paragrafët 15.13 dhe 15.14 të ankimit të tij të datës 20.01.2021, për verifikimin e ligjshmërisë së shumës së dhuruar, sipas kërkesave të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, duke theksuar se mbetet detyrim vlerësimi rast pas rasti i kësaj situatë nga Kolegji, duke përfshirë në këtë vlerësim elemente të tilla, si: deklarim i saktë, ekzistenca e burimit të ligjshëm, si dhe çdo rrethanë tjetër që shërben në verifikimin e ligjshmërisë së krijimit të pasurisë. Komisioneri Publik si në parashtrime, ashtu dhe në bisedimet përfundimtare në Kolegji, ka konsideruar të ligjshme shumën 3.000.000 lekë, duke reduktuar mungesën e burimeve financiare për vitin 2006, nga (-) 4.066.211 lekë, në (-) 1.066.211 lekë.

**13.8.** Për sa parashtruar më sipër, trupi gjykues vlerëson se shuma monetare e dhënë në formë dhurimi, nuk përfshihet në të ardhurat e tatueshme të përcaktuara në nenin 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, konfirmuar ky fakt dhe nga Drejtoria e

Përgjithshme e Tatimeve me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 15.06.2021, administruar në Kolegj në kuadër të shqyrtimit të çështjes (JR) nr. 46/2019, datë 25.09.2019. Në këto kushte, pagesa e detyrimit tatimor më datë 24.07.2020, nga bashkëshorti i subjektit, ka qenë një veprim i panevojshëm në kuadër të këtij procesi. Sa i përket detyrimit tatimor të shtetasit I. M. në kuptim të nenit 8, pika 1, germa “dh” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, që parashikon si të ardhura të tatueshme, ato të përfituara nga kalimi i së drejtës së pronësisë mbi pasuritë e paluajtshme, trupi gjykues konstaton se njëra nga dy kontratat e shitjes, ajo nr. {\*\*\*} rep./kol., datë 29.11.1995, në shumën 100.000 USD, është nënshkruar përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, dhe ligji i mëparshëm nr. 7786, datë 27.01.1994, “Për tatimin mbi të ardhurat personale”, nuk përfshinte këtë të ardhur në të tatueshmet. Referuar shkresës së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, *pasuria e paluajtshme nuk regjistrohet, pa provuar pagimin e detyrimit pranë zyrës së regjistrimit të pasurive të paluajtshme*, dhe në kushtet kur nga aktet e dosjes provohet që blerësi M. G. sipas vërtetimit-regjistrimit të lëshuar nga zyra e Hipotekës bëhet pronar i truallit, *pasuri kjo që transkriptohet në emër të tij në regjistrat nr. {\*\*\*}, datë 29.11.1995*, dhe blerësi A. G. sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep./kol., datë 22.08.2000, ka aplikuar për regjistrim më datë 29.08.2000, trupi gjykues vlerëson të përfshijë në analizën financiare shumën 3.000.000 lekë, dhënë nga babai i bashkëshortit.

14. Lidhur me të ardhurat e pretenduara si *ndihmë financiare nga babai i personit të lidhur*, në shumat prej 300.000 lekësh/vit, Komisioneri Publik pretendon se: i) subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, gjatë plotësimit të deklaratave përgjatë viteve 2005-2016, në rubrikën: “Dhurata dhe trajtime preferenciale” me vlerën mbi 10.000 lekë, nuk rezulton të kenë deklaruar të ardhura të përfituara nga babai i personit të lidhur për përballimin e shpenzimeve të jetesës; ii) deklarimi i këtyre të ardhurave të pretenduara që Komisioni i ka përlllogaritur si të ardhura të ligjshme, ka qenë detyrim ligjor për deklarim, parashikuar nga legjislacioni përkatës, që subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur e kanë mbartur gjatë plotësimit të përvitshëm të deklaratave pranë ILDKPKI-së dhe asaj *vetting*; iii) shumat 300.000 lekë/vit nuk duhen përfshirë në zërin e të ardhurave ndër vite, për sa kohë nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratat periodike vjetore, në referencë të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe të jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit<sup>25</sup> mbi vlerën provuese të tyre në procesin e rivlerësimit. Trupi gjykues, në analizë të këtyre pretendimeve, konstaton:

14.1. Komisioni, në analizën financiare përcjellë subjektit të rivlerësimit si me rezultatet e hetimit, ashtu dhe në vendim, ka përfshirë në zërin të ardhura, *ndihmë financiare nga vjehërri*, në vlerën 300.000 lekë/vit për të gjithë periudhën e rivlerësimit, 2004-2016, përveç vitit 2006, për të cilin ka përfshirë ndihmën e dhënë prej tij në këtë vit, prej 3.000.000 lekësh.

14.2. Lidhur me deklarin e subjektit të rivlerësimit në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, datë 29.01.2020, se prindërit e bashkëshortit kanë qenë në vijimësi mbështetës të djalit të tyre Dh. M. dhe dy fëmijëve të tjerë, për të mundësuar lehtësimin e nevojave të tyre, sa herë ka qenë e nevojshme, Komisioni me pyetësorin nr. 6, i ka kërkuar informacion mbi kontributin e dhënë nga prindërit e bashkëshortit për secilin vit. Subjekti i rivlerësimit ka sqaruar se nuk bëhet fjalë për dhurim të shumave fikse të përdorura për të shtuar ndonjë pasuri, por për shuma të vogla të herëpashershme, shtrirë në kohë sa herë që lindte nevoja, për shkak të mungesave të vogla

<sup>25</sup> Referojuni vendimit (JR) nr. 6/2018, paragrafi 14; vendimit (JR) nr. 8/2018, paragrafi 43; vendimit (JR) nr. 12/2018, paragrafi 24.11; vendimit (JR) nr. 5/2019, paragrafi 23; vendimit (JR) nr. 10/2018, paragrafi 67; vendimit (JR) nr. 19/2019, paragrafi 22.14.

financiare të përnuajshme, si një familje e re. Në kuadër të një marrëdhënieje familjare tradicionale, ku prindërit me mundësi financiare të shëndosha kanë kontribuar për të mundësuar një jetesë normale, të thjeshtë në Tiranë. Për shkak të kohës së kaluar dhe mënyrës së dhënies së kësaj ndihme, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk mund të jetë shteruese në përcaktimin e shumës për çdo vit, por sjell në vëmendje disa momente, që kanë kushtëzuar nevojën për ndihmë financiare, si zhvendosja në Tiranë në vitin 2001, lindja e djalit, ndjekja e studimeve nga bashkëshorti, qiraja e banimit, fatura dhe shpenzimet e tjera për një jetesë të thjeshtë. Sipas subjektit të rivlerësimit, babai i bashkëshortit, z. I. M., ka pasur të ardhura të konsiderueshme, për shkak të shitjes së pasurive të paluajtshme, por edhe nga kultivimi dhe shitja e ullinjve e vajit të ullirit. Familja e bashkëshortit nuk ka dhënë shuma të hollash fikse, por kanë zgjedhur të kontribuojnë në mënyrë të përnuajshme. Gjatë kohës së studimeve të bashkëshortit në Fakultetin e Drejtësisë, prindërit e tij u kanë dërguar *cash* periodikisht në shumat 40.000 – 50.000 lekë për çdo radhë. Sa i përket periudhës pas deklarimit të parë periodik, 31.01.2005, sipas subjektit, ndihma ka vijuar. Pas marrjes së kredisë, prindërit e bashkëshortit kanë kontribuar në pagimin e kësteve të kredisë, në mënyrë sporadike. Kjo ndihmë është dhënë në raste të pamundësisë për të shlyer këtë detyrim. Kjo vlerë nuk e ka kaluar asnjëherë *vlerën e 300.000 lekëve në vit*, për çdo vit deklarues, që në varësi të situatës, janë përdorur për pagim të kësteve të kredisë, kësteve të shkollimit të djalit në shkollë jopublike. Sa i takon mundësisë së të ardhurave të ligjshme të vjehrrit për ndihmesën e dhënë, përveç kontratave të shitjes së pjeshme të pasurive të paluajtshme të trashëguara, subjekti paraqet dhe certifikatë pronësie të sipërfaqeve të ullishtave, foto të ullinjve shumëvjeçarë, si dhe deklaratën noteriale të shtetasit I. M..

**14.3.** Subjekti i rivlerësimit në parashtrimet në Kolegj, pretendon se gjatë hetimit administrativ ka paraqitur fakte dokumentare që tregojnë fitimet e mundshme dhe reale që i vjehrrit ka pasur nga kultivimi i ullirit. Ndërsa me parashtrimet, ka depozituar: 1. raportin e vlerësimit të kryer nga eksperti B. M. për pronat e llojit “Ullishte”, ku sipas përlllogaritjeve, të ardhurat bruto të realizuara për vitet 2000 – 2020, zënë shumën 56.240.000 lekë, duke zbritur shpenzimet prej 11.248.000 lekësh, për shpjegimet agroteknike, mirëmbajtjen e ullishtave, punimet, krasitjet, spërkatjet, vjeljen, standardizimin etj., të ardhurat neto zënë shumën prej 44.992.000 lekësh. Ndihmën financiare të dhënë nga prindërit e bashkëshortit, subjekti vetë pretendon ta ketë deklaruar vetëm gjatë hetimit administrativ pasi kjo ndihmë nuk ka shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie, por për mbulimin e shpenzimeve, kryesisht shlyerjen e kredisë. Në deklaratat periodike, sipas subjektit, në rubrikën e detyrimeve financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë nuk kërkohet burimi i të ardhurave që kanë shërbyer për shlyerjen e detyrimit dhe, kjo ka qenë arsyeja, sipas subjektit, e mosdeklarimit të kësaj ndihme financiare e cila është e vërtetë dhe e pamohueshme. Subjekti pretendon se në asnjë moment nuk është vlerësuar si dhuratë që duhet të deklarohet për efekt të kontrollit të interesave pasurorë. Sipas subjektit, kjo shumë nuk mund të cilësohet si dhuratë apo trajtim preferencial që do të passillte detyrimin për deklarim, pasi ishte për mbulim përditshmërie në shpenzime kur ka pasur mungesa, ndërmjet familjarëve që janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin, pjesë e një familjeje me traditë që vijon të kenë të pandara toka bujqësore të përfutuara me ligj. Në kushtet kur bashkëshorti ka qenë pjesë e familjes bujqësore në kohën e përfitimit të saj, bën që ai të jetë përfitues të paktën në pjesën e tij. Udhëzimi i datës 10.10.2016 i ILDKPKI-së nuk kërkonte burimin e shlyerjes së detyrimeve apo shpenzimeve.

**14.4.** Subjekti, nëpërmjet parashtrimeve, sjell në vëmendje jurisprudencën e Komisionit kur është marrë në konsideratë ndihma financiare e familjarëve për mbulimin e shpenzimeve të deklaruara për herë të parë gjatë hetimit administrativ, madje edhe kur këto të dhëna janë deklaruar vetëm gjatë

prapësimeve të rezultateve të hetimit, qëndrim i përkrahur nga Komisioneri Publik pasi vendimi mori formë të prerë pa u ankimuar, edhe kur në këtë rast ndihma financiare nuk ishte deklaruar nga subjekti i rivlerësimit as në deklaratat periodike e as në deklaratën *vetting*, madje është deklaruar vetëm me shpjegimet mbi raportin përfundimtar. Parimi i barazisë përpara ligjit është parim i rëndësishëm i shtetit të së drejtës që duhet të zbatohet pa dyshim në procesin e *vetting*-ut. Në kushtet kur: ndihma financiare është deklaruar gjatë hetimit administrativ; rrethanat familjare krijojnë besueshmëri për deklarimin e sinqertë për përfitimin e ndihmës financiare gjatë viteve të deklarimit; fakti që kjo ndihmë nuk ka shërbyer për krijimin e ndonjë pasurie, por për përballimin e shpenzimeve dhe më së tepërmi për shlyerjen e detyrimit të kredisë; babai i bashkëshortit ka të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e kësaj shume.

**14.5.** Subjekti sjell në vëmendje jurisprudencën e organeve të *vetting*-ut, ku është mbajtur qëndrim se familjet që përballojnë jetesën me të ardhurat nga bujqësia dhe blegtoria, shpenzimet jetike i kanë të vogla, reduktimi i shpenzimeve familjare ka shkuar deri në masën 40%. Në këto kushte, shpenzimet jetike, sipas subjektit, duhet të ishin zvogëluar deri në këtë masë, siç është vepruar me të gjitha subjektet e tjera që kanë përfituar në mënyrë të rregullt të ardhura nga bujqësia dhe blegtoria. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka kërkuar reduktimin e shpenzimeve për shkak se nuk e njihte praktikën e Komisionit në këtë drejtim dhe metodologjinë e reduktimit të tyre dhe e dyta, për shkak se mbrojtja është kufizuar në barrën e provës të kaluar nga Komisioni. Në këto kushte, shpenzimet jetike duhet të reduktohen në 40%. Ky pretendim i subjektit të rivlerësimit, lidhur me shpenzimet jetike të familjes bujqësore, nuk afekton analizën financiare të kryer në Kolegj në përgjigje të shkaqeve ankimore.

**14.6.** Trupi gjykues analizoi deklaratat periodike vjetore dhe nuk konstatoi që subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur të kenë deklaruar shumën 300.000 lekë të përfituar nga babai i bashkëshortit, deklarim ky që do të përbënte provë në kuptim të nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. As në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit apo personi i lidhur nuk kanë deklaruar këtë të ardhur. Në këto kushte, si dhe për faktin që nuk rezulton asnjë gjurmë shkresore lidhur me këtë të ardhur, si dhe me konsideratë jurisprudencën e Kolegjit, pavarësisht mundësisë financiare që mund të ketë pasur vjehri i subjektit, këto të ardhura të pretenduara vetëm gjatë pyetësorëve, të deklaruara pas pyetjes së Komisionit, të papërcaktuara realisht, bëjnë të bazuar pretendimin e Komisionerit Publik për mospërfshirjen e tyre në mesin e të ardhurave të ligjshme të subjektit të rivlerësimit. Në analizën financiare të kryer në Kolegj, kjo shumë nuk është përfshirë si e ardhur e ligjshme.

15. Lidhur me likuiditetet *cash*, Komisioneri Publik pretendon se përlllogaritjet e Komisionit, i cili në analizën financiare për vitet 2006, 2007 dhe 2016 ka pakësuar likuiditetet *cash*, në shumën 450.000 lekë në vitin 2006, 500.000 lekë në vitin 2007 dhe 300.000 lekë në vitin 2016, ndërkohë që në deklaratat periodike vjetore subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vetëm shtesa të kursimeve *cash* dhe në asnjë prej tyre nuk ka deklaruar pakësime të këtyre kursimeve, nuk përputhen me çfarë ka deklaruar subjekti në deklaratimet periodike vjetore e bien ndesh edhe me orientimin e Kolegjit, në vendimin (JR) nr. 7/2019, paragrafi 39, si dhe jurisprudencën e deritanishme të tij<sup>26</sup>, pasi këto deklarata përbëjnë të vetmen provë dhe mënyrë verifikimi të ekzistencës së likuiditeteve *cash* në funksion të procesit të rivlerësimit. Trupi gjykues, në përgjigje të këtyre shkaqeve ankimore, nga analizimi i akteve në dosje, konstaton:

<sup>26</sup> Referojuni vendimeve (JR) nr. 27/2020, paragrafi 19.4.v; (JR) nr. 19/2019, paragrafi 84; (JR) nr. 11/2019, paragrafi 27.12.18.

**15.1.** Nga analizimi i deklaratave periodike të viteve 2005, 2006, 2007, 2015 dhe 2016, rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar përkatësisht: i) në vitin 2005, likuiditet në *cash* 950.000 lekë; ii) në vitin 2006, *cash* në shtëpi nga kursimet e vitit 2006, 500.000 lekë; iii) në vitin 2007, nuk deklarohet pakësim; iv) në vitin 2015, *cash* në shtëpi për shpenzime të zakonshme, 300.000 lekë; v) në vitin 2016, nuk deklarohet pakësim. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk deklaroi pakësim të gjendjes *cash* në vitet 2006, 2007 dhe 2016, apo ndonjë mënyrë tjetër të përdorimit të tyre, si burim krijimi apo shpenzimi në vitin pasardhës, trupi gjykues, në përputhje me parashikimin e nenit 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe jurisprudencën e Kolegjit, e gjen të drejtë pretendimin e Komisionerit Publik për të mos përfshirë në analizën financiare përdorimin e këtyre kursimeve në vitin pasardhës.

16. Lidhur me shpenzimet e jetesës të familjes së subjektit të rivlerësimit, Komisioneri Publik, ndryshe nga Komisioni, vlerëson se ato duhen llogaritur bazuar në përbërjen familjare të subjektit të rivlerësimit, të deklaruar në deklaratat periodike vjetore përkatëse, duke përjashtuar ato të viteve 2006 dhe 2007, në të cilat subjekti i ka vetëdeklaruar këto shpenzime. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, në përgjigje të këtij pretendimi, konstaton si vijon.

**16.1.** Komisioni, në analizën financiare të kryer për periudhën 2004 e në vazhdim, nuk i është referuar numrit të anëtarëve të familjes sipas përbërjes në certifikatën e gjendjes familjare, dhe as përbërjes familjare të deklaruar në deklaratat e interesave private periodike, por është mbështetur në shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ. Nga Komisioni, për vitet 2004, 2005, 2008, 2009 dhe 2010, janë përllogaritur shpenzimet për dy anëtarë, ndërkohë që familja përbëhej nga tre anëtarë, për vitet 2006 dhe 2007 janë përllogaritur sipas deklaramit të bërë nga vetë subjekti në deklaratat periodike, dhe për periudhën gusht 2010 – dhjetor 2016, përllogaritet janë bërë për tre anëtarë, ndërkohë që familja përbëhet nga katër anëtarë.

**16.2.** Gjatë hetimit administrativ në Komision, në përgjigjet e datës 03.02.2020, të pyetësorit nr. 3, subjekti i rivlerësimit sqaron se djali është rritur në fshatin {\*\*\*} [Durrës] nga prindërit e saj, që nga mosha 1- (një) vjeçare për shkak të gjendjes së rëndë të alergjisë astmatike që iu shfaq në këtë moshë, si dhe ka vijuar për vite me radhë deri aktualisht. Këtë fakt, sipas shpjegimit të subjektit të rivlerësimit, e provon qartësisht edhe frekuentimi nga djali i shkollës publike {\*\*\*} për klasën e parë dhe të dytë, në të cilën babai i subjektit të rivlerësimit ishte arsimtar. Në mbështetje të argumenteve të saj, me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit depoziton deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.07.2020, të prindërve, B. dhe B. H., të cilët deklarojnë se kanë mbajtur në banesën e tyre në fshatin {\*\*\*}, Durrës, nipin K. M. nga mosha një vjeç dhe pa ndërprerje deri në tetor 2019, kur ka nisur studimet e larta në Tiranë, për shkak të alergjisë astmatike, duke u përkujdesur për të dhe duke mbuluar shpenzimet e jetesës së tij, përveç tarifës së shkollimit të mbuluar nga prindërit.

**16.3.** Nga analizimi i akteve të dosjes gjyqësore, nuk identifikohet saktësisht se ku ka banuar djali i subjektit të rivlerësimit K. M., pasi në informacionin e përcjellë nga institucioni arsimor “{\*\*\*}” ShA me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 28.01.2020, rezulton që për vitet 2009 – 2016, ai ka ndjekur këtë shkollë me vendndodhje në Durrës. Nga marrëveshjet dhe kontratat e transportit të nënshkruara për çdo vit shkollor me këtë institucion arsimor, për vitet 2010, 2011, 2012, adresa e nxënësit K. M. përcaktohet {\*\*\*}, ndërsa për vitet e tjera pasardhëse 2014, 2015 përcaktohet: rruga “{\*\*\*}”, Tiranë, që korrespondon me adresën e subjektit të rivlerësimit. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë pretendimin se shpenzimet jetike të djalit janë mbuluar nga prindërit e saj deri

në tetor 2019, pavarësisht mundësisë së tyre financiare, trupi gjykues i përllorarit ato bazuar në përbërjen familjare të subjektit të rivlerësimit, të deklaruara në deklaratat periodike vjetore përkatëse, duke përjashtuar vitet 2006 dhe 2007, për të cilat i ka deklaruar shpenzimet në deklaratat periodike vjetore respektive. Megjithatë, trupi gjykues konstatoi se edhe nëse shpenzimet jetike do të ishin llogaritur sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me të birin, përsëri analiza financiare do të rezultonte me balancë negative në atë masë që nuk do të shëronte pamjaftueshmërinë e burimeve të ligjshme të subjektit të rivlerësimit dhe të personit të lidhur, për periudhën 2004 – 2016, të përcaktuar në paragrafin 20 të këtij vendimi, thjesht do të reduktohej balanca negative në vlerën 648.330 lekë.

**16.4.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, në parashtrimet e saj në Kolegj, pretendon se në vitet 2006 dhe 2007, ndryshe nga vitet e tjera, në shpenzimet mujore të jetesës ka përfshirë dhe shpenzimet e likuidimit mujor të kredisë, pasi ishin dy vitet e para të fillimit të likuidimit të saj dhe subjekti mendonte se duhej të përfshihej dhe ky shpenzim, si rrjedhojë e padijenisë, gjë e cila është riparuar më vonë pasi shlyerja e kredisë deklarohet më vete. Trupi gjykues, në lidhje me këtë pretendim, konstaton se në deklaratat periodike të këtyre dy viteve, shlyerjen e kësteve të kredisë subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar veç shpenzimeve të jetesës, konkretisht në deklaratën e interesave privatë 2006, subjekti i rivlerësimit deklaroi: *shpenzime jetese për vitin 2006, 650.000 lekë*, ndërsa në rubrikën *Detyrimet financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë*, deklaroi shumën e shlyer të kredisë, financuar nga Banka Kombëtare e Greqisë ShA, prej 3.402 eurosh ose 408.200 lekësh. Ndërsa në deklaratën e interesave privatë 2007, subjekti i rivlerësimit deklaroi shlyerjen e këstit 378 euro në muaj, në total 4.536 euro për vitin 2007, si dhe shpenzimet familjare mesatare mujore (shpenzime udhëtimi, shpenzime për fëmijën, energji elektrike, veshje etj.) në vlerën 60.000 lekë në muaj, për 12 muaj 720.000 lekë në total. Fakti që edhe në analizën financiare të depozituar me prapësimet ndaj rezultateve të hetimit, vetë subjekti i rivlerësimit ka përcaktuar pikërisht këto shpenzime jetike si në deklaratat periodike 2006 dhe 2007, në linjë me Komisionin, duke i deklaruar në rubrikë më vetë shlyerjen e kësteve të kredisë në NBG ShA, bëjnë që pretendimi i subjektit të rivlerësimit me parashtrimet, të mbetet i paprovuar dhe në nivel deklarativ dhe, për këto arsye, nuk është marrë në konsideratë në analizën financiare të kryer në Kolegj.

**16.5.** Trupi gjykues gjen gjithashtu të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit me parashtrimet në Kolegj, se shpenzimet jetike duhet të ishin zvogëluar në 40%, ashtu siç është vepruar me të gjitha subjektet e tjera në Komision, të cilat kanë përfituar të ardhura nga bujqësia dhe blegtoia, pasi Kolegji ka konsoliduar tashmë metodologjinë e përlloraritjes së shpenzimeve të jetesës në jurisprudencën e tij, të bazuar vetëm në të dhënat zyrtare të përcjella nga INSTAT-i dhe ILDKPKI-ja.

17. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se nga verifikimi i akteve të administruara në dosje, lidhur me të ardhurat e bashkëshortit nga aktiviteti privat si avokat, duhet të merret në konsideratë *fitimi pas tatimit* për vitet 2014-2015, përkatësisht 153.593 lekë në vitin 2014 dhe 2.850.220 lekë në vitin 2015<sup>27</sup>, nga analizimi i akteve që shoqërojnë raportin e kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë, hartuar nga ILDKPKI-ja, trupi gjykues konstaton se Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë ka informuar se personi fizik “Dh. M.” është i regjistruar pranë kësaj drejtorie me NIPT {\*\*\*},

<sup>27</sup> Rezulton që Komisioni ka përfshirë në zërin: të ardhura, fitimin e tatueshëm, ndërkohë që nga këto shuma duhet të ishte zbritur tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, që referuar akteve bashkëngjitur shkresës së DRT Tiranë nr. {\*\*\*} prot., datë 2.8.2017, është përkatësisht 16.667 lekë në vitin 2014 dhe 231.099 lekë në vitin 2015. Ndërsa në vitin 2016, tatimi mbi fitimin e deklaruar është (0) zero.



sipas të dhënave të sistemit C@ts më datë 12.05.2014, me veprimtari “aktivitete juridike”, i vetëpunësuar. Nga informacioni i shkresës, rezulton se për periudhën 2014 – 2016, subjekti “Dh. M.” ka realizuar qarkullim dhe fitim si vijon: për vitin 2014, qarkullimi 214.000 lekë, fitimi 170.260 lekë; për vitin 2015, qarkullimi 3.458.311 lekë, fitimi 3.081.319 lekë; për vitin 2016, qarkullimi 3.748.332 lekë, fitimi 3.191.501 lekë.

Sipas akteve “Formular i deklarimit të tatimit të thjeshtuar mbi fitimin”, rezulton se: për vitin 2014, fitimi i tatueshëm është 170.260 lekë, tatimi fiks për t’u paguar është 16.667 lekë; për vitin 2015, fitimi i tatueshëm është 3.081.319 lekë, tatimi i thjeshtuar mbi fitimin është 231.099 lekë; për vitin 2016, fitimi i tatueshëm është 3.191.501 lekë, tatimi i thjeshtuar është zero lekë. Në këto kushte, në analizën financiare të kryer nga në Kolegj, për vitet 2014 dhe 2015, të ardhurat janë përlllogaritur sipas formularëve përkatës, në linjë me pretendimin e Komisionerit Publik, ndërsa për vitin 2016 me ndryshimet e ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006<sup>28</sup>, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ku në nenin 11, pika 2 parashikohet se *tatimi i thjeshtuar mbi fitimin për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0 [zero] deri në 5.000.000 lekë, është zero lekë në vit*, fitimi i vitit 2016, në vlerën 3.191.501 lekë, përbën dhe fitimin pas tatimit, në kushtet kur qarkullimi është më pak se 5.000.000 lekë.

18. Lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik se likuiditetet në llogaritë bankare të subjektit të rivlerësimit dhe të bashkëshortit, në datën 31.12.2007, janë në total në shumën (-) 25.490 lekë<sup>29</sup>, nga analizimi i informacionit të përcjellë nga Tirana Bank ShA<sup>30</sup> dhe Raiffeisen Bank ShA<sup>31</sup>, trupi gjykues konstaton se ky pretendim qëndron dhe gjendja e likuiditeteve në datën 31.12.2007, rezulton në vlerën (-) 79.801,88 lekë dhe 53.868,99 lekë përkatësisht, të reflektuara në analizën financiare në Kolegj.
19. *Për pasurinë e luajtshme, automjet tip “Audi A4”, Komisioneri Publik e gjen të pabazuar në akte dhe interpretim ligjor vlerësimin e Komisionit mbi: (i) mundësinë e huadhënësit V. A. për të dhënë hua shumën 6.000 euro nga burime të ligjshme; si dhe (ii) pamjaftueshmërinë e konstatuar, në shumën (-) 172.284 lekë, për të investuar në blerjen e kësaj pasurie, për të shlyer huan, si dhe për të përballuar shpenzimet e tjera familjare për vitin 2016. Trupi gjykues, nga analizimi i akteve në dosjen gjyqësore, konstaton:*

**19.1.** Komisioni në vendim është shprehur se ka krijuar bindjen se huadhënësi ka pasur burime të mjaftueshme të ligjshme për t’i dhënë hua bashkëshortit të subjektit. Ndërsa nga analiza financiare e subjektit të rivlerësimit për vitin 2016, Komisionit i rezultoi balancë negative prej 172.084 lekësh, shumë që nuk ndikon në vlerësimin tërësor të çështjes.

**19.2.** Kjo pasuri dhe burimi i krijimit të saj janë deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*, nga personi i lidhur: *Automjet tip Audi, me targa {\*\*\*}, blerë në mars 2016, në vlerën 8.000 euro. Burim krijimi: me të ardhurat nga puna si avokat*, ndërsa në deklaratën e interesave privatë të vitit 2016, ka bërë një përshkrim të njëjtë të pasurisë dhe në rubrikën e rezervuar për të dhënat konfidenciale, ka saktësuar se: *Lidhur me burimin e krijimit të automjetit të deklaruar [...] shuma*

<sup>28</sup> Me ligjin nr. 142/2015, datë 17.12.2015.

<sup>29</sup> Balanca e llogarisë bankare nr. {\*\*\*}, në emër të subjektit të rivlerësimit, nuk është në shumën +79.802 lekë, sa është llogaritur nga Komisioni, por është në shumën -79.802 lekë. Gjithashtu, balanca e llogarisë bankare nr. {\*\*\*}, në emër të bashkëshortit të subjektit, në Raiffeisen Bank, nuk është në shumën 83.869 lekë, por në shumën 53.869 lekë, pasi rezulton se më 31.12.2007, nga kjo llogari është tërhequr cash, shuma 30.000 lekë.

<sup>30</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 18.12.2018.

<sup>31</sup> Me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 18.12.2018.

prej 6.000 eurosh iu mor hua z. V. A. në momentin e blerjes dhe iu likuidua më datë 17.11.2016, me të ardhurat nga puna si avokat.

**19.3.** Lidhur me përfitimin e kësaj pasurie, nga aktet në dosje, rezulton se personi i lidhur e ka blerë automjetin “Audi A4” në Gjermani, në vlerën 8.000 euro. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor, nëpërmjet shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 21.12.2018, konfirmon pronësinë e personit të lidhur, z. Dh. M., mbi këtë automjet, i cili është zhdoganuar më datë 04.03.2016, duke shlyer detyrime doganore në shumën 229.237 lekë. Trupi gjykues konstaton se shtetasi V. A., më datë 01.03.2016, nëpërmjet *MoneyGram*, i dërgon bashkëshortit të subjektit, z. Dh. M., shumën 6.000 euro<sup>32</sup>. Për këtë qëllim, më datë 07.11.2016, nënshkruajnë mes tyre kontratë huaje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., për dhënien e një shume parash në formën e huas, në masën 6.000 euro më datë 01.03.2016, pa interesa deri në fund të vitit 2016, përdorur për blerjen e një automjeti, shumë e dhënë nëpërmjet *MoneyGram*, referuar mandatit bashkëlidhur kontratës. Nëpërmjet deklaratës noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.11.2016, V. A. deklaroi shlyerjen e detyrimit nga z. Dh. M. në shumën 6.000 euro dhe faktin se nuk ka asnjë pretendim nga kontrata e huas. Kthimi i huas është kryer nëpërmjet transaksionit bankar më datë 14.11.2016, ku konfirmohet transfertë në Alpha Bank ShA<sup>33</sup> nga personi fizik “Dh. M.” te V. A., me përshkrimin: *kalim borxhi sipas kontratës nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 07.11.2016.*

**19.4.** Gjatë hetimit administrativ në Komision, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti i rivlerësimit sqaron se në vitin 2016, bashkëshorti është ndodhur në Gjermani dhe ka gjetur automjetin në fjalë, të cilin ka vendosur ta blejë, por duke mos e pasur me vete të gjithë shumën e çmimit të blerjes, ka kontaktuar me mikun e tij V. A., i cili i ka nisur nga Shqipëria shumën prej 6000 eurosh. Së bashku me përgjigjet, subjekti i rivlerësimit paraqet deklaratën noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 16.01.2020, të shtetasit V. A., i cili sa i përket burimit të të ardhurave që kanë shërbyer për dhënien e shumës 6.000 euro, deklaroi se janë kursimet e tij personale, si dhe fitime nga ushtrimi i aktiviteteve tregtare, të mbajtura *cash* në banesë. Për të provuar këtë fakt me deklaratën më sipër, huadhënësi V. A. depoziton një sërë aktesh shkresore<sup>34</sup>, si: deklarata noteriale, kontrata porosie, aktmarrëveshje të nënshkruara mes tij në cilësinë e administratorit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK dhe shtetasve të ndryshëm të cilët kanë porositur apartamente në objektet e ndërtuara nga kjo shoqëri në qytetin e Përmetit, si dhe dokumente bankare për transfertat e pagesa të kryera për këtë qëllim.

**19.5.** Në kuadër të hetimit administrativ, Komisioni ka kërkuar informacion pranë institucioneve publike, lidhur me pasuritë, aktivitetin tregtar dhe gjendjen financiare të personit tjetër të lidhur, z. V. A., për të vlerësuar mundësinë e tij për dhënien e shumës hua në vitin 2016. Në vijim, Komisioni

<sup>32</sup> Sipas dokumentit “{\*\*\*}”, Dh. M. ka marrë shumën 5.760 euro. Institucioni financiar AK Invest, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 16.01.2020, konfirmon transfertën e gjeneruar nga V. A. ndaj Dh. M. më datë 01.03.2016, në vlerën 5.760 euro.

<sup>33</sup> Konfirmuar nga Alpha Bank ShA me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 13.01.2020.

<sup>34</sup> i. Deklaratë noteriale nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 17.07.2013, ku shtetasi L. H. deklaroi se i ka paguar shoqërisë shumën 10.000 euro sipas mandatarkëtimit nr. {\*\*\*}, datë 14.09.2010, për prenotimin e apartamentit me sipërfaqe 126 m<sup>2</sup> në Përmet; ii. pagesë e brendshme [Internal Payment] Raiffeisen Bank ShA nga shtetasi F. L. K. kundrejt shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, më datë 10.05.2012, në vlerën 1.500.000 lekë, “Për blerje apartamenti [...]”; iii. tërheqje në *cash* të kryera nga V. A. pranë Bankës Raiffeisen ShA në vitin 2012, më 10.05.2012 shuma 500.000 lekë, datë 06.06.2012 shuma 30.000 lekë, dhe datë 17.04.2012 shuma 100.000 lekë; iv. pagesë e brendshme [Internal Payment] Raiffeisen Bank ShA nga shtetasi K. Dh. N. kundrejt shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, më datë 16.08.2012, në vlerën 400.000 lekë “likuidim kësti i katërt për blerje shtëpie [...]”; v. kontratë porosie nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 08.03.2011, për porositjen e një apartamenti në vlerën 3.500.000 lekë [likuiduar 2.250.000 lekë dhe pjesa tjetër do të shlyhet me marrjen në dorëzim të apartamentit]; vi. aktmarrëveshje nr. {\*\*\*} rep., nr. {\*\*\*} kol., datë 28.07.2012, ku shtetasi P. U. paguan për shoqërinë shumën 900.000 lekë.

ka administruar informacionin si më poshtë.

**19.5.1.** Qendra Kombëtare e Biznesit, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 22.01.2020, informon Komisionin se shtetasi V. A. figuron: administrator dhe ortak zotërues i 100% të kapitalit në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, regjistruar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.06.2005, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, NIPT {\*\*\*}; të ketë qenë administrator me afat emërimi 15.12.2009 deri 15.12.2014 dhe figuron ortak zotërues i 25% të kapitalit në shoqërinë “{\*\*\*}” ShPK, me NIPT {\*\*\*}; të ketë qenë administrator dhe ortak zotërues i 50% të kapitalit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, me NIPT {\*\*\*}, larguar si administrator më datë 15.03.2013 dhe larguar si ortak më datë 23.01.2014.

**19.5.2.** Referuar shkresës nr. {\*\*\*} prot., datë 15.01.2020, të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, për shtetasin V. Th. A., rezulton të jetë derdhur kontribut vetëm për periudhën dhjetor 2012 deri dhjetor 2014, me të ardhura bruto në shumën 21.000 - 22.000 lekë në muaj, si dhe përcjell vërtetimin për vjetërsinë në punë për efekt pensioni për këtë shtetas, ku jepen të dhëna mbi qendrën e punës, vendin, detyrën dhe periudhën e ushtrimit të detyrës, nga data 01.10.1985 deri më 30.06.1991.

**19.5.3.** Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 31.01.2020, informon se nga të dhënat e sistemit tatimor C@ts, rezulton i regjistruar subjekti “{\*\*\*}” ShPK, regjistruar në sistemin tatimor më datë 05.01.2010, me aktivitet “Tregtim me shumicë”, ku për vitet 2010 dhe 2016 qarkullimi dhe fitimi kanë qenë 0 (zero) lekë, ndërsa nuk janë dorëzuar deklaratat e tatimit mbi fitimin për vitet 2011, 2012, 2013, 2014, 2015, 2016. Subjekti ka detyrime të pashlyera në vlerën 1.016.631 lekë. Aktualisht është me status pasiv që nga data 06.05.2016.

**19.5.4.** Drejtoria Rajonale Tatimore Gjirokastrë, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 31.01.2020, informon se nga të dhënat e sistemit tatimor C@ts, tatimpaguesi V. Th. A., administrator i subjektit “{\*\*\*}” ShPK, me adresë në Përmet, rezulton me këto të dhëna tatimore:

- i. Për vitin 2005, fitimi neto i vitit ushtrimor është 1.532.963 lekë.
- ii. Për vitin 2008, fitimi në shumën 0 lekë, humbja në shumën 90.165 lekë.
- iii. Për vitin 2009, fitimi në shumën 0 lekë, humbja në shumën 1.914.932 lekë.
- iv. Për vitin 2010, fitimi në shumën 59.404 lekë.
- v. Për vitin 2011, fitimi në shumën 0 lekë, humbja në shumën 1.135.740 lekë.
- vi. Për vitin 2012, fitimi në shumën 0 lekë, humbja në shumën 800.564 lekë.
- vii. Për vitin 2013, fitimi në shumën 0 lekë, humbja në shumën 300.750 lekë.
- viii. Për vitin 2014, fitimi në shumën 0 lekë, humbja në shumën 0 lekë.

Sipas kësaj shkrese, rezulton se detyrimet në kohë reale janë në shumën 7.886.026 lekë. Subjekti nuk ka tërhequr dividend. Subjekti nuk ka dorëzuar Deklaratën Individuale Vjetore të të Ardhurave. Subjekti figuron me status pasiv që prej datës 13.10.2014.

**19.6.** Me parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit sjell në vëmendje qëndrimin e Kolegjit në jurisprudencën<sup>35</sup> e tij, lidhur me kufijtë e verifikimit të ligjshmërisë së shumës së dhuruar apo dhënë hua, në kuptim të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Për të provuar mundësinë financiare të shtetasit V. A., subjekti i rivlerësimit u referohet lëvizjeve të llogarisë bankare të këtij shtetasi, përcjellë nga OTP Bank ShA, me shkresën nr. {\*\*\*}, datë 15.01.2020, ku rezulton se më datë 29.10.2015, llogaria e tij në monedhën euro është kredituar me shumën 7.000 euro, si këst për blerje apartamenti, shumë e tërhequr prej tij në të njëjtën ditë. Gjithashtu, me parashtrimet, subjekti i

<sup>35</sup> Shih vendimin nr. 15/2019 dhe vendimin nr. 20/2019 të Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

rivlerësimit depoziton kontrata sipërmarrjeje, kontrata porosie dhe deklarata noteriale [shih poshtëshënimin nr. 15], të cilat tregojnë arkëtimin e parave nga shtetasi V. A., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, nga shtetas të ndryshëm të cilët kanë porositur apartamente pranë kësaj shoqërie ndërtimore. Në vlerësim të subjektit, vetëm pagat e marra prej tij si administrator në shoqëritë tregtare janë të mjaftueshme për të mbuluar me burime të ligjshme shumën e dhënë hua, prej 6.000 eurosh. Kjo shumë, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk duhet konsideruar hua e mirëfilltë pasi nuk është bërë për faktin se në vitin 2016 nuk kishin burime financiare për blerjen e automjetit, por për shkak të ndodhjes së bashkëshortit në Gjermani dhe gjetjes e pëlqimit të tij për marrjen e mjetit në ato momente, duke mos pasur shumën me vete, si dhe duke mos pasur mundësi lëvrimi nga banka direkt nga Gjermania. Nëse blerja do të ishte kryer në Shqipëri, ky veprim nuk do të ishte kryer pasi bashkëshorti kishte burime financiare të ligjshme. Veprimi në tërësinë e tij ka shërbyer për të kaluar një pamundësi fakti të momentit dhe vendit të ndodhjes dhe jo pamundësi financiare për krijimin e pasurisë automjet në vitin 2016.

**19.7.** Trupi gjykues, pavarësisht akteve noteriale të depozituara nga subjekti i rivlerësimit në Komision, por dhe me parashtrimet në Kolegj, sipas të cilave shoqëria “{\*\*\*}” ShPK ka arkëtuar shuma të konsiderueshme nga shtetas të cilët kanë porositur apartamente pranë kësaj shoqërie në vitet 2006, 2010 – 2013, përsëri me konsideratë informacionin e përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë dhe Gjirokastrë, mbi gjendjen financiare të shoqërisë “{\*\*\*}” ShPK, si dhe informacionin e Institutit të Sigurimeve Shoqërore për të ardhurat e shtetasit V. A., vlerëson të bazuar pretendimin e Komisionerit Publik se shtetasi V. A. nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për t’i dhënë personit të lidhur, z. Dh. M., hua shumën 6.000 euro<sup>36</sup>. Megjithatë, në linjë me pretendimin e Komisionerit Publik, në Kolegj u krye analiza financiare duke konsideruar se huadhënësi V. A. ndodhet në kushtet e mundësisë financiare për të dhënë këtë hua, përsëri subjekti i rivlerësimit do të rezultonte me mungesë të burimeve financiare të ligjshme në vitin 2016, për blerjen e automjetit, shlyerjen e huas, krijimin e kursimeve dhe mbulimin e shpenzimeve të tjera familjare, për një diferencë negative në shumën (-) 1.007.151 lekë.

**19.8.** Trupi gjykues, në analizën financiare të kryer në vijim të arsyetimit në paragrafin 14.6 të këtij vendimi, nuk ka përfshirë në analizën financiare “ndihmë financiare nga vjehri”, në shumën 300.000 lekë, e ardhura e padeklaruar në deklaratat periodike vjetore dhe në deklaratën e pasurisë *vetting*, duke përllogaritur shpenzimet jetike për vitin 2016, bazuar në përbërjen familjare të subjektit të rivlerësimit, si deklaruar në deklaratën periodike të këtij viti. Ndërsa, sa i përket pretendimit të Komisionerit Publik se në zërin “ndryshimi në likuiditete”, të përllogaritet shuma 1.925.783 lekë<sup>37</sup>, pasi nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë deklaruar në deklaratën e interesave private të vitit 2016, pakësim të likuiditeteve *cash* në shumën 300.000 lekë, trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit si gjatë hetimit administrativ në Komision, edhe në parashtrimet në Kolegj, pretendon se shumën 300.000 lekë, tërhequr *cash* më datë 10.12.2015 nga llogaria e

<sup>36</sup> Mbi diferencën e mbetur të çmimit të blerjes prej 2.000 eurosh dhe shpenzimeve doganore në vlerën 229.237 lekë, nga nxjerrjet e llogarive bankare të subjektit të rivlerësimit dhe personit të lidhur, z. M., konstatohet se gjatë periudhës 1.1.2016 deri në momentin e blerjes së automjetit, më datë 04.03.2016, nuk janë kryer tërheqje *cash*. Gjithashtu, të ardhurat e personit të lidhur, z. M., nga aktiviteti i avokatisë, në shumën 3.191.501 lekë, janë vjetore dhe nuk mund të identifikohet pjesa e të ardhurave të realizuara deri në datën e blerjes së automjetit.

<sup>37</sup> Në analizën financiare të kryer nga Komisioni për vitin 2016, faqe 6 e rezultateve të hetimit, zëri “ndryshim likuiditeti” është llogaritur në vlerën 1.625.782 lekë, pasi rezulton të jenë pakësuar kursimet *cash* në shumën 300.000 lekë, pakësim që nuk rezulton të jetë deklaruar në DIPV nga subjekti.

pagës në Alpha Bank ShA<sup>38</sup>, e ka përdorur pjesërisht për blerjen e automjetit, dhe pasaktësia në deklarin e kësaj shume ka qenë rrjedhojë një gabimi njerëzor, për faktin se kjo shumë është përdorur më datë 04.03.2016, përpara se të dorëzohej deklarimi periodik i vitit 2015, më datë 31.03.2016. Trupi gjykues e konsideron pretendimin e subjektit të rivlerësimit deklarativ, pasi përveç mosdeklarimit të shumës 300.000 lekë, si kursim në *cash*, në deklaratën e interesave privatë të vitit 2015, subjekti i rivlerësimit as në deklaratën e interesave privatë të vitit 2016, nuk deklaroi pakësim të gjendjes së likuiditeteve në *cash*, apo përdorimin e kësaj gjendjeje *cash* si burim për blerjen e automjetit objekt shqyrtimi, ndërkohë që bashkëshorti i subjektit deklaroi si burim krijimi të ardhurat nga puna si avokat. Me këtë arsyetim, trupi gjykues gjen të drejtë shkakun ankimor të ngritur nga Komisioneri Publik.

**19.9.** Në mbështetje të arsytimit në këtë vendim dhe akteve të administruara në dosjen gjyqësore, duke përfshirë si burim krijimi për automjetin huan në shumën 6.000 euro, analiza financiare e kryer në Kolegj për vitin 2016, tregoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të investuar në blerjen e këtij automjeti, për të shlyer huan, si dhe për të mbuluar shpenzimet e tjera familjare në vlerën (-) 1.007.175 lekë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

20. Në përfundim, lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë, Komisioneri Publik, në ankim, ka pretenduar se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar investimet, shpenzimet dhe kursimet gjatë periudhës 2005-2016, me një diferencë negative, në total prej - 8.329.638 lekësh, referuar nenit D, pikat 1, 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, nenit 61, pika 3, si dhe nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, si dhe ndodhet në kushtet e deklarinimit të pamjaftueshëm dhe të pasaktë për kontrollin e pasurisë. Ndërsa në parashtrimet dhe bisedimet përfundimtare në Kolegj, duke konsideruar të ligjshme shumën 3.000.000 lekë, dhënë nga babai i bashkëshortit në vitin 2006, ka vlerësuar se diferenca negative e subjektit për periudhën e rivlerësimit, reduktohet në vlerën (-) 5.329.638 lekë. Trupi gjykues, nga analiza financiare e kryer, për periudhën 2005 – 2016, konstatoi se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur rezultojnë me mungesë të burimeve financiare të ligjshme, në vlerën (-) 5.097.358 lekë, sipas parashikimit të nenit 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, dhe arrin në përfundimin se për kriterin e vlerësimit të pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarinim të pamjaftueshëm në zbatim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

*B. Vlerësimi i trupit gjykues lidhur me shkaqet e ankimit për kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale*

21. Lidhur me vendimin penal nr. {\*\*\*}, datë 30.3.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, pjesë e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale të hartuar nga KLGj-ja për subjektin e rivlerësimit, znj. Anita Mici, Komisioneri Publik vlerëson se duhen mbajtur në konsideratë: (i) sa i përket veprës penale “vjedhje e energjisë elektrike dhe impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137, paragrafi 1 i Kodit Penal, kryer dy herë: a) fakti i rilidhjes së energjisë elektrike në mënyrë të kundërligjshme, pasi ishte marrë sanksioni administrativ i ndërprerjes; b) vlera e madhe e debisë në të dyja rastet e konstatuara, dhe për sa i përket veprës penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a, paragrafi 2 i Kodit Penal, fakti që kjo vepër është kryer pasi ishte zbatuar sanksioni administrativ i

<sup>38</sup> Sipas nxjerrjes së llogarisë bankare të subjektit të rivlerësimit në monedhën lekë pranë Alpha Bank ShA. [Rezulton tërheqje *cash* në shumën 300.000 lekë, më datë 10.12.2015].

prishjes së ndërtimit të paligjshëm; (ii) gjetjet dhe vlerësimet e raportit të hartuar nga KLGj-ja, në cilësinë e organit ndihmës në lidhje me konstatimin se: [...]masa e dënimit të caktuar nga gjykata është dhënë në keqinterpretim të neneve 47 dhe 55 të K. Penal dhe, për rrjedhim, ka cenuar parimin e proporcionalitetit të përcaktuar nga neni 1/c i K. Penal dhe neni 17/1 i Kushtetutës [...]; (iii) referuar rolit dhe kompetencës së institucioneve të rivlerësimit në shqyrtimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit<sup>39</sup> dhe kriterëve vlerësues të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, Komisioneri Publik konstaton mungesë të arsytimit ligjor nga ana e subjektit të rivlerësimit, lidhur me caktimin e masës së dënimit në vendimin objekt vlerësimi. Trupi gjykues i Kolegjit, nga analizimi i këtyre shkaqeve ankimore, konstaton:

**21.1.** Komisioni, në vendim, lidhur me këtë dosje penale dhe me dosjen penale që i përket vendimit nr. {\*\*\*}, datë 26.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me të pandehur Sh. M., trajtuar në paragrafin 22 dhe nënparagrafët e tij në këtë vendim, ka arritur në përfundimin se caktimi i llojit dhe masës së dënimit, si pjesë integrale e një vendimi fajësie, bëhet duke u bazuar në kushtet dhe kriteret e dispozitave ligjore të aplikueshme të përgjithshme, por edhe brenda kufijve të dispozitës së posaçme penale, duke qenë njëkohësisht edhe pjesë e zgjidhjes së çështjes në themel të saj. Komisioni ka vlerësuar të drejtë pretendimin e subjektit të rivlerësimit se krahas këtyre faktorëve të cilët është bazuar, në shërbim të një gjykimi të drejtë dhe të paanshëm, merr vlerë edhe bindja e brendshme e gjyqtarit, e krijuar mbi prova të vlerësuara dhe sigurisht brenda kufijve të lejueshëm nga ligji. Po ashtu, duke iu referuar dispozitave penale mbi të cilat janë kërkuar dënime përkatëse, ka rezultuar se në asnjërin prej çështjeve nuk janë dhënë dënime nën minimumin e parashikuar nga ligji. Nisur edhe nga fakti që vendimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit, kanë mbetur në fuqi, dhe në kushtet kur nuk është konkluduar zvarritje e procesit, Komisioni krijon bindjen se pretendimet e subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Mici, faktohen dhe, në këtë këndvështrim, nuk konstatohen problematika që të ndikojnë në vlerësimin profesional të saj.

**21.2.** Nga analizimi i akteve të dosjes penale që i përket shtetasit E. Sh., rezulton që ndaj tij të jetë regjistruar procedimi penal nr. {\*\*\*}, viti 2013, për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a, paragrafi 2 i Kodit Penal, si dhe procedimi penal nr. {\*\*\*}, viti 2014, për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike” (2 herë), të parashikuar nga neni 137, paragrafi 1 i Kodit Penal. Këto dy procedime penale, më datë 16.01.2015, u bashkuan në një të vetëm dhe u gjykuan nga subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici.

**21.2.1.** Prokurori i çështjes penale, në diskutimet përfundimtare para gjykatës, duke konstatuar se fajësia e të pandehurit rezulton e provuar, kërkoi: (i) deklarimin fajtor të të pandehurit E. Sh. për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike në formën e rilidhjes” dhe dënimin e tij me 4 muaj burgim; (ii) deklarimin fajtor të të pandehurit E. Sh. për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike në formën e rilidhjes” dhe dënimin e tij me 4 muaj burgim; (iii) deklarimin fajtor të të pandehurit

<sup>39</sup> *Vendimi orientues (JR) nr. 21/2019 i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, paragrafi. 26.1.1: “[...] Trupi gjykues i Kolegjit çmon të nevojshme që, nëpërmjet arsytimit të plotë të vendimit që lidhet me këtë çështje, të japë edhe orientimet e tij në lidhje me kryerjen e procesit të rivlerësimit, për sa i përket kriterit të aftësive profesionale, sipas përcaktimit të nenit 66, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se, me qëllimin për të kryer një vlerësim të plotë dhe të gjithanshëm, Komisioni, kur është e mundur dhe e nevojshme, duhet të administrojë të gjitha burimet dhe të vlerësojë të gjitha kriteret, bazuar në treguesit e përcaktuar në nenet 71, 72, 74, 75, 76, të ligjit nr. 96/2016, dhe, njëkohësisht, duhet të tregojë mënyrën se si janë administruar burimet dhe janë vlerësuar kriteret, bazuar në treguesit përkatës në analogji me vlerësimin e aftësive profesionale të realizuara për subjektin e rivlerësimit G. M., sipas arsytimit të mësipërm. Gjithashtu, trupi gjykues i Kolegjit konsideron me rëndësi që, për vlerësimin e aftësive profesionale, vëmendje t’i kushtohet edhe denoncimit të fakteve nga publiku, kur ekzistojnë kushtet dhe rrethanat e parashikuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016 [...]”.*

E. Sh. për veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm” dhe dënimin e tij me 30 muaj burgim, parashikuar nga neni 137, paragrafi 1 (2 herë) dhe neni 199/a, paragrafi 2 i Kodit Penal; (iv) në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit E. Sh. me 36 muaj burgim; (v) në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale t’i ulet 1/3 e këtij dënimi, duke u dënuar përfundimisht me 24 muaj burgim.

**21.2.2.** Subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarës së vetme, në përfundim të gjykimit të çështjes gjyqësore, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 30.03.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, vendosi: (i) deklarin fajtor të të pandehurit E. Sh. për veprën penale “Ndërtim i paligjshëm” dhe në bazë të nenit 199/a/2 të Kodit Penal, dënimin e tij me 1 vit e 6 muaj burgim; (ii) deklarin fajtor të të pandehurit E. Sh. për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike” dhe në bazë të nenit 137/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me 1 muaj burgim; (iii) deklarin fajtor të të pandehurit E. Sh. për veprën penale “Vjedhja e energjisë elektrike ose impulseve telefonike” dhe në bazë të nenit 137/1 të Kodit Penal, dënimin e tij me 1 muaj burgim; (iv) në bazë të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit E. Sh. me 1 vit e gjashtë muaj burgim; (v) në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale t’i ulet 1/3 e këtij dënimi, duke u dënuar përfundimisht i pandehuri E. Sh. me 1 vit burgim; (vi) në vuajtjen e dënimit me burgim të llogaritet dhe koha e qëndrimit me masë sigurimi personal “arrest në shtëpi”, nga data 27.06.2014 e caktuar me vendimin gjyqësor nr. {\*\*\*} akti, datë 27.06.2014, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**21.3.** Nga aktet e dosjes penale, trupi gjykues konstaton faktet dhe rrethanat e kësaj çështjeje penale. Lidhur me veprën penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, rezulton se më datë 27.10.2013, nga policia gjyqësore, bazuar në informacionin e Inspektoratit Ndërtimor të Urbanistikës Vendore (në vijim “INUV”), dega Durrës, është referuar se në zonën bregdetare në afërsi të Shkëmbit të Kavajës, në territorin e Komunës Rashbull, në afërsi të restorant “{\*\*\*}”, po ndërtohej pa leje të organeve kompetente një objekt shumëkatësh nga shtetasi E. Sh.. Më datë 17.10.2013, nga përfaqësues të INUV, është mbajtur procesverbali me nr. {\*\*\*}, datë 17.10.2013 dhe vendimi nr. {\*\*\*}, datë 18.10.2013, “Për pezullim punimesh”. Më pas, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.10.2013, nga Kryeinspektori i Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor të Komunës Rashbull, është nxjerrë vendimi “Për prishje të objektit”, në të cilin është përshkruar se objekti është 2 kate dhe një kat nën tokë. Më datë 26.10.2013, është pyetur rreth këtij fakti shtetasi E. Sh., i cili ka deklaruar se nuk ka dijeni se kush është personi që po ndërton objektin pa leje. Më datë 30.10.2013, prokurori i çështjes ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal nr. {\*\*\*} për këtë vepër penale. Nga tabela fotografike e përpiluar më datë 27.10.2013, objekti ka qenë i ndërtuar me 4 kate dhe garazhe, ndërsa më datë 28.04.2014, rezulton me 7 kate dhe garazhe. Më datë 13.05.2014, rezulton që kjo pasuri me sipërfaqe 839 m<sup>2</sup> dhe sipas azhornimit që i është bërë më datë 28.11.2012, rezulton të jetë në pronësi të shtetit. Vendimi i prishjes së këtij objekti të kundërligjshëm është ekzekutuar nga INUK më datë 29.05.2014 dhe shtetasi E. Sh. ka filluar të sistemojë sheshin dhe të ndërtojë përsëri pa leje të organeve kompetente. Ky fakt është konstatuar më datë 02.07.2014 nga patrulla e policisë, e cila ka konstatuar se në zonën e plazhit, te Shkëmbi i Kavajës, në objektin e prishur nga INUK, i ndërtuar nga E. Sh., po ndërtohej një mur rrethues mbi katin e nëndheshëm që kishte ngelur nga prishja. Veprimi për këqyrjen e vendit të ngjarjes është pasqyruar në procesverbalin e datës 02.07.2014, së bashku me fotografitë përkatëse, dhe më datë 03.07.2014, nga policia gjyqësore është bërë referimi te prokurori.

Ndërsa sa i përket konsumimit të veprës penale të “Vjedhjes së energjisë elektrike dhe impulseve telefonike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal, rezulton se “CEZ Shpërndarja” ShA, pasi ka evidentuar abonentët debitorë, ka organizuar grupe pune për të marrë masa administrative ndaj tyre. Në këtë kuadër, pas njoftimit të bërë abonentit E. Sh., me nr. kontrate {\*\*\*}, grupi i punës ka shkuar tek objekti privat, pallati 25-katësh pranë rërës, në zonën e Shkëmbit të Kavajës, në lagjen nr. {\*\*\*}, {\*\*\*}, Durrës, të cilit i kanë ndërprerë energjinë elektrike duke mbajtur procesverbalin përkatës, pasi ky abonent rezultonte debitor, në shumën prej 1.824.387 lekësh, për periudhën 2011-2014, ku ndërprerjen e energjisë e kanë shoqëruar me fotografitë përkatëse, duke pasqyruar këtë veprim. I njëjti grup pune për të verifikuar zbatimin e masave të marra, më datë 26.04.2014, ka ushtruar përsëri kontroll ndaj abonentit E. Sh.. Nga kontrolli i ushtruar, është konstatuar se ky abonent e kishte rilidhur energjinë e ndërprerë duke mos respektuar masën e vënë nga “CEZ Shpërndarja” ShA, veprim të cilin ky grup pune e ka shoqëruar me procesverbalin e konstatimit të rilidhjes së energjisë në mënyrë të paligjshme dhe fotografitë përkatëse të konstatimit të rilidhjes. Për këtë fakt, pas konstatimeve dhe mbajtjes të procesverbaleve nga ky grup pune, “CEZ Shpërndarja” ShA, Drejtoria Rajonale Durrës, ka paraqitur kallëzim në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

Procedimi penal i mësipërm është bashkuar me procedimin nr. {\*\*\*} të vitit 2014, i regjistruar më herët, sjellë me vendim për shpallje moskompetence nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Kavajë. Në kuadër të këtij të fundit, nga hetimet e zhvilluara për këtë procedim penal, rezulton se “CEZ Shpërndarja” ShA, pasi ka evidentuar abonentët debitorë, ka organizuar grupe pune për të marrë masa administrative ndaj tyre. Në këtë kuadër, pas njoftimit të bërë abonentit E. Sh. me nr. kontrate {\*\*\*}, ky grup pune ka shkuar tek objekti privat kantier ndërtimi në zonën e Shkëmbit të Kavajës, në lagjen nr. {\*\*\*}, {\*\*\*} Durrës, të cilit i kanë ndërprerë energjinë elektrike më datë 27.01.2014, duke mbajtur procesverbalin përkatës, pasi ky abonent rezultonte debitor, në shumën 5.490.820 lekë, për periudhën 2011-2014. Nga kontrolli i ushtruar nga grupi i punës tri ditë më pas, më datë 30.01.2014, është konstatuar se ky abonent e kishte rilidhur energjinë e ndërprerë.

**21.4.** Në vendimin penal objekt shqyrtimi, gjyqtarja Anita Mici çmon se veprat penale në ngarkim të të pandehurit E. Sh. janë plotësisht të provuara, prandaj ai duhet të deklarohet fajtor për kryerjen e veprave penale për të cilat akuzohet. Në lidhje me caktimin e llojit dhe masës së dënimit në funksion të individualizimit të dënimit, duke respektuar llojin dhe kufijtë e masave të dënimit të parashikuar nga dispozitat konkrete, neneve 199/a/2 dhe 137/1 të Kodit Penal, në vlerësim të gjykatës, veprat penale janë me rrezikshmëri shoqërore mesatare; lidhur me rrezikshmërinë e autorit, gjykata çmon se në gjykim nuk u provua asnjë rrethanë rënduese, ndërsa si rrethana lehtësuese çmohen: fakti që i pandehuri është i padënuar më parë, mosha e të pandehurit dhe personaliteti i tij shumë i mirë, rrezikshmëria shoqërore që ai paraqet nuk është shumë e lartë, fakti që ai është kryefamiljar me gjendje jo të mirë shëndetësore, fakte të provuara gjatë gjykimit me akte shkresore; veprat penale janë kryer me dashje direkte (të drejtpërdrejtë). Për sa i përket llojit të dënimit, ndërmjet alternativave të dënimit që parashikon dispozita konkrete e Kodit Penal, neni 199/a/2 dhe neni 137/a i tij, gjykata çmon se për një arritje sa më të plotë të qëllimit të dënimit si në drejtim të autorit të veprës penale, ashtu edhe në drejtim të shoqërisë në përgjithësi, duhet të jetë ai me burgim, siç u kërkua dhe nga përfaqësuesi i akuzës, në masë proporcionale me rrezikshmërinë e veprës, vetë autorit dhe tërësisë së rrethanave lehtësuese të përshkruara më lart.

**21.5.** Kundër këtij vendimi kanë ushtruar ankim si i pandehuri, ashtu edhe prokurori i çështjes. Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 19.05.2016, Gjykata e Apelit Durrës ka vendosur: “Lënien në fuqi të



vendimit penal nr. {\*\*\*}, datë 30.03.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjykata e Apelit Durrës e ka gjetur të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë sa i përket llojit e masës së dënimit, dhënë ndaj të pandehurit. Gjykata e Apelit Durrës arsyeton se: *Masa e dënimit penal është rezultat i vlerësimit të rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale, shkallës së fajit të autorit të veprës penale, pasojave të ardhura nga vepra penale, si dhe rrethanave lehtësuese e rënduese në referim të parashikimeve të nenit 47 e vijues të Kodit Penal. [...] Gjykata, duke pasur parasysh edhe doktrinën e konsoliduar evropiane në këtë fushë, ka theksuar se që të jetë i pranueshëm dënimi penal në aspektin kushtetues, në përputhje me nenin 17/1 të Kushtetutës, duhet të jetë i drejtë edhe në përpjesëtim me veprën. Në këtë mënyrë, që të mund të ketë një proces riedukativ të suksesshëm, duhet që ndëshkimi penal të perceptohet nga autori i veprës si i drejtë dhe në përpjesëtim me veprën e kryer (vendimi nr. 19, datë 01.06.2011, i Gjykatës Kushtetutës). Masa e dënimit e dhënë nga gjykata e shkallës së parë vlerësohet se është në përshtatje me rrezikshmërinë shoqërore të veprës dhe autorit, rezultat i vlerësimit të drejtë të të gjitha elementeve dhe rrethanave që përbëjnë faktin penal, në respektim të parashikimeve të nenit 47 e vijues të Kodit Penal.*

**21.6.** Në kuadër të procesit të rivlerësimit, vendimi penal i dhënë nga subjekti i rivlerësimit për këtë çështje penale, është një nga 5 (pesë) dosjet e përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, në kuadër të vlerësimit të aftësive profesionale, sipas parashikimit të nenit 43, pika 2 e ligjit nr. 84/2016. Në raportin e hollësishëm dhe të arsyetuar nr. {\*\*\*} prot., datë 03.12.2019, “Për analizimin e aftësisë profesionale të gjyqtarës Anita Mici”, KLGj-ja arsyeton se subjekti i rivlerësimit ka aftësi në arsyetimin ligjor të vendimeve penale, por ka raste me mangësi në mënyrën e caktimit të dënimit. Gjyqtarja në këtë dosje penale ka keqinterpretuar nenin 55 të Kodit Penal për bashkimin e dënimeve, dhe në dy raste në caktimin e masës së dënimit, gjykata ka keqinterpretuar nenin 47 të Kodit Penal, duke cenuar parimin e proporcionalitetit të përcaktuar nga neni 1/c i Kodit Penal dhe neni 17/1 i Kushtetutës, që lidhet me mënyrën dhe masën e caktimit të dënimit penal.

Për çështjen penale në fjalë, KLGj-ja në raport citon se: *[...] Masa e dënimit e caktuar nga gjykata me 1 vit burgim për të tria veprat penale me anë të procedurës së gjyqimit të shkurtuar dhe bashkimit të dënimeve është në kufijtë minimalë që parashikon vetëm dispozita e njëjës vepër penale, ajo e nenit 199/a/2 e K.Penal, ose 20% e masës së dënimit maksimal. Ndërsa për veprën penale të nenit 137/1 të K.Penal, gjykata ka dhënë 2 dënime me nga 1 muaj burgim, dhe në bashkim të tyre 1 muaj burgim ose 3% të masës së dënimit maksimal të kësaj dispozite, dhe në bashkim të dënimeve sipas nenit 55/3 të Kodit Penal, është dhënë dënimi më i rëndë për veprën penale të nenit 199/a/2 të Kodit Penal. [...] Në rastin konkret, në funksion të një politike të drejtë penale, vihet re se të dyja veprat penale janë shumë të përhapura, i pandehuri E.Sh. paraqet rrezikshmëri të theksuar shoqërore, ai i ka kryer veprimet e kundërligjshme me përsëritje për të dyja veprat penale, ushtron aktivitet privat në plazhin e Durrësit, në një objekt 25-katësh, dhe dëmi i shkaktuar me energjinë elektrike për periudhën 2011-2014, arrin shumën 5.480.820,45 lekë. Kjo masë dënimi nuk është në proporcion mes së drejtës të kufizuar dhe interesit publik apo dëmit të shkaktuar palës së dëmtuar, si dhe synimit që kërkon të arrijë dënimi penal. [...] Në rastin konkret, i pandehuri ka vepruar me dashje direkte të dyja veprat penale, megjithëse ka qenë i ndëshkuar më parë me masë administrative për të dyja rastet (prishje të objektit dhe prerje të energjisë elektrike), e cila është shkallë më e rëndë e fajit, me qëllim të posaçëm nxjerrjen e përfitimit të paligjshëm. Këto aspekte nuk duhet të analizohen veç e veç, por të gërshetuara me njëra-tjetrën. Nuk ka asnjë rrethanë lehtësuese sipas nenit 48 të K.Penal, por gjykata ka çmuar të tilla rrethana të përgjithshme, sipas nenit 49 të K.Penal, dhe ka rrethanë rënduese në nenin 50, germa “h” e K.Penal (kryerja e veprës më shumë se një herë). Në këtë kuptim, masa e dënimit të caktuar nga gjykata është dhënë në*

*keqinterpretim të neneve 47 dhe 55 të Kodit Penal dhe, për rrjedhim, ka cenuar parimin e proporcionalitetit të përcaktuar nga neni 1/c i K.Penal dhe neni 17/1 i Kushtetutës (shih edhe vendimin nr. 19/2011 dhe nr. 47/2012 të Gjykatës Kushtetuese. Në bazë të nenit 72/4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pa zëvendësuar interpretimin dhe logjikën e gjyqtarit, ky vendim të merret në konsideratë për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.*

**21.7.** Lidhur me konstatimet në raportin e KLGj-së, për çështjen në ngarkim të të pandehurit E. Sh., subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në Komision dhe në parashtrimet në Kolegj ndaj shkaqeve të ankimit të Komisionerit Publik, sqaron se ka caktuar një dënim proporcional, në respektim të përcaktimeve të nenit 55/3 të Kodit Penal, duke caktuar dënimin më të rëndë të shtuar. Dënimi penal, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk mund të jetë mbledhje matematikore e dënimeve për çdo vepër penale, gjë që më pas u konsiderua nga Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 9, datë 26.02.2016, si shkelje e parimeve kushtetuese e që bie ndesh dhe me përmbajtjen logjike të nenit 1/c të Kodit Penal. Në vijim, subjekti i rivlerësimit parashtron se në kuptim të ligjit penal, i pandehuri do të konsiderohet përsëritës vetëm nëse do të ishte deklaruar fajtor dhe dënuar më parë, me vendim gjyqësor dhe jo dënim administrativ. Veprat penale të konsumuara nga i pandehuri, sipas subjektit të rivlerësimit, nuk paraqesin rrezikshmëri të theksuar shoqërore, moshë e tij e madhe dhe gjendja shëndetësore e tij kanë bërë që të hetohet e gjykohet me masë sigurimi “arrest në shtëpi”<sup>40</sup>. Gjykata zëvendësoi masën e sigurimit, duke konkluduar në një masë më të butë, mbështetur në: 1. epikrizën mjekësore të datës 21.06.2014, lëshuar nga mjeku i klinikës së kardiologjisë; 2. epikrizën e mjekut neurolog, datë 23.06.2014, në Spitalin Rajonal Durrës, fakt i marrë në konsideratë dhe në gjykimin e akuzës në themel nga subjekti i rivlerësimit, në drejtim të caktimit të një mase dënimi afër minimumit të parashikuar nga ligji, pa cenuar asnjë dispozitë ligjore të aplikueshme. Subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, sjell në vëmendje që vendimi i dhënë prej saj është lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës edhe në lidhje me masën e dënimit, duke mos u cenuar në asnjë element ligjor, pas kontrollit gjyqësor rishikues, vendimmarrja e gjykatës së shkallës së parë është gjetur e bazuar në ligj e në prova në tërësinë e saj.

**21.8.** Ashtu siç pretendon edhe Komisioneri Publik, trupi gjykues konstaton se në vendimin objekt vlerësimi, arsyetimi lidhur me masën e dënimit është i përgjithshëm, duke mos analizuar mjaftueshëm shkaqet që çuan në këtë masë dënimi, në raport me rrethanat e veprave penale dhe konsistencën në kryerjen e tyre. Në kuadër të parimit se kontrolli i ligjshmërisë për vendimet gjyqësore, kryhet nga gjykata më e lartë, në rastin konkret, edhe pse Gjykata e Apelit Durrës e ka gjetur të drejtë masën e dënimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit, është KLGj-ja, si organi ndihmës i këtij procesi rivlerësimi, si organi i qeverisjes së sistemit të drejtësisë me funksion kushtetues në vlerësimin e gjyqtarëve të të gjitha niveleve, që në raportin e vlerësimit të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, ka parashtruar fakte dhe rrethana që evidentojnë mangësi të subjektit në drejtim të caktimit të masës së dënimit, që përbëjnë dhe shkaqet e ankimit të Komisionerit Publik, të cilat trupi gjykues i gjen të drejta, duke marrë parasysh fenomenin e krijuar nga përhapja në masë e këtyre veprave penale.

**21.9.** Trupi gjykues, me konsideratë të dhënat nga aktet në dosjen gjyqësore, evidentoi mungesë në

<sup>40</sup> Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*} akti, datë 27.06.2014, vendosi: “Zëvendësimin e masës së sigurimit personal “Arrest në burg”, caktuar ndaj të dyshuarit E. Sh. [...] në atë të “Arrestit në shtëpi”, parashikuar nga neni 237 i Kodit të Procedurës Penale. Lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin e datës 31.07.2014.

arsyetimin ligjor të subjektit të rivlerësimit në drejtim të caktimit të masës së dënimit në ngarkim të shtetasit E. Sh.. Në këtë çështje gjyqësore, duket se subjekti nuk ka vlerësuar drejt faktet dhe rrethanat e kryerjes së veprave penale, si: vepra penale “Vjedhje e energjisë elektrike dhe impulseve telefonike”, e parashikuar nga neni 137, paragrafi 1 i Kodit Penal, që ishte kryer dy herë nga i pandehuri, i cili ndër të tjera rezultoi të ketë rilidhur energjinë në mënyrë të kundërligjshme, pasi ndaj tij ishte marrë sanksioni administrativ i ndërprerjes së saj; vlera e konsiderueshme për të cilën ky shtetas rezultonte debitor; si dhe ndëshkimin e tij sa i përket veprës penale “Ndërtimi i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a, paragrafi 2 i Kodit Penal, vepër që është kryer pasi ishte zbatuar më parë sanksioni administrativ i prishjes së ndërtimit të paligjshëm. Trupi gjykues i Kolegjit në këtë çështje, konstaton se subjekti i rivlerësimit ka zbatuar në mënyrë të gabuar nenet 47 dhe 55 të Kodit Penal, në caktimin e masës së dënimit, gjë që afekton indikatorin e parashikuar nga neni 72, pika 3 e ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në drejtim të arsytimit ligjor, sa i përket cilësisë së analizës dhe argumentimit logjik, në proporcionalitetin e masës së dënimit të disponuar.

22. Lidhur me vendimin penal nr. {\*\*\*}, datë 26.11.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, pjesë e raportit të vlerësimit të aftësive profesionale të hartuar nga KLGj-ja, Komisioneri Publik vlerëson se duhen marrë në konsideratë gjetjet dhe vlerësimet e raportit të hartuar nga KLGj-ja, për mungesë të arsytimit ligjor nga ana e subjektit të rivlerësimit, lidhur me caktimin e masës dhe llojit të dënimit në vendimin objekt vlerësimi.

22.1. Nga analiza e akteve të dosjes, çështja penale nr. {\*\*\*} regj. them., datë 22.10.2015, i përket të pandehurit Sh. M., i akuzuar për veprën penale të “Kontrabandës me mallra që paguhet akcizë”, të parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal. Referuar akteve të fashikullit gjyqësor, rezultoi se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 21.10.2015, ka dërguar për gjykim procedimin penal nr. {\*\*\*} të vitit 2015 dhe në diskutimet përfundimtare, të datës 26.11.2015, ka kërkuar: (i) deklarin fajtor të të pandehurit Sh. M., për veprën penale “Kontrabandë me mallra që paguhet akcizë”, parashikuar nga neni 172 i Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim; (ii) në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale, të zbritet një e treta e dënimit, duke u dënuar përfundimisht me 4 muaj burgim; (iii) bazuar në nenin 63 të Kodit Penal, për shkak të rrezikshmërisë së paketë të pandehurit, të pezullohet ekzekutimi i vendimit të dënimit me burgim dhe zëvendësimin e tij, me detyrimin e të pandehurit Sh. M. të përmbushë me 40 orë punë në interes publik, në Ndërmarrjen e Pastrim Gjellbërimit pranë Bashkisë Durrës, që duhet ta kryejë për një afat prej 2 muajsh; (iv) detyrimin e të pandehurit Sh. M., që të mbajë kontakt me Shërbimin e Provës së Qarkut Durrës, gjatë periudhës së kryerjes së 40 orëve në interes publik; (v) në zbatim të neneve 36, pika 1, germa “a” e Kodit Penal dhe 190, pika 1, germa “a” e Kodit të Procedurës Penale, sendet e sekuestruara në cilësinë e provës materiale (20 steka cigaresh të markës “Malboro” e bardhë, “Murati” dhe “Merit”) të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit.

22.2. Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 26.11.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, subjekti i rivlerësimit, ka vendosur, sipas kërkesës së prokurorit të çështjes, konkretisht: (i) deklarin fajtor të të pandehurit Sh. M. për veprën penale të “Kontrabandës me mallra që paguhet akcizë” dhe, në bazë të nenit 172 të Kodit Penal, dënimin e tij me 6 (gjashtë) muaj burgim; (ii) në aplikim të nenit 406 të Kodit të Procedurës Penale i ulet 1/3 e këtij dënimi, duke u dënuar përfundimisht me 4 (katër) muaj burgim; (iii) në aplikim të nenit 63/1 të Kodit Penal, urdhërohet pezullimi i ekzekutimit të dënimit me burgim, duke u urdhëruar i pandehuri të punojë në funksion të publikut pa shpërblim,

për një periudhë prej 40 orësh pune, që do ta kryejë brenda 6 muajve nga dita që vendimi do të marrë formë të prerë, sipas programit që do të hartohet nga Shërbimi i Provës Zyra Vendore Durrës. [...]; (v) në zbatim të nenit 36/1, germa “a” e Kodit të Procedurës Penale dhe nenit 190/1, germa “a” e Kodit të Procedurës Penale, sendet e sekuestruara në cilësinë e provës materiale (20 steka cigaresh të markës “Malboro” e bardhë, “Murati” dhe “Merit”) të konfiskohen dhe të kalojnë në favor të shtetit [...]. Më datë 07.12.2015, vendimi ka marrë formë të prerë për arsye të mosushtrimit të ankimit ndaj tij.

**22.3.** Referuar raportit profesional të KLGj-së, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës i është referuar analizës së rrezikshmërisë shoqërore të autorit të saj (e pakët) të paargumentuar, si dhe rrethanave lehtësuese, por të padetajuara. Në këtë raport, citohet: [...] *Masa e dënimit të caktuar nga gjykata, me 4 muaj burgim, sipas procedurës së gjykimit të shkurtuar, është në kufijtë minimalë që parashikon dispozita për nenin 172 të Kodit Penal ose rreth 5 % e masës së dënimit maksimal. Kjo masë dënimi nuk është në proporcion mes dëmit të shkaktuar të të drejtave të palës së dëmtuar dhe synimit që kërkon të arrijë dënimi penal. [...] Nuk ka asnjë rrethanë lehtësuese sipas nenit 48 të Kodit Penal, por gjykata ka çmuar të tilla rrethana të përgjithshme sipas nenit 49 të Kodit Penal, ka 1 rrethanë rënduese në nenin 50, germa “b” e këtij kodi (kryerja e veprës për të siguruar përfitime pasurore). Gjithashtu gjykata ka keqinterpretuar nenin 63/1 të K.Penal, duke pezulluar ekzekutimin e vendimit dhe zëvendësuar atë me punë në interes publik, pasi dispozita kërkon rrezikshmëri të pakët të personit dhe rrethana në favor të tij. Përkundrazi, vepra penale, si dhe autori i saj paraqesin rrezikshmëri të theksuar shoqërore. Në këtë kuptim, masa e dënimit të caktuar ka cenuar parimin e proporcionalitetit të përcaktuar nga neni 1/c i Kodit Penal dhe neni 17/1 i Kushtetutës (shih edhe vendimin nr. 19/2011 dhe nr. 47/2012 të Gjykatës Kushtetuese. Në bazë të nenit 72/4 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, pa zëvendësuar interpretimin dhe logjikën e gjyqtarit, ky vendim të merret në konsideratë për vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit.*

**22.4.** Lidhur me këtë çështje, subjekti i rivlerësimit, si në Komision, edhe në Kolegj është shprehur se ka caktuar të njëjtin lloj, masë dhe alternativë të vuajtjes së dënimit të kërkuar nga përfaqësuesi i akuzës dhe se ka zbatuar drejt kërkesat e nenit 63 të Kodit Penal, pasi nga tërësia e rrethanave objektive të çështjes dhe dënimit të caktuar për të pandehurin plotësohen kërkesat e kësaj dispozite. I pandehuri ka paraqitur rrezikshmëri mjaft të ulët shoqërore, ka qenë i padënuar më parë dhe sasia e kontrabandës me mallra akcize ka qenë tejet e ulët, 20 steka cigare. Për këtë rast, është dhënë dhe një dënim plotësues apo masë ndëshkuese financiare që së bashku çojnë në caktimin e drejtë të dënimit, në përputhje me nenin 47 të Kodit Penal dhe që arrin plotësisht qëllimin e posaçëm të dënimit penal në drejtim të autorit të veprës penale. Dënimi, sipas subjektit, jep efekte të plota pasi e ka ndëshkuar në dy drejtime autorin, ku ndëshkimi financiar në këto raste sjell ndjeshmëri mjaft të mirë në përmbushjen e qëllimit penal.

Subjekti i rivlerësimit parashton se relativizimi apo ashpërsimi i vlerësimit të kujt do *post factum* dhe *de plano* është larg realitetit dhe standardit ligjor të perceptimit të gjallë që gjyqtari përfton nga çështja në çështje dhe gjatë procesit gjyqësor. Disponimi në cilësinë e gjyqtarit lidhet me mënyrën e vlerësimit të provave, rrethanave konkrete objektive që ka prezantuar rasti dhe duhet vlerësuar si pjesë e zgjidhjes së çështjes në themel. Sipas subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Mici, bazuar në standardet ndërkombëtare që garantojnë pavarësinë e gjyqtarit, vendimet e dhëna prej saj nuk duhet të konsiderohen në zbatim të gabuar të ligjit penal, për shkak të vlerësimit ndryshe të fakteve dhe rrethanave apo provave nga organi vlerësues. Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të KE-së

(2010)12 thekson se në marrjen e vendimit, gjyqtari duhet të jetë i pavarur, i paanshëm dhe i aftë për të marrë vendime pa asnjë ndikim, ndërhyrje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nga çdo autoritet, duke përfshirë edhe autoritetet e brendshme të gjyqësorit, sanksionuar dhe në nenin 145 të Kushtetutës, por pa nënkuptuar se gjyqtari nuk mban përgjegjësi për punën e kryer gjatë ushtrimit të funksionit të tij.

22.5. Trupi gjykues, me konsideratë faktin që subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, në cilësinë e gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, ka vendosur masën e dënimit dhe dënimin plotësues të kërkuar nga prokurori i çështjes, pavarësisht se ky element nuk përbën detyrim ligjor për t'u zbatuar nga gjykata, duke vlerësuar sasinë e mallit kontrabandë dhe zbatimin e nenit 63, pika 1 e Kodit Penal<sup>41</sup> për kryerjen e një pune në interes publik, çmon se disponimi i subjektit të rivlerësimit në këtë çështje nuk duket se shkon përtej bindjes së brendshme të krijuar në bazë të provave, rrethanave të çështjes dhe dispozitave të zbatueshme.

23. *Lidhur me vendimin penal nr. {\*\*\*}, datë 15.05.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, Komisioneri Publik pretendon se, referuar rolit dhe kompetencës së institucioneve të rivlerësimit në shqyrtimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit, si dhe kriterëve vlerësuese të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i këtij rasti, në kushtet e konstatimeve të përsëritura, Komisioneri Publik vlerëson se duhen marrë në konsideratë gjetjet dhe vlerësimet e raportit të hartuara nga organi inspektues i kohës, në drejtim të mungesës së analizës dhe argumentimit logjik të subjektit, në vendimin objekt vlerësimi. Trupi gjykues, në analizë të këtij pretendimi, konstaton:*

23.1. Komisioni, në vendim, në analizë të shpjegimeve të subjektit të rivlerësimit, si dhe provave të administruara, çmon se subjekti i rivlerësimit ka argumentuar ligjërisht të gjithë procedurën e ndjekur lidhur me gjykimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurisë. Komisioni vlerëson se, për sa kohë është shqyrtuar çështja e themelit, madje rezultojnë se i pandehuri është shpallur i pafajshëm, në një logjikë të drejtë, të bazuar në prova dhe ligj, edhe zëvendësimi i masës së arrestit ndaj të pandehurit rezultojnë të jetë trajtuar nga subjekti në mënyrë korrekte, në kohë dhe procedurë, duke u bazuar në kërkesa procedurale ndaj organit të akuzës, grumbullim të provave dhe fakteve të reja në dobi të procesit deri në zëvendësimin e masës.

23.2. Trupi gjykues vëren se kjo çështje është sjellë në vëmendje të Komisionit, si rezultat i përgjigjes së Ministrisë së Drejtësisë drejtuar Komisionit me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 04.01.2018, në lidhje me informacionin që Komisioni ka kërkuar në kuadër të procesit të rivlerësimit, lidhur me të dhënat statistikore, dokumentet ligjore, vlerësime, si dhe të dhëna mbi ankesat ndaj subjektit të rivlerësimit për shkak të detyrës apo vlerësimeve për masa disiplinore. Me këtë shkresë, përcillet dhe praktika e inspektimit të kryer nga Ministria e Drejtësisë në vitin 2016.

23.2.1. Nga aktet e administruara në dosjen gjyqësore, rezultojnë se me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.03.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, në cilësinë e gjyqtares së çështjes, vendosi të vlerësojë të ligjshëm arrestimin në flagrancë të të dyshuarit B. P., i dyshuar për kryerjen e veprës penale të “Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese”, e mbetur në

---

<sup>41</sup> Neni 63, paragrafi 1 i Kodit Penal parashikon: “Gjykata, për shkak të rrezikshmërisë së pakët të personit dhe të rrethanave të kryerjes së veprës penale, kur ka caktuar një dënim gjer në një vit burgim, mund të vendosë pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe zëvendësimin e tij me detyrimin që i dënuari të përmbushë një punë në interes publik”.

tentativë, dhe “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit”, të parashikuara nga nenet 79/dh e 22 dhe 287/5 të Kodit Penal, dhe të caktojë si masë sigurimi personale ndaj të dyshuarit B. P. atë të “arrestit në burg”, parashikuar nga neni 238 i Kodit të Procedurës Penale.

**23.2.2.** Për sa i përket inspektimit të kryer nga ministri i Drejtësisë, rezulton se me urdhrin nr. {\*\*\*}, datë 15.04.2016, “Për ushtrim inspektimi në 9 gjykata”, u krye inspektimi në 9 (nëntë) gjykatat e rretheve gjyqësore, duke përfshirë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, me objekt verifikimin e zbatimit të dispozitave procedurale penale në gjykimin e kërkesave për vleftësim ndalim/arresti dhe caktimin e masave të sigurimit personal në çështjet e gjykuara nga këto gjykata. Në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, u inspektua vendimi nr. {\*\*\*}, datë 15.05.2015, i marrë ndaj shtetasit B. P.. Ky inspektim inicioi si rezultat i shqetësimit të ngritur nga ministri i Punëve të Brendshme, përcjellë nëpërmjet shkresave të shumta Ministrisë së Drejtësisë, për raste abuzimi në zbatimin e masave të sigurimit personal, duke çuar në dekurajim të forcave të rendit dhe duke lënë të lirë persona me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Një nga shkresat është edhe ajo nr. {\*\*\*} prot., datë 22.02.2016, që u adresohet disa gjykatave, dhe ku përcillet dhe shqetësimi i drejtorit të Policisë së Shtetit, mbi vendime dhe urdhra kontradiktorë ose në papajtueshmëri me ligjin gjatë zbatimit të masave.

**23.2.3.** Në këtë shkresë, pasi përshkruhet ngjarja kriminale, citohet se Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 15.05.2015, për shtetasin B. P. ka vendosur ndryshimin e masës së sigurimit personal nga “arrest në burg” në masën e sigurimit personal “detyrim paraqitjeje në policinë gjyqësore”. Gjyqtare në këtë çështje ka qenë znj. Anita Mici. Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, është bërë ankimi i këtij vendimi dhe Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 11.06.2015, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 15.05.2015, të Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, duke caktuar masën e sigurimit personal “Arrest në burg” për shtetasin B. P., i cili është shpallur në kërkim nga ana e Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës, pasi nuk është paraqitur sipas masës së sigurimit të dhënë më parë.

**23.2.4.** Në raportin<sup>42</sup> e hartuar mbi inspektimin e kryer në zbatim të urdhrin të ministrit të Drejtësisë, rezulton të jetë përcaktuar se, në zbatim të përcaktimeve të nenit 260/2 të Kodit të Procedurës Penale<sup>43</sup>, grupi i inspektimit ka vlerësuar se nuk kanë qenë kushtet ligjore për të pranuar kërkesën e të arrestuarit B. P. për zëvendësimin e masës së sigurimit personal, pasi nevojat e sigurisë nuk janë zbutur, janë të njëjtat si në fillim, për të njëjtën ngjarje që ishin duke u kryer veprime hetimore në lidhje me autorët e saj. Nevojat e sigurisë nuk kanë ndryshuar dhe aq më tepër të kenë evoluar në favor të të dyshuarit, për të konkluduar në një konkluzion kategorik se ai nuk duhet të jetë me atë masë sigurimi. Nevojat e sigurimit nuk mundet që të ndryshojnë nëse merren në shqyrtim vetëm provat që organi i akuzës mbledh gjatë hetimeve paraprake. Nuk ka ndryshim të akuzës në një akuzë më të lehtë apo nuk paraqiten shkaqe shëndetësore apo familjare që të justifikojnë uljet e nevojave të sigurimit. Sipas raportit, pavarësisht kalimit të afatit dymujor nga momenti i caktimit të masës së sigurimit që përkon me dhënien e informacionit për veprimet hetimore, nga provat dhe të gjitha rrethanat objektive që janë kryer veprat penale, rezulton se masa e sigurimit që është aplikuar më

<sup>42</sup> Raport “Mbi inspektimin e kryer në Gjykatat e Rretheve Gjyqësore Tiranë, Shkodër, Durrës, Elbasan, Kurbin, Vlorë, Gjirokastrë, Kavajë e Dibër, mbi verifikimin e ankesës së një institucioni publik”, qershor 2016, i hartuar nga Drejtoria e Inspektimit Gjyqësor dhe Prokurorisë në Ministrinë e Drejtësisë.

<sup>43</sup> Në nenin 260, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, përcaktohet se: “Kur nevojat e sigurimit zbuten ose kur masa e zbatuar nuk i përgjigjet më rëndësisë së faktit ose dënimit që mund të caktohet, gjykata e zëvendëson masën me një tjetër më të lehtë”.

parë nga ana e gjykatës, është e vetmja masë e përshtatshme sipas kritereve të nenit 230, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, për të bërë një hetim të plotë dhe objektiv dhe në raport me rrezikshmërinë e veprës dhe të autorit dhe kushteve të tjera të evidentuara në këtë procedim.

**23.2.5.** Në observacionin mbi konkluzionet e raportit të inspektimit të ministrit të Drejtësisë, subjekti ka parashtruar, ndër të tjera, se: konkluzioni i inspektorëve se *nevojat e sigurimit nuk mundet të ndryshojnë nëse merren në shqyrtim vetëm provat që organi i akuzës mbledh gjatë hetimeve paraprake*, është absurd dhe një trajtim thellësisht i gabuar i rastit që vjen si rezultat i mosnjohjes së ligjit (i referohet nenit 246, pika 6 e Kodit të Procedurës Penale dhe vendimit unifikues, pjesë integrale e ligjit, vendimi unifikues nr. 1, datë 08.01.2009<sup>44</sup>, i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë) dhe një konceptimi juridik të gabuar; konkluzioni se *nuk ka ndryshim të akuzës në një akuzë më të lehtë apo nuk paraqiten shkaqe shëndetësore apo familjare që të justifikojnë uljen e nevojave të sigurimit*, është një vlerësim i gabuar i ligjit procedural penal pasi shtetasi B. P. nuk ka pasur cilësinë e të pandehurit me akuzë konkrete të njoftuar, por ka qenë person nën hetim, ndaj të cilit vijonin hetimet deri në kualifikimin ligjor të akuzës që do të rezultojë e provuar në fund të tyre; në përfundim të afatit 2-mujor të hetimit, masa e sigurimit nuk i përgjigjej më rëndësisë së faktit dhe jo akuzës, e cila nuk ishte ngritur. Provat e reja<sup>45</sup> ndryshuan faktin penal që i atribuohet shtetasit B. P., trajtuar në vendimin gjyqësor nr. {\*\*\*}, datë 15.05.2015 dhe, si pasojë e rezultateve negative të ekspertimit, gjykata ka konkluduar se shtetasit B. P. nuk mund t'i atribuohet fakti penal për të cilin kishte nisur hetimi, pasi të gjitha provat e përjashtonin përfshirjen e tij në qitjen me armë zjarri dhe ai nuk mund të vijonte të qëndronte në “arrest në burg”,

---

<sup>44</sup> Në vendimin unifikues nr. 1, datë 08.01.2009, Kolegjet e Bashkuara arrijnë në përfundimin unifikues se: “[...] është në përgjegjësinë e prokurorit kompetent të ndërmarrë nismën e të përmbushë, në afat dhe në përmbajtje, detyrimet përkatëse sipas afateve e procedurave që parashikohen nga pika 6 e nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, në mënyrë që gjykata të rishqyrtojë periodikisht legjitimitetin e zbatimit të masës së sigurimit të arrestit, të cilën ajo gjykatë ia ka caktuar individit pikërisht mbi kërkesën e vetë organit të prokurorisë.

Gjykata nuk vihet në lëvizje kryesisht për të kërkuar nga prokurori kompetent përmbushjen e detyrimit të informimit dymujor, sipas dispozitës procedurale të lartpërmendur. Detyrimin për vënien në lëvizje të gjykatës, nëpërmjet paraqitjes së informacionit mbi të arrestuarin dhe gjendjen e procedimit, ligjëvënësi ia ngarkon prokurorit. Nëse ky i fundit nuk përmbush detyrimin në afat, i arrestuari legjitimohet të kërkojë rishqyrtimin e masës së sigurimit. Gjatë shqyrtimit gjyqësor të kërkesës, gjykata urdhëron prokurorin të riparojë shkëljen e ligjit duke depozituar menjëherë informacionin dhe të dhënat mbi gjendjen e procedimit, të cilat i nënshtrohen hetimit gjyqësor dhe debatit mes palëve”.

Në këtë kuadër, Kolegjet e Bashkuara vijnë në përfundimin tjetër unifikues se: “edhe në rastin e parashikuar nga pika 6 e nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, sikurse në rastet e tjera kur paraqitet kërkesë nga vetë i arrestuari, në interpretim e zbatim të drejtë të pikës 2 të nenit 28 të Kushtetutës dhe të pikës 4 të nenit 5 të Konventës, gjykata e shqyrton çështjen në seancë gjyqësore dhe duhet të vendosë me shpejtësi, për vijimin, revokimin, ose zëvendësimin e masës së sigurimit. [...] Prandaj, Kolegjet e Bashkuara çmojnë se i përket në radhë të parë gjykatës, detyrimi që të sigurojë zbatimin efektiv të garancive kushtetuese të lidhura me respektimin e së drejtës themelore të lirisë së personit, në kuptimin që caktimi e zbatimi i masave të sigurimit, veçanërisht asaj të arrestit, të mos tejkalojnë kohën e arsyeshme. Për këtë qëllim, edhe pas caktimit të masës “arrest në burg”, pavarësisht nga mënyra e vënies së saj në lëvizje, në çdo rast, gjykata duhet të shqyrtojë në seancë gjyqësore të gjitha rrethanat e lidhura me ekzistencën ose jo të interesit publik real që justifikon vazhdimin e zbatimit të kësaj mase. Në këtë gjykim, ajo mban parasysht edhe respektimin e parimit të prezumimit të pafajësisë, si dhe natyrën e masës së arrestit si përjashtim nga rregulli kushtetues i respektimit të lirisë individuale”.

<sup>45</sup> (1) Akt ekspertimi nr. {\*\*\*}, datë 23.03.2015: “nga trajtimi kimiko-fizik i materialeve objekt ekspertimi të fiksuara gjatë këqyrjes në vendin e ngjarjes së ndodhur më datë 19.03.2015 [...], nuk u përfutuan gjurmë papilare me vlera identifikimi”; (2) akti i ekspertimit nr. {\*\*\*}, datë 26.03.2015, për teshat e marra dhe të sekuestruara shtetasit B. P. menjëherë pas ngjarjes, teshat të cilat ai ka pasur veshur në kohën e ndodhjes së ngjarjes dhe në konkluzion të tij, ka rezultuar se: “Në këmbishën objekt ekspertimi (marrë shtetasit B. P.), nuk u evidentua prania e nitriteve dhe nitrateve, të cilat janë të pranishme edhe te faktorët plotësues të qitjes me prejardhje nga baruti”; (3) akti i ekspertimit nr. {\*\*\*}, datë 26.03.2015: “Në dy shiritat ngjitës të marrë si model nga duart e shtetasit B. P., nuk u evidentuan prani e nitrateve e nitriteve, të cilat janë të pranishme edhe te faktorët plotësues të qitjes me prejardhje nga barutet”.

për një krim që nuk e kishte kryer, pavarësisht qëndrimit të Gjykatës së Apelit.

**23.2.6.** Në vijim të observacioneve, gjyqtarja parashtron se inspektorët nuk janë thelluar të verifikojnë se procedimi penal ka shkuar për gjykim më datë 23.02.2016, dhe akuza e ngritur për shtetasin B. P. nuk është ajo e parashikuar nga nenet 79, 22 e 278/5 të Kodit Penal, por, më datë 20.10.2015, nga prokurori i çështjes merret vendimi “Për marrjen si të pandehur dhe njoftimin e akuzës” për veprën penale të “Moskallëzimit të krimit”, parashikuar nga neni 300/1 i Kodit Penal, ndërsa më datë 19.02.2016, merret vendim “Mbi ndryshimin e akuzës” duke i komunikuar akuzën për veprën penale të parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal, “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake dhe municionit”. Vepra për të cilën akuzohet ky shtetas, dënohet me gjobë ose burgim deri në shtatë vjet, duke u ulur dukshëm rëndësia e dënimit penal, si një fakt që shkon në favor të mungesës së çdo pasoje të vendimmarrjes. Subjekti pretendon se ka garantuar rolin e gjykatës në fazën e hetimit paraprak në respektim të plotë të ligjit procedural penal dhe vendimit unifikues.

**23.2.7.** Në shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 06.09.2016, të ministrit të Drejtësisë, drejtuar ministrit të Punëve të Brendshme, në përgjigje për shqetësimet e ngritura, i bën me dije se në përfundim të inspektimit, është konkluduar se në 6 raste, gjyqtarët nuk kanë respektuar dispozitat procedurale të parashikuara nga nenet 228, 229, 230 e 260 të Kodit të Procedurës Penale, lidhur me kushtet dhe kriteret e caktimit të masës së sigurimit apo zëvendësimin e saj. Për sa më sipër, është vlerësuar se shkeljet e konstatuara nuk janë në atë shkallë që të passjellin fillimin e një procedure disiplinore ndaj gjyqtarëve, *por duhet të mbahen në konsideratë në rast përsëritjeje në të ardhmen prej tyre.*

**23.3.** Për t’iu rikthyer vendimit objekt vlerësimi, nga aktet në dosje, rezulton se pas caktimit të masës së sigurimit “arrest në burg”, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.03.2015, personi nën hetim B. P., më datë 28.04.2015, paraqet kërkesë për zëvendësimin e masës së sigurimit personal drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Kjo kërkesë vjen pas administrimit të aktit të ekspertimit për faktorë plotësues të qitjes, aktit të ekspertimit teknik për prezencë gjurmësh papilare, zbardhjes së videos dhe fotove të sekuestruara në cilësinë e provës. Në kushtet kur sipas rrethanave, nuk ekzistonte asnjë provë qoftë me dëshmitarë, shkresore apo shkencore që të përfshinte si autor të dyshuar për veprat penale për të cilat është bërë regjistrimi i procedimit penal dhe caktimi i masës së sigurimit ndaj tij, bazuar në nenin 260, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, personi nën hetim dhe avokati i tij kërkojnë zëvendësimin e masës së sigurimit me një tjetër më të lehtë. Për të vërtetuar pretendimet e paraqitura në këtë kërkesë, i kërkohet gjykatës që në vështrim të nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, të disponojë paraprakisht informacionin në lidhje me ecurinë e hetimit në mbështetje të pretendimit në kërkesë.

**23.4.** Më datë 14.05.2015, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës, dërgon në gjykatë informacion në lidhje me personin nën hetim dhe Gjykata e Shkallës së Parë Durrës, në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 15.05.2015, për pranimin e kërkesës për zëvendësimin e masës së sigurimit, arsyeton se nuk ka asnjë pengesë ligjore, madje është detyra e saj që të marrë në shqyrtim kriteret mbi individualizimin e masës së sigurimit personal të parashikuar qartë nga nenet 228, 229 dhe 230 të Kodit të Procedurës Penale, për më tepër kur kanë kaluar afër 2 muaj nga zbatimi i masës së sigurimit “arrest në burg”, e cila duhet të verifikohet edhe në kuptim të nenit 246, pika 6 e këtij kodi. Në vijim të arsyetimit, gjykata vlerëson se në kuptim të nenit 260, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, duhet të vlerësojë ndryshimin e rrethanave për personin për të cilin kërkohet ndryshimi i masës së sigurimit në raport me nevojat e sigurimit që kërkon rasti. Gjykata rivlerëson ekzistencën



e kushteve dhe kriterëve të neneve 228 dhe 229 të Kodit të Procedurës Penale, në vëmendje të rrethanave të reja që kanë rezultuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Personi nën hetim është një person me një personalitet të mirë, i padënuar më parë. Nuk rezultojnë rrethana që i dyshuari të kryejë krime të tjera të rënda apo të të njëjtit lloj me atë për të cilin rezultojnë të dhëna provuese sipas nenit 300/1 të Kodit Penal. Vepra penale për të cilën dyshohet aktualisht personi nën hetim, nuk dyshohet të përsëritet më prej tij, pasi gjykata çmon se pavarësisht veprës penale për të cilën është regjistruar procedimi penal ndaj këtij personi, me provat e reja të administruara nga organi i akuzës, përjashtohet dyshimi për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 79/dh, 22 dhe 278/5 të Kodit Penal dhe vazhdon të ketë dyshime se ka kryer veprën penale të parashikuar nga neni 300/1 i këtij kodi. Gjkata çmon se personi nën hetim mundet të hetohet me një masë sigurimi me të butë, siç është ajo e detyrimit për t'u paraqitur në policinë gjyqësore, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, në përputhje dhe me parimin e prezumimit të pafajësisë dhe të drejtës së lirisë, parashikuar nga Kushtetuta, KEDNj-ja dhe praktika gjyqësore e Gjykatës së Lartë, vendimi nr. 140, datë 21.12.2005.

Në rastin konkret, gjykata çmon se i dyshuari nuk paraqet rrezikshmëri të veçantë, siç kërkohet në nenin 230, pika 1 e Kodit të Procedurës Penale, duke çmuar se nevojat e sigurimit nuk janë të një niveli kaq ekstrem, sa për të lënë në fuqi masën e sigurimit “arrest në burg”. Gjkata gjithashtu vlerëson edhe shkallën dhe nevojat e sigurimit në rastin konkret, për një zbatim korrekt të kërkesave të nenit 246, pika 6 e Kodit të Procedurës Penale dhe vendimit unifikues të Gjykatës së Lartë nr. 1, të vitit 2009. Fakti penal për të cilin ngrihen dyshime në këto momente, është tërësisht i ndryshëm nga fakti penal për të cilin është caktuar masa e sigurimit “arrest në burg”, gjendje e cila bën që të mos ketë më justifikim për zbatimin e masës së sigurimit arrest në burg. Për të garantuar mbarëvajtjen e hetimit dhe eventualitetin e gjykimit të tij, si dhe për të minimizuar eventualitetin e ikjes me qëllim shmangien nga dënimi dhe dhënien e drejtësisë, gjykata çmon të caktojë masën e sigurimit “detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore”, parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale, masë e cila do të garantojë një kontroll periodik të të dyshuarit dhe paraqitjen e tij tek organi procedues.

**23.5.** Kundër këtij vendimi, ka ushtruar ankim Prokuroria pranë Gjykatë së Shkallës së Parë Durrës, duke kërkuar prishjen e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 15.05.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me të cilin është zëvendësuar masa e sigurimit “arrest në burg”, caktuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.04.2015, për personin nën hetim për veprën penale të “Vrasjes në rrethana cilësuese”, të mbetur në tentativë, si dhe të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve dhe municioneve luftarake”, të parashikuara nga nenet 79/dh, 22 dhe 278/5 të Kodit Penal, në masën e sigurimit “detyrim për t'u paraqitur në policinë gjyqësore”, të parashikuar nga neni 234 i Kodit të Procedurës Penale.

**23.6.** Gjkata e Apelit Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 11.06.2015, vendosi ndryshimin e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 15.05.2015, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe rrëzimin e kërkesës së personit nën hetim për zëvendësimin e masës së sigurimit “arrest në burg” me një masë sigurimi më të butë, duke arsyetuar se vendimi i gjykatës së shkallës së parë është marrë në zbatim të gabuar të ligjit, pasi nuk plotësohen kushtet e nenit 260/2 të Kodit të Procedurës Penale. Në rastin konkret, nevojat e sigurisë nuk janë zbutur dhe janë të njëjtat kushte si në nisjen fillestare, për të cilat janë duke u kryer veprime hetimore për të arritur në një përfundim të drejtë dhe objektiv në raport me veprat penale dhe autorët, si dhe pozicionin e secilit prej tyre në këto vepra. Nuk kanë ndryshuar kushtet e dyshimeve të arsyeshme të bazuara në prova për veprat penale dhe për të

dyshuarin B. P.. Nevojat e sigurisë nuk kanë ndryshuar dhe aq më tepër të kenë evoluar në favor të të dyshuarit për të konkluduar në një konkluzion kategorik se ai nuk duhet të jetë me atë masë sigurimi. Nevojat e sigurimit nuk mundet që të ndryshojnë nëse merren në shqyrtim vetëm provat që organi i akuzës mbledh gjatë hetimeve paraprake. Nuk ka ndryshim të akuzës në një akuzë më të lehtë apo nuk paraqiten shkaqe shëndetësore apo familjare që të justifikojnë uljen e nevojave të sigurimit. Pavarësisht kalimit të afatit dymujor nga momenti i caktimit të masës së sigurimit që përkon me dhënien e informacionit për veprimet hetimore, rezulton nga provat dhe nga të gjitha rrethanat objektive që janë kryer veprat penale, se masa e sigurimit që është aplikuar më parë nga ana e gjykatës është e vetmja masë e përshtatshme sipas kriterëve të nenit 230/1 të Kodit të Procedurës Penale, për të bërë një hetim të plotë dhe objektiv dhe në raport me rrezikshmërinë e veprës dhe autorit, si dhe kushteve të tjera të evidentuara në këtë procedim.

**23.7.** Pas dërgimit të vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës, për ekzekutim në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Durrës, me shkresën nr. {\*\*\*} prot., datë 11.06.2015, “Dërgohet urdhër ekzekutimi i vendimit nr. {\*\*\*}, datë 11.06.2015, i Gjykatës së Apelit Durrës për kërkuesin B. S. P., së bashku me vendimet gjyqësore” dhe nga të dhënat e dërguara nga kjo drejtori me shkresën me nr. {\*\*\*} prot., datë 22.07.2015, rezulton se nga kërkimet për ekzekutimin e masës së sigurimit “arrest në burg” për shtetasin B. P., nuk është arritur të bëhet kapja e tij dhe ekzekutimi i masës pasi ky shtetas rezulton se ka dalë jashtë shtetit më datë 09.06.2015, nga pika kufitare Morinë, Kukës. Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 24.07.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës vendosi pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe deklarimin e ikjes për shtetasin B. P..

**23.8.** Më datë 23.02.2016, prokurorja e çështjes, pas kryerjes së veprimeve hetimore dhe studimit të akteve të procedimit penal, dërgon para Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, kërkesën për gjykimin e çështjes penale nr. {\*\*\*} të vitit 2015. Në këtë kërkesë, citohet se: *në kushtet kur rezulton e provuar se nga makina e të pandehurit B. P., është marrë arma me të cilën është realizuar qitja në vendin e ngjarjes, nga ana jonë, me vendimin e datës 19.02.2016, është ndryshuar akuza për të pandehurin B. P., duke e akuzuar për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve dhe municioneve luftarake”, të parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal, që ka të bëjë me mbajtjen pa leje të armës që është përdorur në vendin e ngjarjes në automjetin tip Benz, me targë {\*\*\*}, në përdorim të tij.* Prokuroria, në përfundim, për këtë shtetas, kërkon gjykimin e tij për veprën penale të parashikuar nga neni 278/5 i Kodit Penal.

**23.9.** Gjatë hetimit administrativ në Komision dhe me parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit sqaron se ka vepruar në zbatim të drejtë të nenit 260/2 të Kodit të Procedurës Penale, provave të reja të rezultuara në dinamikë të hetimit, në respektim dhe të nenit 246 të këtij kodi, që legjitimon gjykatën të rivlerësojë kushtet dhe kriteret për zbatimin e masës ekstreme arrest në burg. Subjekti ka vlerësuar se në këtë rast nuk mund të vijohej me këtë masë sigurimi, pasi faktet në ngarkim të shtetasit, për shkak të rezultateve të akteve të ekspertimit, nuk ishin më të rëndësishme për të cilën ishte regjistruar procedimi penal në ngarkim të tij, por shkonin në çdo rast deri në moskallëzimin e krimit. Subjekti i rivlerësimit sqaron se mbetet ende e paqartë se ku konsistojnë shkeljet procedurale të konstatuara nga inspektorët e Ministrisë së Drejtësisë, pasi subjekti ka respektuar të gjitha parashikimet procedurale të gjykimit. Çmuarja e provave, shqyrtimi apo interpretimi i tyre është në tagrin absolut të gjykatës dhe një organ administrativ nuk mundet kurrësi të bëjë interpretim të provave. Edhe përfaqësuesi i akuzës, pasi mbajti disa muaj çështjen në hetim, pa marrë asnjë provë të re, në shkelje të afateve të hetimit dhe të të drejtave të personit nën hetim, ka konkluduar në ndryshimin e akuzës, madje prokurori është treguar jokohorent në qëndrimin e tij përgjatë procesit,

duke komunikuar, shfuqizuar e ndryshuar akuzën. Në mbështetje të argumenteve të saj, subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, referon disa vendime<sup>46</sup> të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, sipas së cilave është mbajtur qëndrim se arsyetimi i gjykatave vendase do të konsiderohet i papërshtatshëm nëse është “abstrakt” ose i “bazuar në stereotipe”. Ndërsa sa i përket rrezikut të largimit, GjEDNJ-ja<sup>47</sup> gjithashtu ka deklaruar se ai nuk mund të matet vetëm në bazë të ashpërsisë së dënimit të mundshëm që personi rrezikon, por duhet të vlerësohet duke iu referuar disa faktorëve të tjerë të rëndësishëm, si veçanërisht, karakteri i personit, morali i tij, shtëpia, profesioni, pasuria, lidhjet familjare dhe të gjitha lidhjet e tij me shtetin ku ai po ndiqet penalisht, si dhe lidhjet e tij ndërkombëtare.

**23.10.** Sipas subjektit të rivlerësimit, është gjykata që, në zbatim të nenit 246 të Kodit të Procedurës Penale, vlerëson provat e grumbulluara në korelacion me faktin penal dhe fatin e procedimit penal. Vendimi nr. {\*\*\*}, datë 11.06.2015, i Gjykatës së Apelit Durrës mbeti i pazbatueshëm dhe nuk ka sjellë asnjë pasojë. Personi në hetim, për akuzën përfundimtare, është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë, pasi Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 15.11.2016, vendosi deklarin të pafajshëm të të pandehurit B. P. për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të municioneve”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal në fuqi, përpara ndryshimeve të vitit 2013 të Kodit Penal, në bazë të nenit 388/d të Kodit të Procedurës Penale dhe shuarjen e masës së sigurimit “Arrest në burg”, dhënë me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 11.06.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës, vendim ky i lënë në fuqi nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 30.11.2017.

**23.11.** Për sa parashtruar më sipër, trupi gjykues vlerëson se pavarësisht zgjidhjes në themel të çështjes, ku i pandehuri B. P. është deklaruar i pafajshëm për veprën penale të “Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe të municioneve”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal në fuqi, përpara ndryshimeve të vitit 2013 të Kodit Penal, në bazë të nenit 388/d të Kodit të Procedurës Penale dhe shuarjen e masës së sigurimit “Arrest në burg”, dhënë me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 11.06.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës, përsëri ky fakt nuk justifikon mungesën e analizës ligjore të subjektit të rivlerësimit në drejtim të zëvendësimit të masës së sigurisë, nga “arrest në burg” në “detyrim për paraqitje në policinë gjyqësore”, në kushtet kur nuk plotësoheshin kërkesat e parashikuara nga neni 260, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale, që lidhen me ndryshimin e nevojave të sigurisë, si arsyetuar në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 11.06.2015, të Gjykatës së Apelit Durrës.

**24.** *Lidhur me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.12.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës,* Komisioneri Publik pretendon se denoncimi i publikut, në referencë të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, përmban të dhënat e nevojshme për të vlerësuar mbi shkeljen, pasojat ligjore, rrethanat që krijojnë bindje se ka pasur shkelje ligjore. Në vlerësim të Komisionerit Publik: (i) cenimi i parimit të sigurisë juridike për palët në procesin gjyqësor, ka ardhur si pasojë e mosthirrjes së palës tjetër në gjykimin me objekt: “rivendosjen në afat të ankimit”, veprim i detyrueshëm nga ligji, që duhej të ishte kryer nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm që shqyrtoi kërkesën; (ii) në analizë të fakteve dhe rrethanave të dala nga hetimi administrativ i këtij rasti, në kushtet e konstatimeve të përsëritura, Komisioneri Publik çmon se vendimi gjyqësor objekt vlerësimi, i marrë nga subjekti i

<sup>46</sup> Çështjet: *Clooth kundër Belgjikës, 1991, Yagçi dhe Sargin kundër Turqisë.*

<sup>47</sup> Çështjet: *Neumeister kundër Austrisë 1968, paragrafi 10; Smirnova kundër Rusisë, Letellier kundër Francës, 1991, paragrafi 43.*

rivlerësimit në kundërshtim me një dispozitë urdhëruese të ligjit, sikurse neni 152 i Kodit të Procedurës Civile, duhet të merret në konsideratë dhe të vlerësohet në drejtim të mungesës së analizës ligjore dhe argumentimit; (iii) Kolegji i Posaçëm i Apelit, në vendimin orientues (JR) 21/2019, shprehet se: [...] *konsideron me rëndësi që për vlerësimin e aftësive profesionale, vëmendje t'i kushtohet edhe denoncimit të fakteve nga publiku [...]*, kur ekzistojnë kushtet dhe rrethanat e parashikuara në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016. Sa më sipër, rezultatet e hetimit të këtij denoncimi të administruar sipas nenit 53, duhen konsideruar dhe në funksion të qëllimit kushtetues për rritjen e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë.

**24.1.** Komisioni në vendim, vlerëson se rivendosja në afat ka pasur lidhje të drejtpërdrejtë me pavlefshmërinë e aktit të njoftimit të vendimit të themelit të çështjes së vitit 2001, për shkak të mungesës së njëres palë në shpalljen e vendimit, por nga ana tjetër, pa dyshim që pasoja e vendimmarrjes lidhet ngushtësisht me vijueshmërinë e ankimit për themelin e çështjes. Kjo mënyrë kërkimi hap rrugën e zhvillimit të procesit gjyqësor të themelit, për të cilin në fakt u provua që vetë pala që rezultonte në mungesë të kishte qenë pjesë e një marrëdhënieje kontraktore shitjeje të pasurisë objekt gjykimi i themelit, pas shpalljes së vendimit të themelit, çka në mënyrë të drejtpërdrejtë tregon për marrje dijani të saj lidhur me vendimin. Në këto kushte, ky ka qenë një element i rëndësishëm për t'u vlerësuar nga gjykata në rast të njoftimit të palës kundërshtare (sikurse e ka paraparë neni 152, paragrafi i parë i Kodit të Procedurës Civile) në procesin e rivendosjes, përveçse vlerësimit të afatit kohor tepër të gjatë të kërkimit të rivendosjes në afat nga gjykimi i themelit të çështjes, i cili duhet të bënte një lidhje logjike me pretendimin për mosmarrjen dijani të një vendimi për 10 vite radhazi. Por në vlerësim të përgjithshëm të rastit, nuk konstatohen problematika që të mund të ndikojnë në vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit.

**24.2.** Kjo çështje civile është përcjellë në vëmendje të Komisionit nëpërmjet denoncimit<sup>48</sup> të shtetasit N. P., adresuar subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Mici. Në këtë denoncim, thuhet se gjykimi për rivendosjen në afat është bërë pas 10 vitesh, kur kanë kaluar afatet ligjore të ankimimit, dhe procesi gjyqësor është bërë i fshehtë, pa u njoftuar pala paditëse, në kundërshtim të neneve 151, 152 të Kodit të Procedurës Civile. Sipas denoncuesit, pasi ka marrë vendimin në mënyrë të fshehtë, subjekti i rivlerësimit nuk zbardhte vendimin e arsyetuar dhe vetëm me kërkesë është dhënë vendimi pas 3 muajve.

**24.3.** Në këtë ankesë, denoncuesi bën me dije se në vitin 2001, babai i tij, me vendimin gjyqësor nr. {\*\*\*}, datë 30.11.2001, u njoh bashkëpronar në një pasuri të cilën e kishte fituar në mënyrë të ligjshme (para vitit 1945). Pas 10 vjetësh, gjyqtarja Anita Mici në mënyrë krejt arbitrare, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.11.2010, pranon rivendosjen në afat të palës kundërshtare për të bërë ankim në gjykatën e apelit. Ky vendim u bë pa u njoftuar dhe thirrur si palë, pala paditëse në gjykimin e themelit, në kundërshtim me rregullat e përcaktuara në Kodin e Procedurës Civile. Kërkesa mund të paraqitet vetëm brenda 1 viti nga dita e dhënies së vendimit. Në kundërshtim të hapur me dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, gjyqtarja Anita Mici, për motive të panjohura, jep një vendim haptazi të padrejtë. Pala kundërshtare menjëherë pas vendimit i ka dhunuar dhe plagosur anëtarët e familjes së denoncuesit, ku si pasojë e goditjeve të pësuar, i ati i denoncuesit ndërroi jetë pak muaj më pas.

**24.4.** Nga aktet në dosje, trupit gjykues i rezulton se me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 30.11.2001,

---

<sup>48</sup> Regjistruar në Komision me nr. {\*\*\*} prot., datë 26.12.2017.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës vendosi të pranojë kërkesëpadinë e paditësit J. P. (S.), duke e njohur bashkëpronar me të paditurit H. P. etj., trashëgimtarë të I. P. mbi sipërfaqen prej 10.000 m<sup>2</sup>, të ndodhur në lagjen nr. {\*\*\*}, Rruga e {\*\*\*}, Durrës. Pas kërkesës së shtetases H. P., subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, në cilësinë e gjyqtares së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.12.2010, vendosi pranimin e kërkesës së kërkuases H. P. dhe rivendosjen në afat të ankimit, kundër vendimit nr. {\*\*\*}, datë 30.11.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Në këtë vendim, është arsyetuar se kërkuësja H. P. pretendoi se kishte marrë dijëni për vendimin nr. {\*\*\*}, datë 30.11.2001, vetëm më datë 28.10.2010 dhe vendimi kishte marrë formë të prerë pa iu njoftuar kërkuases, me qëllim që të ushtronte të drejtën e ankimit në Gjykatën e Apelit Durrës. Kërkuësja pretendon se nuk i është njoftuar sipas rregullave procedurale një kopje e vendimit përfundimtar të gjykatës, duke i dhënë vendimit formë të prerë brenda një afati të tillë, që krijon idenë e të qenit prezent në gjykim. Në këtë vendim, thuhet se gjykimi i themelit ka përfunduar në mungesë të kërkuases H. P., me cilësinë e të paditurës në gjykim, fakt që rezultoi nga procesverbali i seancës gjyqësore dhe nga parashkrimet në pjesën hyrëse të vendimit të gjykatës. Vendimi është shpallur nga gjykata më datë 30.11.2001 dhe ka marrë formë të prerë më datë 18.12.2001. Sipas arsyetimit në vendim, dëftesa për komunikimin e vendimit që i takon kërkuases H. P., që mban datën e komunikimit 03.12.2001, konstatohet qartë se nga njëra anë, te “marrësi i aktit”, pasqyrohet të ketë nënshkruar kërkuësja H. P. dhe firma, ndërsa te “komunikuesi” mungon tërësisht nënshkrimi i ftuesit gjyqësor, edhe pse janë komunikime të së njëjtës datë. Përfaqësuesi i kërkuases pretendoi se njoftimi është i pavlefshëm pasi, ndër të tjera, kërkuësja nuk ka ditur shkrim dhe lexim dhe nuk mund të shkruante emrin e saj në këtë akt. Ai pretendoi dhe pavlefshmërinë e njoftimit të vendimit për shkak se dëftesa komunikuese nuk përmban kundërfirmën e personit që ka bërë komunikimin për të provuar rregullsinë e kryerjes së tij.

Në kuptim dhe interpretim të përbashkët të dispozitave procedurale civile që parashikojnë rregulla urdhëruese mbi mënyrën e njoftimit të një akti të gjykatës dhe kërkesave të nenit 122 të Kodit të Procedurës Civile ku sanksionohet pavlefshmëria e njoftimit në mungesë të respektimit të dispozitave që kanë lidhje me mënyrën e bërjes së njoftimit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, në këtë vendim, çmon se në këtë rast komunikimi i vendimit, nëpërmjet mbajtjes së dëftesës së komunikimit, më datë 03.12.2001, për kërkuesen H. P., është i pavlefshëm dhe, për rrjedhojë, pa pasoja juridike për të, pasi provohet shkelja haptas e rregullave mbi njoftimin e akteve, pasi nga përmbajtja e tij nuk jepet asnjë e dhënë identifikuese mbi personin që ka bërë komunikimin e vendimit dhe lidhjen e tij me Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Durrës, që të ligjërojë veprimin e tij në ushtrim të detyrës funksionale në gjykatë. Në këtë rast, gjykata çmon se ky akt komunikues duhet të shpallet i pavlefshëm në kuptim të nenit 119/1,2 të Kodit të Procedurës Civile, pasi ai nuk është kryer në formën e kërkuar nga ligji shprehimisht, si dhe i mungojnë të dhëna të domosdoshme për arritjen e qëllimit të tij, siç është nënshkrimi dhe identifikimi i nëpunësit gjyqësor që ka njoftuar aktin. Në kuptim të nenit 458 të Kodit të Procedurës Civile, gjykata çmon se e drejta e palës për të kërkuar rivendosjen në afat të ankimit, nuk kushtëzohet me afat prekluziv nga koha e dhënies së vendimit, afat që hedh në dekadencë vetë të drejtën, por mund të realizohet në çdo kohë, kur pala vjen në dijëni dhe provon pavlefshmërinë e njoftimit, si në rastin konkret. Gjykata, nën argumentin ligjor të dispozitave të mësipërme, në kushtet që komunikimi i vendimit shpallet i pavlefshëm nga gjykata, ai mbetet një akt pa pasoja juridike e, për pasojë, kërkuases i lind e drejta të bëjë ankim kundër vendimit pasi ky vendim, në kuptimin substancial, nuk ka marrë formë të prerë për të. Ndërsa në kuptimin formal, për të mundësuar bërjen e ankimit ndaj një vendimi të cilit administrativisht i është dhënë forma e prerë, gjykata shprehet për rivendosjen e së drejtës të ankimit, duke i hapur rrugë paraqitjes formale të ankimit, pranë gjykatës që ka dhënë vendimin.

Gjykata çmon se kërkuesja ka humbur afatin e ankimit për shkaqe të arsyeshme që lidhen drejtpërdrejt me padijeninë e saj për ekzistencën dhe përmbajtjen e vendimit përfundimtar, për shkak të pavlefshmërisë dhe paefektshmërisë së komunikimit të vendimit (kërkuesja është gjykuar në mungesë), siç u provua në këtë gjykim.

**24.5.** Pas rivendosjes në afat dhe ushtrimit të ankimit nga kërkuesja H. P., Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 14.10.2013, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 30.11.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Gjykata e Apelit Durrës ka arsyetuar se nuk ekziston asnjë shkak për cenimin e vendimit të gjykatës si për njoftimin e palëve për seancat gjyqësore dhe zgjidhjen e themelit të çështjes. Nga materialet e dosjes, rezulton se gjykimi i çështjes është bërë në mungesë të palës së paditur H. P., por kjo nuk përbën shkelje për të zhvilluar gjykimin sepse e paditura është njoftuar rregullisht për të gjitha seancat, si përgatitore, edhe ato gjyqësore, por nuk është paraqitur, konkretisht më datat 30.04.2001, 14.05.2001, 28.05.2001 dhe 05.06.2001, pasi fletëthirret janë të firmosura nga vetë kjo shtetase në prani të ftuesit. Në këto kushte, gjykimi ka vazhduar në mungesë të saj, në zbatim të nenit 179 të Kodit të Procedurës Civile. Gjithashtu, në disa seanca gjyqësore, kanë marrë pjesë fëmijët e saj që në këtë gjykim janë të paditur, çka tregon pamundësinë e mosnjoftimit të H. P. për zhvillimin e këtyre seancave, pretendime këto të ngritura pas 10 vjetësh. Sa i përket themelit të çështjes, gjykata çmon se është zgjidhur drejt (*i referohet vendimit nr. {\*\*\*}, datë 30.11.2001*).

**24.6.** Në kuadër të procesit të rivlerësimit, me shpjegimet në Komision dhe parashtrimet në Kolegj, subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, sqaron se vendimi i dhënë prej saj, ka qenë në zbatim të nenit 458 të Kodit të Procedurës Civile<sup>49</sup>, me argumentin se e drejta e palës për rivendosjen në afat të ankimit nuk kushtëzohet me afat prekluziv nga koha e dhënies së vendimit, afat që hedh në dekadencë vetë të drejtën, siç parashikohej para ndryshimeve të kodit, por mund të realizohet në çdo kohë, kur pala vjen në dijeni dhe provon pavlefshmërinë e njoftimit të vendimit të dhënë në mungesë. Sipas subjektit të rivlerësimit, është konstatuar pavlefshmëria e njoftimit të vendimit në përputhje me nenet 122, 128, 130 të Kodit të Procedurës Civile dhe, në zbatim korrekt të tyre dhe të fakteve të provuara në gjykim, është konstatuar pavlefshmëria e njoftimit të vendimit përfundimtar. Në vijim të argumenteve të saj, subjekti i rivlerësimit sqaron se Gjykata e Apelit Durrës nuk e ka gjetur vendimin e dhënë prej saj, në kundërshtim me ligjin, pasi në vendimin e rivendosjes në afat, subjekti nuk ka marrë në shqyrtim njoftimet e seancave gjyqësore, pasi nuk është atribut i gjyqtarit që shqyrton rivendosjen në afat, por i gjykatës së apelit kur shqyrton çështjen në themel. Rasti konkret lidhet me aktet njoftuese pas dhënies së vendimit përfundimtar, që janë pjesë administrative e dosjes gjyqësore, që lidhet drejtpërdrejt me marrjen dijeni efektivisht të palës në mungesë për vendimin gjyqësor. Në gjykimin me objekt rivendosjen në afat të ankimit, gjyqtari nuk mund të vlerësojë ligjshmërinë e njoftimeve që ka bërë dhe pranuar trupi gjykues në themel të çështjes, pasi ato janë vlerësime të gjyqtarit që ka gjykuar themelin dhe shqyrtohen për ligjshmëri vetëm nga gjykata më e lartë.

Subjekti i rivlerësimit gjithashtu pretendon se denoncuesi ka kuptuar gabim vendimin e rivendosjes në afat dhe shkaqet ligjore që kanë çuar gjykatën në dhënien e vendimit, duke e ngatërruar me njoftimet e gjyqimit të themelit, që s'kanë të bëjnë me vlerësimet e subjektit të rivlerësimit, por i përkasin gjykatës së apelit. Mënyra e zgjidhjes nga Gjykata e Apelit qoftë në themel, qoftë në

---

<sup>49</sup> Neni 458 i Kodit të Procedurës Civile parashikon: “Kur palët kanë humbur të drejtën e ankimit për shkaqe të arsyeshme, mund të paraqesin kërkesë për rivendosje në afat, përpara gjykatës që ka dhënë vendimin. Kjo kërkesë shqyrtohet nga gjykata dhe kundër vendimit të saj mund të bëhet ankim i veçantë”.

zbatim të ligjit procedural civil nga gjykata e shkallës së parë, nuk ka lidhje me vlerësimin e shkeljes ligjore me pasojë pavlefshmërinë e njoftimit të vendimit. Ftuesi ligjor e ka respektuar ligjin kur i ka njoftuar vendimin Bashkisë Durrës dhe nuk e ka bërë për kërkesen H. P.. Në kushtet kur vendimi i shpallur në mungesë ka marrë formë të prerë pa u ankimuar, pala që ka humbur të drejtën e ankimit për shkaqe ligjore, e ushtron ankimin vetëm nëpërmjet rivendosjes në afat. Në këtë rast, gjykata shqyrton vetëm ligjshmërinë e akteve që kanë njoftuar vendimin përfundimtar dhe jo të akteve të njoftimit gjatë gjykimit të çështjes në themel.

24.7. Për sa parashtruar më sipër, trupi gjykues konstaton se instituti i rivendosjes në afat është rregulluar nga tri dispozitat e Kodit të Procedurës Civile, të cilat parashikojnë:

Neni 151 [para ndryshimeve me ligjin nr. 38/2017, datë 30.03.2017]<sup>50</sup>:

*Kur palët ose prokurori që ka ngritur padi, për shkaqe të arsyeshme, kanë humbur afatin ligjor ose atë të caktuar nga gjykata, mund të kërkojnë prej saj rivendosjen në afat, përveç kur afatet kanë karakter prekluziv.*

Neni 152:

*Kërkesa për rivendosjen e afatit të humbur shqyrtohet nga gjykata së cilës duhet t'i paraqiten edhe dokumentet që justifikojnë ose për të cilat kërkohet rivendosja e afatit. Gjatë shqyrtimit të kërkesës, thirrret edhe pala tjetër. Kundër vendimit të gjykatës mund të bëhet ankim i veçantë.*

Neni 458, “Rivendosja në afat e ankimit”:

*Kur palët kanë humbur të drejtën e ankimit për shkaqe të arsyeshme, mund të paraqesin kërkesë për rivendosje në afat, përpara gjykatës që ka dhënë vendimin. Kjo kërkesë shqyrtohet nga gjykata dhe kundër vendimit të saj, mund të bëhet ankim i veçantë.*

Dispozitat e sipërcituara nuk parashikojnë një afat kohor për ushtrimin e së drejtës së rivendosjes në afat, megjithatë prekluzivitetin e ankimit e ka paraparë neni 445 i Kodit të Procedurës Civile, sipas së cilit: *ankimi në gjykatën e apelit dhe rekursi në Gjykatën e Lartë nuk mund të bëhen pasi ka kaluar një vit nga shpallja e vendimit. Kjo dispozitë nuk zbatohet kur pala në mungesë vërteton se nuk ka qenë në dijeni të procesit gjyqësor, për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve.* Për këtë arsye, kërkesa për rivendosje në afat e ankimit, mund të paraqitet deri në një vit nga momenti i shpalljes së vendimit dhe pas kalimit të këtij afati, mund të paraqitet si rast përjashtimor vetëm nëse pala ka qenë në padijeni të zhvillimit të procesit gjyqësor dhe të vendimit për shkak të pavlefshmërisë së njoftimeve.

Ashtu siç është arsyetuar në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 14.10.2013, të Gjykatës së Apelit Durrës, nga materialet e dosjes, rezulton se gjykimi i çështjes është bërë në mungesë të palës së paditur H. P., por kjo nuk përbën shkelje për të zhvilluar gjykimin sepse e paditura është njoftuar rregullisht për të gjitha seancat, si përgatitore dhe ato gjyqësore, dhe nuk është paraqitur, e konkretisht, më datë 30.04.2001, datë 14.05.2001, datë 28.05.2001, datë 05.06.2001, pasi fletëthirrjet janë të firmosura nga vetë kjo shtetase në prani të ftuesit.

Në këto kushte, subjekti i rivlerësimit, në shqyrtimin e kërkesës për rivendosjen në afat të ankimit,

<sup>50</sup> Neni 151 i Kodit të Procedurës Civile, me ndryshimin me ligjin nr. 38/2017, parashikon: “Kur palët ose prokurori, për arsye që rrjedhin nga forca madhore ose që nuk mund të ishin parashikuar nga ata, kanë tejkalluar afatin procedural ligjor ose atë të përcaktuar nga gjykata, mund t’i kërkojnë gjykatës rivendosjen në këto afate procedurale, përveç kur afatet kanë karakter prekluziv”.

nuk duhet të ishte mjaftuar vetëm me analizimin e njoftimit të vendimit përfundimtar dhe pavlefshmërinë e këtij njoftimi në përputhje me nenet 119/1,2, 122, 128, 130 të Kodit të Procedurës Civile, por në harmoni me faktet dhe rrethanat e tjera, si njoftimi i rregullt i kërkuësës për seancat përgatitore dhe gjyqësore, çka do të çonte në mospranimin e kërkesës për rivendosje në afat, pasi do të provohej se nuk plotësoheshin kushtet e nenit 445 të Kodit të Procedurës Civile, që pala të mos kishte dijeni të procesit gjyqësor, që do të legjitimonte në këtë rast kërkesën për rivendosjen në afat në tejkalim të afatit 1-vjeçar nga shpallja e vendimit. Për më tepër, në kuadër të një procesi të rregullt ligjor, në shqyrtimin e kërkesës për rivendosjen në afat, duhet të ishte marrë në konsideratë koha e gjatë, gati 10 vjet, nga vendimi gjyqësor ndaj të cilit kërkohej rivendosja në afat për të ushtruar ankimin, si një afat i cili nuk duket se është i arsyeshëm për të ruajtur balancën mes parimit të sigurisë juridike dhe aksesit në gjykatë.

**24.8.** Për sa i përket pjesëmarrjes së palës tjetër në procesin gjyqësor të shqyrtimit, si një detyrim ligjor i parashikuar shprehimisht nga neni 152 i Kodit të Procedurës Civile, *gjatë shqyrtimit të kërkesës, thirret edhe pala tjetër*, në rastin objekt shqyrtimi duket se ky detyrim nuk është respektuar nga subjekti i rivlerësimit. Në kuptim të nenit 193 (para ndryshimeve me ligjin nr. 38/2017) të Kodit të Procedurës Civile, *gjykata, kur çmon se procesi gjyqësor duhet të zhvillohet në prani të një personi të tretë, i cili rezulton se ka interes në çështje, e thërret atë dhe për këtë qëllim, shtyn seancën gjyqësore*. Për sa më sipër, në kushtet kur me kërkesën për rivendosjen në afat, duhet të paraqitet dhe dokumenti për të cilin kërkohet rivendosja në afat, në rastin konkret vendimi nr. {\*\*\*} datë 30.11.2001, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, subjekti i rivlerësimit, për këtë arsye, duhet të kishte thirrur si pjesëmarrëse në proces edhe palën paditëse, si një palë me interes në këtë çështje.

**24.9.** Në këto kushte, trupi gjykues i gjen të drejta pretendimet e Komisionerit Publik, pasi rezulton e provuar se me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 23.12.2010, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, ka cenuar parimin e sigurisë juridike për palët në procesin gjyqësor, në kushtet kur nuk ka thirrur palën paditëse, në gjykimin e çështjes civile me objekt rivendosjen në afat të ankimit, në kundërshtim me parashikimet e nenit 152 të Kodit të Procedurës Civile. Duke pasur në konsideratë qëllimin e këtij parimi, që vendimet e formës së prerë të gjykatave të mos vihen në diskutim, subjekti i rivlerësimit duhet të kishte treguar një kujdes të veçantë, në zbatim të këtij parimi, së pari lidhur me kohën shumë të gjatë nga vendimi i formës së prerë në vitin 2001, duke vënë në rrezik kështu stabilitetin e vendimeve gjyqësore dhe paprekshmërinë e të drejtave të fituara tashmë nga pala. Nga ana tjetër, subjekti i rivlerësimit duhej të udhëhiqej nga parimi i barazisë së armëve duke bërë pjesëmarrës në këtë proces dhe palën paditëse.

**25.** *Lidhur me vendimin penal nr. {\*\*\*}, datë 05.12.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës, në të cilin subjekti i rivlerësimit është në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, Komisioneri Publik ka ngritur këto shkaqe ankimore: (i) vetë Komisioni ka kërkuar dhe administruar shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me shkaqet e rekursit të prokurorit të ushtruar ndaj këtij vendimi të Gjykatës së Apelit Durrës, duke konkluduar edhe në mangësi në analizën ligjore të subjektit të rivlerësimit, në lidhje me pretendimet për zbatimin e nenit 427/5 të Kodit të Procedurës Penale; (ii) në referencë të nenit E të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, sa kohë procesi i rivlerësimit të subjektit të rivlerësimit, në rastin konkret, do të përfundojë me marrjen e vendimit përfundimtar nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, Komisioneri Publik, ndryshe nga sa ka vendosur Komisioni për transferimin organit kompetent, për inspektimin e shkaqeve që mund të përbëjnë shkelje disiplinore,*



kërkon që kjo çështje të përfshihet në rrethin e vendimeve objekt vlerësimi të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, duke u administruar eventualisht vendimi që do të marrë Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë, mbi shkaqet e rekursit të prokurorit. Trupi gjykues i Kolegjit, në analizë të këtyre pretendimeve, konstaton:

**25.1.** Komisioni, në vendim, për këtë çështje, arsyeton se përtej kriterit të plotësimit të vuajtjes së  $\frac{3}{4}$  të dënimit, nuk janë konstatuar mangësi dhe madje as nuk ka pasur dyshime dhe nuk janë pretenduar mosplotësime të kriterëve të tjera ligjore për lirimin me kusht, as nga prokurori që ka paraqitur rekurs ndaj vendimit të subjektit të rivlerësimit dhe as nga Gjykata e Shkallës së Parë, që e ka rrëzuar kërkesën vetëm për moskryerjen e  $\frac{3}{4}$  të dënimit. Komisioni çmon se trupa gjykuese ku subjekti është anëtar, ndërsa ka aplikuar nenin 427/5 të Kodit të Procedurës Penale, nuk i është përmbajtur afatit të parashikuar nga kjo dispozitë për caktimin e seancës së radhës. Për sa kohë çështja është për gjykim në Gjykatën e Lartë, e cila ka në kompetencë jo vetëm ta zgjidhë atë, por edhe të unifikojë praktikën gjyqësore të çështjeve me natyrë të veçantë dhe me mundësi interpretimi të shumëfishtë, Komisioni, bazuar në nenin 72/4 të ligjit nr. 96/2016, çmon se nuk ka tagrin të vlerësojë gjykimin e korrektësisë së vendimit apo të analizojë themelin e çështjes gjyqësore, për sa kohë lehtësisht konstatohet se ankimi i organit të akuzës kryesisht i përket këtij niveli, pra, themelit të çështjes. Në tërësi, për sa është arsyetuar, Komisioni vlerëson se konstatimi ligjor më sipër, pa synuar të zëvendësojë apo cenojë logjikën e arsyetimit të subjektit në këto parashtrime dhe as në vendimmarrje lidhur me këtë çështje, përbën rrethanë që të konkludojë për dërgimin e kësaj çështjeje pranë organit të inspektimit për verifikime të mëtejshme nëse ka shkaqe për procedim disiplinor.

**25.2.** Nga aktet në dosjen gjyqësore, rezulton se me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 16.07.2014, të Gjykatës së Lartë, i gjykuari L. B. u deklarua fajtor për kryerjen e disa veprave penale, si: “Vrasje me paramendim”, kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga nenet 78/1 dhe 25 të Kodit Penal; “Vrasje me paramendim”, kryer në bashkëpunim, e mbetur në tentativë, parashikuar nga nenet 78/1, 25 dhe 22 të Kodit Penal; “Vrasje me dashje”, kryer në bashkëpunim; dhe “Vrasje me dashje”, e mbetur në tentativë, të parashikuara nga nenet 76, 25 dhe 22 të Kodit Penal, vepra të kryera ndaj disa shtetasve, si dhe për veprën penale “Prodhim dhe mbajtje pa leje të armëve dhe municioneve luftarake”, të parashikuara nga neni 278/2 i Kodit Penal. Përfundimisht, pas ndryshimit të pjesshëm të vendimit të Gjykatës së Apelit për Krime të Rënda, me të cilin ishte dënuar me burgim të përjetshëm, Gjykata e Lartë, në aplikim të nenit 55 të Kodit Penal, në bashkim të dënimeve, vendosi dënimin e të gjykuarit L. B. me 25 vjet burgim. Pas këtij vendimi, i dënuari ka vijuar me një sërë kërkesash drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë dhe Durrës, dhe ka përfituar ndryshimin e vuajtjes së dënimit nga një burg i sigurisë së lartë në një burg të zakonshëm dhe ulje të dënimit të mbetur.

**25.3.** Më datë 20.06.2016, i dënuari L. B. i drejtohet Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me kërkesën për pezullimin e ekzekutimit të vendimit me burgim dhe vazhdimin e vuajtjes së pjesës së mbetur të dënimit me qëndrim në shtëpi, sipas nenit 59/a të Kodit Penal. Më pas, paraqet kërkesë për ndryshimin e bazës ligjore të kërimit, nga neni 59/a i Kodit Penal në kërkesën për zbatimin e nenit 64 të Kodit Penal për “Lirimin me kusht”, në mbështetje të nenit 477 të Kodit të Procedurës Penale, kërkesë e rrëzuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 28.07.2016, si e pabazuar në ligj. Në këtë vendim, është arsyetuar se: *pavarësisht sjelljes pozitive të shkëlqyer që i dënuari L. B. ka pasur gjatë vuajtjes së dënimit e rrethanave të rënduara familjare, kërkesa e tij nuk mund të pranohet, pasi ai nuk ka plotësuar kushtin, nuk ka vuajtur  $\frac{3}{4}$  e dënimit*

*prej 25 vjetësh, dhënë me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 16.07.2014, të Gjykatës së Lartë. Nga dinamika e vuajtjes së dënimit, ai rezulton se ka vuajtur 18 vjet e 2 muaj e 9 ditë burgim, nga 25 vjet që është dënimi, pra nuk ka plotësuar kushtin prej  $\frac{3}{4}$  e vuajtjes së dënimit për të përfutuar nga neni 64 i Kodit Penal.*

**25.4.** Pas ankimit të ushtruar ndaj këtij vendimi, Gjykata e Apelit Durrës, në të cilën subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, ishte në cilësinë e anëtares së trupit gjykues, vendosi: ndryshimin e vendimit penal me nr. {\*\*\*}, datë 28.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; pranimin e kërkesës; lirimimin me kusht të të dënuarit L. A. B. nga vuajtja e mëtejshme e dënimit penal me burgim, dhënë me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 16.01.2012, të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ndryshuar me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 06.02.2015, të Gjykatës së Lartë, për pjesën e mbetur pa vuajtur, prej 6 vjet, 2 muaj e 22 ditë burgim; urdhërohet i dënuari që për një periudhë kohe prej 5 vjetësh të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës, Zyra Vendore Durrës, duke iu nënshtruar programit rehabilitues të përcaktuar nga kjo zyrë, me kusht që gjatë kësaj kohe të mos kryejë vepër tjetër penale; urdhërohet lirimi i të dënuarit L. B. nga IEVP Durrës.

Në këtë vendim, Gjykata e Apelit Durrës ka arsyetuar se: *në vlerësim të provave në dosjen gjyqësore, argumenteve të gjykatës së shkallës së parë dhe shkaqeve të ankimit, bazuar në kërkesat e nenit 427 të Kodit të Procedurës Penale, vendosi përsëritjen pjesërisht të shqyrtimit gjyqësor, me qëllim marrjen e provave të reja, të cilat nuk rezultonin të marra nga gjykata e shkallës së parë, prova të cilat iu nënshtruan vlerësimit në tërësinë e tyre, bashkë me ato të përfshira në dosjen gjyqësore. [...] Në kuadër të çeljes pjesërisht të shqyrtimit gjyqësor, mbrojtja e të dënuarit, paraqitur si provë vendimi i datës 01.12.2016<sup>51</sup> i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në të cilin rezulton se i dënuari L. B. kishte përfutuar ulje dënimi nga pjesa e mbetur, në masën 45 ditë, si dhe dinamikën e vuajtjes së dënimit për gjendjen e datës 02.12.2016. [...] Sipas dinamikës së vuajtjes së dënimit të datës 02.12.2016, rezulton se i dënuari L. B., nga dënimi i dhënë, ka kryer gjithsej 18 vjet, 9 muaj e 22 ditë, kohë në të cilën janë llogaritur dënimi i vuajtur fizikisht, periudha e përfutuar me paraburgim, si dhe uljet e dënimit që ai ka përfutuar ndër vite në zbatim të ligjit mbi ekzekutimin e dënimeve penale, përfshirë dhe uljen e përfutuar më datë 01.12.2016, bashkë me kohën e vuajtur deri ditën e shpalljes së vendimit nga Gjykata e Apelit. Kjo pasi në gjykimin në apel, u riçel pjesërisht shqyrtimi gjyqësor dhe, në këto rrethana, çdo provë e re e marrë u shqyrtua bashkë me provat e tjera. Duke qenë se vuajtja në masën  $\frac{3}{4}$  e dënimit prej 25 vjetësh burgim, përkthehet në vuajtjen fizikisht të një kohe prej 16 vitesh e 9 muajsh, konstatohet se kërkuesi L. B. ka vuajtur më shumë se  $\frac{3}{4}$  e dënimit të dhënë.*

**25.5.** Kundër vendimit penal nr. {\*\*\*}, datë 05.12.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës, ka ushtruar rekurs Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës, duke kërkuar prishjen e vendimit nr. {\*\*\*} të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 28.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, që ka rrëzuar kërkesën e kërkuesit L. B., për “Lirimimin me kusht”. Një pjesë e pretendimeve të ngritura nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës, konsistojnë, në sa vijojnë.

**25.5.1.** Vendimi i Gjykatës së Apelit Durrës është në shkelje të ligjit procedural penal, të neneve 152, 380 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, dhe të ligjit material penal, neni 64 i Kodit Penal,

<sup>51</sup> Me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 01.12.2016, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës vendosi pranimin pjesërisht të kërkesës së kërkuesit L. B. dhe, në bazë të nenit 63 të ligjit nr. 8323 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, të dënuarit i ulet 45 ditë burgim nga dënimi i dhënë me vendimin nr. 175, datë 16.07.2014, të Gjykatës së Lartë.

dhe në zbatim të gabuar të vendimit unifikues nr. 2, datë 25.05.2015, të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

**25.5.2.** Në kuptim të nenit 427 të Kodit të Procedurës Penale, përsëritja e shqyrtimit gjyqësor është kryer nga gjykata e apelit pa qenë e nevojshme, pasi thelbi i vendimeve që kërkonte gjykata pasqyroheshin qartë në urdhrin e ekzekutimit të prokurorit, si dhe në vendimin e Gjykatës së Lartë të administruar në fashikullin e gjykimit. Gjkata e Apelit nuk ka respektuar pikën 5 të nenit 427 të Kodit të Procedurës Penale, sipas së cilës shqyrtimi gjyqësor nuk mund të shtyhet për një afat më të gjatë se 10 ditë, siç ka vepruar Gjkata e Apelit Durrës, duke e shtyrë gjykimin për një muaj e pesë ditë.

**25.5.3.** Administrimi si prova i dinamikës së vuajtjes së dënimit, datë 02.12.2016, të IEVP Durrës dhe shkurtimi i vendimit nr. {\*\*\*}, datë 01.12.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili nuk kishte marrë formë të prerë, janë në shkelje të neneve 380 dhe 427 të Kodit të Procedurës Penale, pasi këto akte nuk mund të konsiderohen sipas pikës 2 të këtij neni, Gjkata e Apelit ka arritur në përfundim të gabuar për sa i përket përlllogaritjes së vuajtjes së dënimit.

**25.5.4.** Gjkata e Apelit ka gabuar duke pranuar të plotësuar  $\frac{3}{4}$  e dënimit, ditën e gjykimit në apel, në kundërshtim me nenin 64 të Kodit Penal, sipas të cilit të dënuarit i lind e drejta për të kërkuar lirimin me kusht kur plotëson  $\frac{3}{4}$  e dënimit e në këtë moment, i lind e drejta t'i drejtohet gjykatës për të përfituar nga favoru i kësaj dispozite, njëkohësisht institucionet përkatëse plotësojnë dokumentacionin sipas ligjit për trajtimin e të dënuarve.

**25.5.5.** Gjkata nuk ka mbajtur në konsideratë përfitimet nga uljet e dënimeve të cilat janë bërë nga gjykata e shkallës së parë, pa respektuar afatin në çdo vit, sipas nenit 63 të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve", i ndryshuar. Ndërkohë ka rezultuar se kërkuesi ka përfituar uljen e parë nga gjykata më datë 11.09.2015 dhe pa kaluar një vit, më datë 19.04.2016, gjykata ka bërë uljen e dytë me 90 ditë dhe më datë 01.12.2016, kur çështja ishte në gjykim në gjykatën e apelit, është bërë ulja e tretë me 45 ditë, pa plotësuar afatin 12 muaj nga ulja paraardhëse.

**25.5.6.** Gjkata nuk ka mbajtur në vlerësim faktin se veprat penale për të cilat është deklaruar fajtor dhe është dënuar kërkuesi, paraqesin një rrezikshmëri shumë të lartë shoqërore dhe koha e vuajtjes së dënimit me qëllim edukimin e të dënuarit duhet të jetë në proporcion me këtë rrezikshmëri shoqërore. Sa më e lartë të jetë rrezikshmëria shoqërore e veprës penale të kryer, aq më i thellë duhet të jetë hetimi gjyqësor në lidhje me riedukimin e të dënuarit.

**25.5.7.** As Raporti Vlerësues i Shërbimit të Provës, Zyra Vendore Durrës dhe as Vlerësimi i Sjelljes nga IEVP Durrës nuk kanë përcjellë në gjykatë informacionin që kërkon ligji për të konfirmuar marrëdhëniet e kërkuesit me të dëmtuarit ose me familjarët e viktimave, por është pranuar ky fakt vetëm mbi deklaratimet e vetë të dënuarit, kërkues në proces, në shkelje të nenit 31/6 të ligjit nr. nr. 8328, datë 16.04.1998, i ndryshuar dhe vendimit unifikues nr. 2/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

**25.6.** Gjatë hetimit administrativ në Komision, me shpjegimet mbi rezultatet e hetimit lidhur me çështjet e ngritura nga prokurori pranë Gjykatës së Apelit Durrës në rekurs, subjekti i rivlerësimit ka mbajtur qëndrimin si vijon.

**25.6.1.** Në respekt të ligjit dhe kontrollit vertikal të zbatimit të tij, dhënia përgjigje e pretendimeve rekursuese është atribut ligjor vetëm i Gjykatës së Lartë. Gjykata e Apelit është një gjykatë fakti dhe jo vetëm ligji, subjekti vlerëson se nuk ka pasur asnjë pengesë ligjore që të gjendej i plotësuar kushti i vuajtjes së 3/4 të dënimit në kohën e gjykimit në apel. Në lidhje me rrezikshmërinë e lartë të të dënuarit, subjekti sqaron se një element i tillë nuk është pjesë e kriterëve ligjore kumulative të parashikuara nga neni 64 i Kodit Penal, pasi rrezikshmëria e lartë e veprave penale është reflektuar në caktimin e dënimit, ku në zbatim të kërkesave të nenit 47 të Kodit Penal, gjykata që ka shqyrtuar çështjen e fajësisë dhe caktimin e dënimit në themel, ka reflektuar rrezikshmërinë shoqërore të veprave penale në masën e dënimit të dhënë.

**25.6.2.** Nëse lirimi me kusht sipas vlerësimit të subjektit, do të mohohet për shkak të rrezikshmërisë së lartë shoqërore të veprave penale të kryera, do të kishim penalizim të dyfishtë të të dënuarit për të njëjtin shkak, pasi po për shkak të rrezikshmërisë së veprave penale, i dënuari do të merrte një dënim të ashpër dhe po për këtë shkak, do të humbiste mundësinë e lirimit me kusht, institut që lidhet me rehabilitimin dhe riintegrimin e të dënuarit në shoqëri dhe jo me përcaktimin e dënimit si rrjedhojë e rrezikshmërisë shoqërore të krimit të kryer. Trupi gjykues në të cilin ka bërë pjesë subjekti, ka bërë një analizë të hollësishme të çdo të dhëne në lidhje me riedukimin e tij, sjelljen e vazhdueshme në institucion, angazhimin në programet rehabilituese, në nivele shumë të mira, që gjejnë pasqyrim në vendimin objekt shqyrtimi.

**25.6.3.** Në lidhje me përfshirjen në cilësinë e provave të reja edhe të vendimit të datës 01.12.2016 të gjykatës, për uljen e dënimit me 45 ditë, ndërkohë që vendimi i Gjykatës së Apelit daton më 05.12.2016, subjekti sqaron se kjo gjë jo vetëm nuk bie ndesh me ligjin, por është pjesë e hetimit të thelluar që ka bërë në vijimësi trupi gjykues, me qëllim krijimin e bindjes se i dënuari paraqet nivel të kënaqshëm rehabilitimi dhe mundësi reale riintegrimi nëpërmjet lirimit me kusht. Ulja e dënimit është përfitim në masën e dënimit të vuajtur, si sintezë e gjithë sjelljes së të dënuarit në institucionin e vuajtjes së dënimit, është tregues rehabilitimi për një të dënuar, mision i gjykatës në gjykimin për lirimin me kusht.

**25.6.4.** Në vijim, subjekti sqaron se në kushtet kur procesi i uljes së dënimit ka vetëm një palë procedurale, kërkuesin, dhe kërkimi i tij është pranuar, vendimi është i paankimueshëm, thënë ndryshe me ekzekutim të menjëhershëm, pasi i njeh të dënuarit të drejta që lidhen me lirinë personale të tij, bazuar në nenin 462, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale. Bazuar në këtë dispozitë, sipas subjektit, vendimi që ul dënimin në bazë të nenit 63 të ligjit të posaçëm nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar<sup>52</sup>, është përjashtim i pjesshëm i të gjykuarit nga dënimi, në masën e ulur nga gjykata dhe, për rrjedhojë, është vendim që vihet në ekzekutim menjëherë pas shpalljes, duke u reflektuar në dinamikën e vuajtjes së dënimit.

**25.6.5.** Për sa i përket faktit që Gjykata e Apelit në datën 31.10.2016, ka shtyrë seancën për administrimin e tri vendimeve të themelit, për më shumë se 10 ditë, sipas nenit 427, pika e të Kodit të Procedurës Penale, konkretisht seanca është zhvilluar në datë 05.12.2016, duke mundësuar dhe depozitimin e vendimit të datës 01.12.2016 për uljen e dënimit me 45 ditë, subjekti sqaron se prokurori ka kuptuar gabim nenin 427, pika 5 e Kodit të Procedurës Penale, pasi kjo dispozitë i referohet marrjes së provave të reja në gjykimin në themel të çështjes penale, ku pozita e subjektit është “i pandehur”, ndërsa lirimi me kusht është kërkesë e të dënuarit në fazën e ekzekutimit të një

---

<sup>52</sup> *I ndryshuar me ligjin nr. 9888, datë 10.03.2008, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”.*

vendimi penal dënimi me burgim, ku statusi i kërkuesit nuk është i tillë që detyron gjykatën në këtë afat për marrjen e akteve.

**25.6.6.** Në rastin konkret, nuk kemi të bëjmë me prova të reja fajësie (neni 427, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale), në një gjykim akuze, por me akte treguese rehabilitimi në një proces dinamik, gjë që prokurori nuk e bën të qartë dallimin mes gjykimit të themelit dhe gjykimit të veçantë në fazën e ekzekutimit të vendimit. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nga aktet e administruara, rezultonte se i dënuari provonte nivel të lartë rehabilitimi, duke u prezantuar si një i dënuar shembullor, model i reflektimit të thellë nga vuajtja e dënimit, shpërblyer me leje, gjithë kohës i punësuar në institucion, për të cilat kishte përfituar dhe zbritje dënimi. Përgjatë kohës së kushtit, kur kanë kaluar 3 vjet e 8 muaj nga lirimi, nuk ka asnjë sjellje me natyrë penale që të çonte gjykatën në revokimin e vendimit të lirimit me kusht.

**25.7.** Për sa arsyetuar më sipër, ashtu siç pretendon dhe subjekti i rivlerësimit në shpjegimet dhënë mbi rezultatet e hetimit, se në respekt të ligjit dhe kontrollit vertikal të zbatimit të tij, dhënia përgjigje e pretendimeve rekursuese është atribut ligjor vetëm i Gjykatës së Lartë, kolegji penal i kësaj gjykate tashmë është shprehur lidhur më këtë çështje, duke evidentuar zbatimin e gabuar nga Gjykata e Apelit Durrës, të nenit 64 të Kodit Penal dhe, për rrjedhojë, me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 07.12.2021, ka vendosur prishjen e vendimit nr. {\*\*\*}, datë 05.12.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës dhe lënien në fuqi të vendimit nr. {\*\*\*}, datë 28.07.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

**25.8.** Me parashtrimet e depozituara në Kolegj, Komisioneri Publik, nisur nga pjesa arsyetuese e vendimit gjyqësor të Kolegji Penal të Gjykatës së Lartë, konstaton se vendimmarrja e trupit gjykues të Gjykatës së Apelit Durrës, pjesë e të cilit ka qenë dhe subjekti i rivlerësimit, është gjetur si e marrë në zbatim të gabuar dhe në kundërshtim me kërkesat e ligjit penal material dhe, në këto kushte, duhet të merret në konsideratë nga Kolegji dhe të vlerësohet në drejtim të nënindikatorëve të përcaktuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016.

**25.9.** Nga analizimi i vendimit të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, trupi gjykues konstaton se në të është arsyetuar zbatimi i gabuar i nenit 64 të Kodit Penal, në drejtim të përlllogaritjes së vuajtjes së  $\frac{3}{4}$  të dënimit, si një nga kushtet për t'u plotësuar në kuadër të lirimit para kohe me kusht. Kolegji Penal, ndër të tjera, ka arsyetuar si vijon.

**25.9.1.** Gjykata e Apelit Durrës ka disponuar në kundërshtim me kërkesat e ligjit penal material. Neni 64 i Kodit Penal parashikon se të dënuarit i lind e drejta për të kërkuar lirimin me kusht, kur plotëson apo ka vuajtur më shumë se  $\frac{3}{4}$  e dënimit të caktuar ndaj tij. Në rastin konkret, rezulton se më datë 20.06.2016, kur është paraqitur kërkesa e të dënuarit L. B. për “lirim para kohe me kusht”, nuk ishte plotësuar një nga kushtet ligjore të parashikuara në këtë dispozitë, vuajtja e  $\frac{3}{4}$  të dënimit të dhënë ndaj tij, me 25 vjet burgim.

**25.9.2.** Ligjvënësi, në kuptim dhe zbatim të nenit 64 të Kodit Penal, lirimin para kohe me kusht nga vuajtja e dënimit, e ka kushtëzuar me domosdoshmërinë e plotësimit/përmbushjes *njëkohësisht* të disa kushteve, siç janë: (i) Të ketë vuajtur jo më pak se  $\frac{3}{4}$  e dënimit të dhënë për krime me masa dënimi nga 5 gjer në 25 vjet burg, siç është edhe rasti në shqyrtim. Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje. (ii) Me sjelljen dhe punën e tij, i dënuari të tregojë se, me dënimin e vuajtur, është arritur qëllimi për edukimin e tij. (iii) Evidentimi i pranisë/ekzistencës së arsyeve të veçanta për këtë qëllim. (iv) Lirimi para kohe me kusht nuk lejohet

për të dënuarit përsëritës për krime të kryera me dashje, si dhe për të dënuarit që kanë kryer veprat penale të parashikuara në nenet 78/a, 79/a, 79/b, 79/c apo paragrafi i tretë i nenit 100 të Kodit Penal.

**25.9.3.** Nga aktet e përcjella nga I EVP Durrës, përfshirë dhe dinamikën e vuajtjes së dënimit nga i dënuari, rezulton se ai ka përfituar disa herë ulje dënimi. Fillimisht, vlen të evidentohet se, me vendimin nr. {\*\*\*} akti, marrë më datë 27.02.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Krujë ka pranuar kërkesën e të dënuarit për ndryshimin e llojit të sigurisë së burgut, nga “burg i sigurisë së lartë” në një “burg të sigurisë së zakonshme”. Me vendimin nr. {\*\*\*} akti, datë 11.09.2015, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka pranuar kërkesën e kërkuarit L. B. për uljen e dënimit për periudhën nga data 06.04.2006 deri në datën 06.04.2012, me nga 90 ditë për çdo vit, gjatë kohës që ai ka qenë në paraburgim (gjithsej 540 ditë); nga data 07.04.2012 deri në datën 07.04.2015 uljen e dënimit me 45 ditë për secilin vit, kohë kur ai ka vuajtur dënimin në një burg të sigurisë së lartë, vendim që nuk është kundërshtuar nga organi i akuzës dhe të dënuarit L. B. i janë ulur gjithsej 675 ditë nga dënimi i mbetur.

**25.9.4.** Në dinamikën e vuajtjes së dënimit, është pasqyruar edhe zbritja e dënimit me një vit e gjashtë muaj nga dënimi i mbetur për shkak të ligjit nr. 107/2012 “Për dhënie amnistie”, sipas vendimit nr. {\*\*\*} akti, datë 11.05.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Në këtë vendim, i dënuari duhet të përfitojë uljen e dënimit në 1/4 e tij, për veprën penale “Prodhimi dhe mbajtja pa leje e armëve luftarake”, pasi plotëson kriteret e parashikuara në nenin 3, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 107/2012 “Për dhënie amnistie”. Njëkohësisht, rezulton se gjatë vitit 2016, i dënuari L. B. ka përfituar ulje dënimi, sipas ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, ku me vendimin nr. {\*\*\*} akti, datë 19.04.2016, ka përfituar uljen me 90 ditë të dënimit të dhënë ndaj tij me vendimin nr. {\*\*\*}, datë 16.07.2014, të Gjykatës së Lartë; si dhe me vendimin e datës 01.12.2016, i janë ulur edhe 45 ditë të tjera nga ky dënim.

**25.9.5.** Në dinamikën e vuajtjes së dënimit të përcjellë nga I EVP Durrës, nuk është evidentuar nëse uljet e dënimit janë për shkak të ligjit për amnistinë apo për shkak të ligjit për të drejtat dhe trajtimin të dënuarve, por janë shënuar ditët në total që i dënuari ka përfituar, element ky që ka ndikuar në zbatimin e gabuar të ligjit penal, duke përfshirë në llogaritjen e pjesës së vuajtur të dënimit, edhe uljen e dënimit të përfituar për shkak të amnistisë. Nga ana tjetër, në kundërshtim me ligjin, gjykata e apelit ka përfshirë në periudhën e vuajtjes së dënimit, për efekt të përcaktimit të 3/4 të dënimit, si kriter i parashikuar në nenin 64 të Kodit Penal, edhe vendimin e datës 01.12.2016 (disa ditë para se gjykata e apelit të shprehej me vendimin e rekursuar), ndonëse nuk kishte kaluar afati i ankimit ndaj këtij vendimi. Ky vendim është marrë në kundërshtim me ligjin për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve, pasi ligji i kohës parashikonte që i dënuari mund të përfitonte një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit (me vendimin e datës 19.04.2016, kërkuarisi kishte përfituar tashmë 90 ditë ulje dënimi për vitin 2016).

**25.9.6.** Gjykata e Apelit gabimisht ka përcaktuar në vendimin e saj se: *[...] vuajtja në masën 3/4 e dënimit prej 25 vitesh burgim, përkthehet në vuajtjen fizikisht të një kohe prej 16 vitesh e 9 muajsh,* kur në fakt koha që duhet të vuajë fizikisht i dënuari ndaj të cilit është caktuar dënim me 25 vite burgim, është 18 vite e 9 muaj burgim. Kolegji Penal çmon se në rastin konkret, nuk plotësohet kushti i përcaktuar në nenin 64 të Kodit Penal – vuajtja e jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë, kusht ky që duhet të jetë plotësuar në momentin e depozitimit të kërkesës, dhe jo gjatë gjykimit në apel, ku objekt shqyrtimi është ligjshmëria e vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Zbatimi i gabuar i ligjit penal në rastin konkret, ka ardhur edhe si pasojë e llogaritjes në masën e

dënimin të vuajtur të uljes së dënimit në masën një vit e gjashtë muaj të përfituar prej të dënuarit L. B., për shkak të ligjit nr. 107/2012 “Për dhënie amnistie” – ndalim ky i parashikuar shprehimisht në paragrafin e dytë të nenit 64 të Kodit Penal.

**25.9.7.** Kushtet e parashikuara në nenin 64 të Kodit Penal janë kumulative, ndaj mjafton mosplotësimi i njërit prej tyre, për të refuzuar kërkesën për lirim me kusht. Në rastin konkret, mosplotësimi i kushtit të vuajtjes së “jo më pak se tre të katërtat e dënimit të dhënë” – është i mjaftueshëm për të arritur në konkluzionin se kërkesa e të dënuarit L. B. për lirim para kohe me kusht, është e pabazuar në ligj (pavarësisht këtij konkluzioni, duhet theksuar edhe fakti se disa nga vendimet e gjykatës së shkallës së parë për ulje dënimi janë në kundërshtim me ligjin për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve apo ligjin për ekzekutimin e vendimeve penale, vendime për të cilat nuk rezulton të jetë ushtruar as ankimi). Në këto rrethana, Kolegji vlerëson të mos vijojë me trajtimin e ekzistencës apo jo të arsyeve të veçanta apo të analizojë sjelljen e të dënuarit në raport me veprën penale të kryer dhe familjarët e viktimës/viktimitave, elemente që në fakt janë trajtuar si në vendimin e rekursuar, ashtu edhe në rekursin e prokurorit.

**25.9.8.** Kolegji Penal vlerëson se në rastin konkret, kjo çështje mund të zgjidhet përfundimisht nga Gjykata e Lartë, pasi jemi para zbatimit të ligjit material – kushteve të parashikuara në nenin 64 të Kodit Penal. Kolegji vlerëson se zbatimi i ligjit material në rastin konkret, nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve apo të provave të marra në lidhje me këtë çështje. Në rrethanat e parashtruara, Kolegji vlerëson të drejtë vendimin e gjykatës së shkallës së parë, e cila ka rrëzuar kërkesën e të dënuarit pikërisht për shkak të mosplotësimin të kushtit ligjor të “vuajtjes së tre të katërtave të dënimit të dhënë ndaj kërkuesit L. B.”.

**25.10.** Me parashtrimet në Kolegji, subjekti i rivlerësimit shprehet se nga vetë vendimi i Gjykatës së Lartë, nuk është konstatuar cenim i nenit 427/5 të Kodit të Procedurës Penale, pretendim i rekursorit i trajtuar dhe nga vetë Komisioni në vendim dhe Komisioneri Publik në ankim. Për shkak të natyrës së gjykimit, ai nuk ka asnjë lidhje me gjykimin e themelit të një procedimi penal, por është kërkesë në fazën e ekzekutimit të vendimit të dënimit me burgim, riçelja e shqyrtimit gjyqësor dhe marrja e akteve dokumentare në cilësinë e provës, nuk ndjek të njëjtat rregulla si ato për marrjen e provave, si: njoftime mbi faktet objekt akuze dhe afatet e përcaktuara nga neni 427/5 i Kodit të Procedurës Penale, 10-ditore për caktimin e seancës, nuk vlejnë në të njëjtën mënyrë në këtë lloj gjykimi. Çështja e lirit me kusht, është kërkesë e të dënuarit në fazën e ekzekutimit të një vendimi penal, dënimi me burgim ku statusi i kërkuar që ka investuar gjykatën me pretendimin e tij nuk është i tillë që detyron gjykatën në këtë afat për marrjen e akteve. Në këtë rast, aktet e marra nuk janë prova fajësie në kuptimin procedural të provës, por janë akte zyrtare (vendim gjyqësor) që nevojiten për të verifikuar ekzistencën e kushteve ligjore në kërkesën e të dënuarit që ka investuar gjykatën dhe nuk kanë asnjë lidhje detyruese me afatin 10-ditor.

Lidhur me konstatimin e Gjykatës së Lartë në vendim: *[...] se në dinamikën e vuajtjes së dënimit të përcjellë nga IEVP Durrës, nuk është evidentuar nëse vendimet për ulje dënimi janë për shkak të ligjit për amnistinë apo për shkak të ligjit për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve [...]*, subjekti pretendon se Gjykata e Lartë nuk ka konstatuar shkelje apo anashkalim me dashje apo në kundërshtim me provat e dosjes gjyqësore të ligjit penal material në këtë pikë, pasi një fakt i tillë nuk ka ndodhur nëpërmjet vendimit të Gjykatës së Apelit Durrës. Sipas subjektit, ajo që del qartë nga vendimi i Gjykatës së Lartë, është fakti se kanë qenë pikërisht të dhënat e paraqitura nga IEVP Durrës që kanë ndikuar në zbatimin e gabuar të ligjit material penal. Kjo pasi, në kushtet që të gjitha ditët e ulura nëpërmjet vendimeve gjyqësore janë trajtuar së bashku me aktin e dinamikës së vuajtjes

së dënimit, duke mos qartësuar për Gjykatën e Apelit se jemi para një përfitimi që derivon nga ligji për amnistinë, kjo kohë është përfshirë në dënimin e vuajtur për efekt të plotësimit të ¾ të përcaktuar nga ligji dhe për këtë kriter ligjor, ka çuar Gjykatën e Apelit në qëndrim të gabuar. Pra, qëndrimi i gabuar nuk vjen si rezultat i asnjë lloj deformimi të fakteve nga Gjykata e Apelit, sikurse ka konkluduar Komisioni apo arsyetuar Gjykata e Lartë, por vjen nga një paraqitje ndryshe e të dhënave nga ana e IEVP-së, që është organ ndihmës për gjykatën në këto lloj gjykimesh.

**25.11.** Ndërsa, sa i përket arsytimit të Gjykatës së Lartë në vendim, se: *në kundërshtim me ligjin, gjykata e apelit ka përfshirë në periudhën e vuajtjes së dënimit, për efekt të përcaktimit të ¾ të dënimit, si kriter i parashikuar në nenin 64 të Kodit Penal, edhe vendimin e datës 01.12.2016 (disa ditë para se gjykata e apelit të shprehej me vendimin e rekursuar), ndonëse nuk kishte kaluar afati i ankimit ndaj këtij vendimi. Ky vendim është marrë në kundërshtim me ligjin për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve, pasi ligji i kohës parashikonte që i dënuari mund të përfitonte një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit (me vendimin e datës 19.04.2016, kërkuesi kishte përfituar tashmë 90 ditë ulje dënimi për vitin 2016), subjekti sqaron se vendimi i datë 01.12.2016, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, nuk ka qenë objekt rishikimi në Gjykatën e Apelit Durrës, nuk është në misionin e asaj gjykate të shqyrtojë atë vendim. Ky është një vendim vetëm me palë kërkuese, me kërkim të pranuar dhe potencialisht pa asnjë mundësi ligjore ankimimi. Lidhur me argumentimin se vendimi i datës 01.12.2016 nuk kishte marrë formë të prerë dhe, për rrjedhojë, ulja e dënimit prej 45 ditësh nuk mund të përfshihej në masën e përgjithshme të dënimit të vuajtur, subjekti sqaron se ky qëndrim i Gjykatës së Lartë është i pari në këtë drejtim, nuk ka një qëndrim unifikues në lidhje me këtë çështje, e ligji nuk lë vend për zbatim tjetër, ai është vendim me ekzekutim të menjëhershëm, sepse disponon për shuarje të pjesshme dënimi dhe, për rrjedhojë, disponon mbi lirinë personale. Ky vendim është i paankimueshëm e me ekzekutim të menjëhershëm, në zbatim të nenit 462, pika 2 e Kodit të Procedurës Penale. Këto lloj vendimesh ndikojnë drejtpërdrejt në lirinë personale e për këtë shkak, ligji procedural penal ka paraparë te vendimet që ekzekutohen menjëherë pas shpalljes, që parashikohet qartësisht edhe nga neni 417 i Kodit të Procedurës Penale, ku qartësohet se ankimi ndaj këtyre vendimeve, nuk ka efekt pezullues, dhe personi fiton lirinë atë çast.*

**25.12.** Subjekti, nëpërmjet parashtrimeve në Kolegj, pretendon gjithashtu se Gjykata e Lartë nuk ka një praktikë gjyqësore të mëparshme që të ishte orientuese për subjektin në momentin e gjykimit e aq më pak detyruese, duke zbatuar ligjin, ashtu siç e ka gjykuar, bazuar në argumente. Subjekti i rivlerësimit pretendon se ka qenë konsistente se kjo kohë duhet të llogaritet e përditësuar deri në dhënien e vendimit përfundimtar, pasi zbatimi formalist i dispozitës (duke e lidhur plotësimin e kohës minimale me datën e regjistrimit të kërkesës), nuk i shërben as miradministrimit të drejtësisë penale, as vetë *ratio-s* së institutit, as gjykatës, as të dënuarit dhe aq më pak shoqërisë. Subjekti pretendon se ka vlerësuar në mënyrë koherente (pas asnjë aplikim të ndryshëm) se kërkesa, pavarësisht se e bërë në një datë më të hershme sesa lejon afati ligjor, nuk mundet të përbëjë pengesë ligjore kundrejt gjykatës që në rast se në momentin e shqyrtimit, vlerëson se afati është plotësuar, të vendosë pranimin e saj për shqyrtim dhe zgjidhjen në themel të kërkesës.

Në praktikën gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë dhe të gjykatave të apelit, të cilat ka konsultuar, është konstatuar se është pranuar në mënyrë konstante dhe të përgjithshme se afati i periudhës minimale të vuajtjes së dënimit me burgim për qëllimet e akordimit të lirimit para kohe me kusht, përlllogaritet në mënyrë të përditësuar, deri në momentin e dhënies së vendimit përfundimtar. Mënyra e interpretimit nga gjykatat, sipas subjektit, shmang formalizmat e tepruara dhe garanton më shumë aksesin e të dënuarve te ky lloj dënimi alternativ, duke i dhënë përparësi themelit të kushteve apo kritereve ligjore sesa aspekteve formale. Subjekti i rivlerësimit pretendon se gjykata kompetente e fazës së ekzekutimit, ka detyrë ligjore që të kontrollojë dhe të përlllogarisë



afatin e periudhës së vuajtur të dënimit në mënyrë të përditësuar dhe deri në momentin e vendimmarrjes përfundimtare, pasi vetëm në këtë mënyrë, ajo do të jetë në gjendje që të përcaktojë me saktësi sesa është periudha e mbetur e dënimit me burgim, e cila do të pezullohet dhe që do të shërbejë për të përcaktuar kohëzgjatjen e dënimit alternativ të lirimit me kusht. Qëndrimi i Gjykatës së Lartë në vendimin objekt diskutimi, sipas subjektit të rivlerësimit, vjen pas vendimmarrjes së subjektit të rivlerësimit dhe gjithë qëndrimin konsistent të gjykatave më të ulëta, e që do të duhet të vlerësohet fuqia detyruese e vetë vendimit të Gjykatës së Lartë dhe se si do të mund të ndikojë në të ardhmen në trajtimin e të njëjtit kriter ligjor, parashikuar në nenin 64 të Kodit Penal, duke pasur parasysh se nuk jemi përpara një qëndrimi njësoj e aq më pak unifikues të praktikës gjyqësore.

**25.13.** Në vijim të parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, sjell në vëmendje se duke pasur në vëmendje rrezikshmërinë e lartë shoqërore të veprave penale të kryera nga kërkuesi, trupi gjykues ku ka qenë anëtare, ka bërë një analizë të hollësishme të çdo të dhëne në lidhje me riedukimin e të dënuarit, sjelljen, angazhimin në programet rehabilituese të cilat kanë qenë në nivele shumë të mira. I dënuari gjatë ekzekutimit të vendimit të gjykatës, përgjatë gjithë kohës së kushtit, por edhe deri aktualisht, nuk ka kryer asnjë vepër penale tjetër, shtrirë në një periudhë 6-vjeçare nga momenti i dhënies së lirisë me kusht. I dënuari, referuar akteve sjellë me parashtrimet, si urdhra për dhënie leje dhe vlerësim sjelljeje të lëshuara nga IEVP-ja, sipas subjektit, tregon të ketë pasur një sjellje shembullore, ka qenë i punësuar dhe ka përfituar ulje dënimi nëpërmjet përfshirjes në punë, ka dalë me leje dhe është rikthyer në institucion vijimësisht gjatë periudhës së fundit të vuajtjes së dënimit me burgim.

**25.14.** Trupi gjykues, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit, ka qenë pjesë e trupit gjykues që ka marrë vendimin nr. {\*\*\*}, datë 05.12.2016, në zbatim të gabuar të nenit 64 të Kodit Penal, përfshihet në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Mici. Në kuptim të nenit 43, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, procedura e rivlerësimit kryhet në përputhje me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve, për aq sa është i zbatueshëm. Në këtë drejtim, neni 72 i ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ka përcaktuar indikatorët mbi të cilët vlerësohen aftësitë profesionale të gjyqtarit. Në pikën 2 të kësaj dispozite, parashikohet si indikator *aftësia e përgjithshme për të interpretuar ligjin*. Ashtu siç është arsyetuar në vendimin e Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë, subjekti i rivlerësimit si pjesë e trupit gjykues që ka shqyrtuar kërkesën e të dënuarit L. B., për “Lirim para kohe me kusht”, ka treguar mangësi në analizimin e vendimeve gjyqësore me të cilat i dënuari ka përfituar ulje dënimi, duke mos treguar kujdes në drejtim të zbatimit të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar, që parashikon se të dënuarit mund të përfitojnë një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit, si dhe uljen e dënimit për shkak të ligjit nr. 107/2012 “Për dhënie amnistie”, të cilën vetë neni 64 i Kodit Penal, në përmbajtjen e tij e ka përjashtuar nga përllogaritja: “Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose falje”. Trupi gjykues gjen të pabazuar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se kanë qenë të dhënat e paraqitura në aktin e dinamikës së vuajtjes së dënimit nga IEVP Durrës që kanë çuar Gjykatën e Apelit Durrës në qëndrim të gabuar. Gjykata e Apelit Durrës ka pasur detyrimin ligjor të analizojë të gjitha vendimet gjyqësore për ulje dënimi, ashtu siç administroi tri vendimet e themelit, për të cilat shtyu seancën gjyqësore të datës 31.10.2016, deri më datë 05.12.2016, duke pasur mundësi të administrojë në këtë rast edhe vendimin nr. {\*\*\*}, të datës 01.12.2016, së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për uljen e dënimit me 45 ditë. Mungesa e analizimit të këtyre vendime gjyqësore, tregon mangësi profesionale të subjektit të rivlerësimit, në kuadër të interpretimit dhe zbatimit të drejtë të nenit 64 të Kodit Penal. Në këto kushte, lidhur me vendimin penal nr. {\*\*\*}, datë 05.12.2016, të Gjykatës së Apelit Durrës, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e anëtarit të trupit gjykues, ka treguar mangësi profesionale në interpretimin e nenit 64 të Kodit Penal, lidhur me plotësimin e kriterëve ligjorë që kërkon lirim para kohe me kusht nga vuajtja e dënimit, arsyetuar në vendimin nr. {\*\*\*}, datë 07.12.2021, të Kolegjit Penal të Gjykatës së Lartë.

26. Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e gjyqtarit të vetëm apo anëtarit të trupit gjykues, në vendimet penale, me burim nga raportet e hartuara nga KLGj-ja, Ministria e Drejtësisë, denoncimi nga publiku dhe çështja e diskutuar dhe bërë publike për zbatimin e nenit 64 të Kodit Penal, është gjetur në zbatim të gabuar dhe në kundërshtim me kërkesat e ligjit penal material dhe procedural. Mangësitë e konstatuara afektojnë indikatorin e parashikuar nga neni 72, pikat 2 dhe 3 të ligjit nr. 96/2016 e, për pasojë, e kualifikojnë subjektin e rivlerësimit si të papërshtatshëm, sipas parashikimit të nenit 61, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.
27. Trupi gjykues i Kolegjit, lidhur me pretendimin e Komisionerit Publik, që krahas shkaqeve të tjera për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, të aplikohet edhe neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, vlerëson se rrethanat e analizuara në çështjen objekt shqyrtimi dhe që janë konsideruar si shkaqe për kualifikimin sipas nenit 61, pikat 3 dhe 4 të këtij ligji, janë të njëjtat për të cilat kërkohet edhe kualifikimi i tyre sipas nenit 61, pika 5. Në këto kushte, Kolegji çmon se është arritur qëllimi i ligjvënësit nëpërmjet kualifikimit të shkeljeve sipas dispozitave të posaçme të ligjit lidhur me kriteret përkatëse të rivlerësimit, të cilat urdhërojnë vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Kolegji nuk evidentoi rrethana të tjera, jashtë atyre të kualifikuara si më lart, të cilat mund të passillnin vlerësimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Mici, në tërësi, duke konkluduar se ajo ka cenuar besimin e publikut sipas nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016. Për këto arsye, Kolegji e konsideroi të panevojshëm analizimin e mëtejshëm të këtij pretendimi të Komisionerit Publik.
28. Në përfundim të sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Anita Mici, nuk ka arritur nivelin e besueshmërisë të parashikuar nga neni 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, për konfirmim në detyrë. Në kushtet e deklaramentit të pamjaftueshëm lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë dhe mangësive profesionale që çojnë në papërshtatshmëri lidhur me kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale, trupi gjykues, në zbatim të nenit 61, pikat 3 dhe 4 të ligjit nr. 84/2016, vlerëson se vendimi nr. 287, datë 04.08.2020, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i cili ka vendosur konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Mici, është marrë në konstatim të gabuar të situatës faktike dhe në zbatim të gabuar të ligjit dhe, për rrjedhojë, duhet ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE,**

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

### **VENDOSI:**

1. Ndryshimin e vendimit nr. 287, datë 04.08.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Anita Mici.
  2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
- U shpall sot, në Tiranë, më datë 23.02.2023.

**ANËTARE**

**Ina RAMA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Albana SHTYLLA**

*nënshkrimi*

**ANËTARE**

**Rezarta SCHUETZ**

*nënshkrimi*

**RELATORE**

**Natasha MULAJ**

*nënshkrimi*

**KRYESUES**

**Sokol ÇOMO**

*nënshkrimi*